



# NBG BANK

PARTNER PËR SOT DHE NESËR

RAPORTI VJETOR 2015



# NBG BANK

PARTNER PËR SOT DHE NESËR



## TABELA E PËRMBAJTJES

MISIONI YNË	4
MESAZH NGA DREJTORI PERGJITHSHEM EKZEKUTIV	6
GRUPI NBG	8
BANKA NBG NË SHQIPËRI	10
QEVERISJA KORPORATIVE	12
STRUKTURA ORGANIZATIVE	27
SHËRBIMET BANKARE PËR KONSUMATORËT	29
BANKINGU TREGTAR DHE I KORPORTAVE	30
ADMINISTRIMI I RREZIKUT	31
BURIMET NJEREZORE	36
PAJTUESHMERIA	38
AUDITIMI I BRENDSHËM	39
PERGJEGJESIA SOCIALE	41
TË DHËNA FINANCIARE	42
ZYRA ADMINISTRATIVE	118
ADRESAT E KONTAKTIT	119



# MISIONI YNË

Misioni i bankës në Shqipëri është të zhvillohet si një institucion financiar lider në vend duke u siguruar konsumatorëve një shërbim të dedikuar të qëndrueshëm, që krijon vlera duke operuar me angazhim, qëndrueshmëri, vazhdimësi, dhe transparencë në përfitim të konsumatorit, aksionerëve, punonjësve dhe në frymën e përgjegjesisë ndaj komunitetit në përgjithësi.

# Në NBG ne:

- Sigurojmë shërbime të personalizuar të një cilësie të larte dhe zgjidhje financiare inovative për konsumatorët.
- Kujdesemi dhe vlerësojmë punonjësit ndërkohë që nxisim punën në grup dhe diversitetin.
- Të rrisim pavarësinë tonë dhe të mbajmë nivele të larta të performancës.
- Të bëjmë diferencën në komunitetet tona dhe të shpalosim integritet dhe shërbim të shkëlqyer

NBG Albania është krenare që është pjesë e grupit NBG, lider i grupit financiar më të madh në Greqi, i pranishëm në Europën jug-lindore dhe Mesdheun lindor. Banka Kombëtare e Greqisë u themelua në vitin 1841, si banka e parë në Greqinë moderne dhe gjatë historikut 170 vjeçar ka dhënë një kontribut vendimtar në jetën financiare të shtetit mëmë.

Grupi NBG ofron një game të gjerë produktesh dhe shërbimesh, që përputhen me nevojat gjithnjë në ndryshim të bizneseve dhe individëve si: depozita, investime në biznes, financim, sigurim, leasing, etj.

Vizioni i grupit NBG është të ruajë pozicionin e tij drejtues në Greqi dhe prezencën dinamike në Europën juglindore e Mesdheun lindor, duke operuar me angazhim, qëndrueshmëri e transparencë në përfitim të klientit, punonjësit, aksionerit dhe me përgjegjshmëri ndaj shoqërisë.





# MESAZH NGA DREJTORI PERGJITHSHEM EKZEKUTIV



**Z. Ioannis Agathos,**  
Drejtore i Pergjithshem  
Ekzekutiv



# I DASHUR LEXUES,

**Brenda tendencës në rritje, përgjatë viteve, në arritjet makroekonomike të Shqipërisë, por në të njëjtën kohë në një mjedis agresiv konkurrence bankare si dhe nën efektet anësore të vështirësive ekonomike në vendet fqinje, Banka NBG Albania pati sërish një vit pozitiv.**

Pavarësisht barrës gjithnjë në rritje të kredive të këqia në sektorin bankar shqiptar – ato qëndruan në një mesatare prej 20% të totalit të portofolit të kredive, pa marrë në konsideratë efektet e fshirjes së kredive nga bilanci për qëllim rregullimi- dhe kryesisht mungesa e mundësive dhe kushteve për rritje bankare, Banka NBG Albania arriti të shënonte 9% rritje në portofolin e saj të kredive, kryesisht nga rritja e kredive korporative me 18%.

Viti financiar 2015 ishte i pari, që nga fillimi i krizës ekonomike në 2009, kur Banka NBG Albania rekuperoi tendencën negative në cilësinë e aseteve. Kreditë e këqia të Bankës në 2015 ranë në 250bps, krahasuar me vitin 2014, kryesisht falë menaxhimit efektiv dhe të fokusuar të kredive me probleme.

Gjatë vitit 2015, Banka NBG Albania mbajti një rritje të qëndrueshme të të ardhurave, e cila u shoqërua me një menaxhim efektiv të kostove, që të kombinuara çuan në gjenerimin e rezultateve pozitive para provigjoneve, prej €3.5 milionë në 2015 kundrejt €1.9 milionë në 2014.

Të ardhurat neto nga interesi u rritën me 1.6 milionë Euro , ose me 20% nga viti në vit duke reflektuar kryesisht një rënie në koston e fondeve me 50% nga viti në vit. Marzhi neto nga interesat u rrit me 80 pike bazë, duke arritur 336 pike bazë në total në fund të vitit 2015. Banka rriti eficientë e saj në kosto duke reduktuar raportin e koston ndaj të ardhurave nga 80% në 68% në krahasim me një vit më parë, duke ndjekur një politikë të mbajtjes së koston nën kontroll

Banka mbetet plotësisht e vetë-financuar, duke kapërcyer në mënyrë efektive humbjen e depozitave që ndodhi gjatë periudhës së verës dhe duke prezantuar produkte depozitash tërheqëse dhe të mirë strukturuara u bë i mundur rekuperimi i rreth 30 % I kësaj humbjeje gjatë dy tremujorëve të fundit të vitit 2015, trend i cili do të vazhdojë dhe në vitin që pason.

Raporti i Likuiditetit i Banka NBG Albania qëndron shumë mbi atë minimal të përcaktuar nga Banka e Shqipërisë. Ajo gjithashtu gëzon një raport mjaft të

mire të kapitalit ndaj aseteve, me një nivel CAD prej 19.1% në fund të vitit 2015, që qëndron dukshëm mbi kufirin rregullator prej 15% dhe mesatares së sistemit bankar shqiptar prej 15.7%

Krahas biznesit, t'u qëndrojmë besnikë parimeve të përgjegjësisë sociale ka qenë gjithnjë një pjesë e rëndësishme e shërbimit tonë ndaj komunitetit dhe një zgjedhje e ndërgjegjshme në menaxhimin e biznesit tonë në mënyrë të përgjegjshme. Duke respektuar angazhimin tonë, ne vazhduam përgjatë vitit 2015 të kontribuojmë në disa fusha të interesit publik, duke mbështetur fëmijët në nevojë, kulturën dhe artin shqiptar, nevojat e komunitetit për shëndetësi dhe arsim, etj.

Në vitin që po vjen, Banka NBG Albania do të vazhdojë të ndërmarrë hapat e nevojshëm në ndjekje të objektivave të saj strategjike për një forcim të politikave të saj të menaxhimit të riskut në linjë me udhëzimet e Grupit , duke përmirësuar sistemet e saj të I.T. dhe MIS, si dhe duke diversifikuar biznesin e saj Retail dhe Korporatë në tregun shqiptar, duke përmirësuar në mënyrë konkurruese cilësinë e aseteve tona, përfitueshmërinë dhe nivelin e shërbimit ndaj klientit.

Sigurisht, do të ketë të tjera sfida në rrugën tonë të arritjes së objektivave, por falë profesionalizmit të stafit, mbështetjes së Grupit dhe bashkëpunimit të klientëve tanë, 2016 do të rezultojë një tjetër vit arritjesh.

Për këtë arsye, fjalet e fundit janë fjalë mirënjohjeje, në emër të menaxhimit të Banka NBG Albania, drejtuar kujtdo dhe secilit prej kontribuesve në suksesin tonë.

# GRUPI NBG

Banka Kombëtare drejton një nga grupet më të mëdha financiare në Greqi, me një prani të fortë në Europën juglindore dhe Mesdheun lindor. NBG Group operon në 11 vende në të gjithë botën ku, përveç NBG-së, kontrollon 10 banka dhe 53 kompani duke ofruar shërbime financiare përmes 19,830 punonjësve të saj.

## Të dhëna financiare

(në € milion, në përputhje me IFRS)

	Viti financiar '15
Totali asetëve	111,232
Kapitali Aksioner	9,099
Kredi & parapagime të konsumatorëve (bruto)	45,375
Për shkak të konsumatorëve	42,959
Kredi: Depozita (neto)	91%
Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit	14.6%

## Kompanitë e Grupit

### Greqi

National Bank of Greece S.A.  
Ethniki Hellenic General Insurance S.A.  
National Securities S.A.  
NBG Asset Management Mutual Funds S.A.  
Ethniki Leasing S.A.  
Ethniki Factors S.A.  
Ethniki Kefalaiou S.A.  
NBG Pangaea REIC

### Bullgari

United Bulgarian Bank AD  
Interlease EAD  
UBB Factoring  
UBB - Chartis Insurance Company AD  
UBB - Alico Life Insurance Company AD  
UBB Insurance Broker AD

### Rumani

Banca Romaneasca SA  
NBG Leasing IFN SA  
Garanta Asigurari SA

### Serbi

Vojvodjanska Banka AD - Novi Sad  
NBG Leasing d.o.o.

### Maqedoni

Stopanska Banka AD - Skopje

### Shqipëri

Banka NBG Albania Sh.A.

### Mbretëri e Bashkuar

NBG London Branch  
NBGI Private Equity Ltd  
NBG Securities SA

### Qipro

National Bank of Greece (Cyprus) Ltd  
Ethniki Insurance (Cyprus) Ltd  
National Securities S.A.

### Malta

NBG Bank Malta Ltd

### Afrikë e Jugut

The South African Bank of Athens Ltd

### Egjipt

NBG Egypt Network

### Australi

NBG Melbourne Representative Office



# ÇMIME DHE NDERIME

**“Banka më e vlerësuar për ekselencë”** për shërbimet që u ofron klientëve grekë (vendi 1) dhe klientëve institucionalë të huaj në tregun grek (vendi 2) - çmim i dhënë nga studimi i shërbimeve ndërkombëtare “Agent Banks in Major Markets Survey” i bërë nga revista Global Custodian.

**“Banka më e mirë për 2012”** Çmim i marrë për të pestin vit rradhazi / Greqi.

**Çmimi i dytë në kategoritë “Kompania më e mirë”** e listuar në këmbimin valutë të Athinës” dhe “Kompania më e mirë në fushën e qeverisjes së korporatës” / Greqi

**“Banka më e mirë në Greqi”** nga revista financiare ndërkombëtare Euromoney, çmim i dhënë për të 23-tin vit në rradhë.

**“Banka tregëtare më e mirë në Greqi 2013”** Çmim i dhënë nga revista Global Finance.

**2 çmime të ndryshme në “E- evolutions 2013”**/ Greqi .

**“Kombinimi i kanaleve fizike dhe dixhitale”**, Për dyqanin i-bank të NBG, i dhënë nga Qendra e Kërkimeve të Biznesit e Universitetit të Ekonomisë dhe Biznesit të Athinës dhe Boussias Communications/ Greece.

**Çmimi “Përgjegjësia sociale e korporatës”** Për fushatën “Show them” i dhënë nga Ministria e Zhvillimit, Konkurrencës, Infrastrukturës, Transportit dhe Rjeteve/ Greqi.

**“Banka me ecurinë më të mirë në treg, në Greqi”** , Nga revista financiare ndërkombëtare Global Finance (2013)

**‘Çmimi i parë për ekselencë në Marketing për I-Bank’** - Dega pioniere I-Bank e NBG, fitoi çmimin e parë në kategorinë Administrimi i Shpërndarjes së Rjetit dhe Trade Marketing

**Çmimi i dytë për Raportin ndaj Përgjegjësisë Sociale** mes gjithë bizneseve greke . NBG u listua e para në kategorinë e bankave (2012)



# BANKA NBG NË SHQIPËRI

NBG e filloi aktivitetin në Shqipëri në shtator 1996 si një degë në Tiranë e Bankës Kombëtare të Greqisë S.A, banka e parë dhe më e madhe në Greqi me një histori 170 vjeçare. Tashmë, në vijim të transformimit në Maj 2012, NBG Albania SHA zhvillon aktivitetin e saj si një bankë e pavarur, e vetë financuar, anëtare e grupit NBG.

Banka NBG Albania është një nga bankat kryesore në vend, iniciatore dhe një lojtar i rëndësishëm në dhënien e kredive për shtëpi dhe ato konsumatore, duke zotëruar një pjesë të konsiderueshme të tregut të këtyre produkteve. Banka ofron gamën e plotë të produkteve dhe shërbimeve për klientët e të gjithë segmenteve: korporata, biznese të mesme e të vogla dhe individë. Ajo ka zgjeruar

rrjetin e saj me 28 degë në të gjithë vendin, 12 prej të cilave gjenden në Tiranë, dhe 16 në çdo qytet të Shqipërisë. Banka NBG Albania ka një rrjet ATM-sh në të gjithë vendin duke u mundësuar klientëve të kenë akses mbi likuiditetin e tyre kudo ku shkojnë, pa pasur nevojë për të shkuar në bankë.


Aktivitetet bankare drejtohen nga një staf i përkushtuar dhe i dedikuar i përbërë nga 303 punonjës të mirëtrajnuar, profesionistë dhe me eksperiencë në një nivel teknik dhe menaxherial të mbështetur nga sisteme të avancuara të teknologjisë së informacionit. Banka NBG Albania, është një bankë që vetë financohet, me një likuiditet të lartë dhe bazë të fortë kapitali.

Të dhëna operacionale	Q2 2016*	2015	2014
Nr i Degëve	28	28	27
Punonjës	300	303	284
Zyra Qendrore	150	145	138
Rrjeti i Degëve	150	158	146
		Total CAD ratio	14.6%

Të dhëna kryesore financiare (në € m)	Q2 2016	2015	2014
Totali asetëve	285	284	316
Kredi për konsumatorët (bruto)	211	214	197
Depozita të konsumatorëve (të rregulluara)	201	193	236
Totali i kapitalit aksioner	61	60	58

Raporte kryesore			
Raporti i kapitalit të nivelit të parë	13.1%	12.7%	11.28%
Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit (CAR)	16.64%	19,1%	18.41%
Norma likuiditetit	37.2%	34.6%	41.7%
Kosto / Të ardhura	60.6%	67.6%	79.4%
Marzhi neto i interesave	3.60%	3.36%	2.56%
Kredi / Depozita (neto)	90%	95%	71%
Kosto e riskut (provigjone) bps	142	82	66
RoE (para taksave)	3.5%	3,6%	2.5%
RoA (pas taksave)	0.8%	0,7%	0.5%

\*Q2 - Tremujori i dytë



# QEVERISJA KORPORATIVE



## Banka NBG Albania Executive Team

**Ioannis Antoniadis**  
Drejtör i Riskut;

**Aida Apostoli (Tirana)**  
Drejtore e Bankingut Individual

**Anastasios Asimakopoulos**  
Drejtör i Bankingut Korporativ

**Brunilda Papa (Jakovi)**  
Drejtore e Operacioneve dhe Financës

**Ioannis Agathos**  
Drejtör i Përgjithshëm Ekzekutiv;

**Jonida Lakuriqi**  
Drejtuese për Qeverisjen Bankare



**NBG BANK**



## Kuadri i Miradministrimit të Bankës

Kuadri i miradministrimit të Bankës është në përputhje me kriteret e legjislacionit shqiptar (i.e. Ligjin Tregtar dhe Rregulloren 63/2012 të Bankës së Shqipërisë), Statutin e Bankës, parimet e Grupit NBG dhe rregulloret e brendshme. Drejtimi i Bankës synon të sigurojë një ndarje efektive dhe transparente të roleve dhe përgjegjësi të organeve drejtuese, në përputhje me dispozitat rregullatore, si dhe check & balance midis funksioneve të mbikëqyrjes strategjike, drejtimit dhe kontrollit.

Mbështetur në urdhrin e Guvernatorit Nr. 8/1/28.05.2012, Dega e Shqiperise e NBG sh.a. u shndërrua në Bankën NBG Shqipëri sh.a., një filial i pavarur dhe i vetëfinancuar i Grupit NBG. Ky proces i shndërrimit çoi në krijimin e strukturave të reja mbikëqyrëse, drejtuese dhe administruese, si Këshilli Drejtues, Komiteti i Auditit dhe drejtuesit ekzekutivë. Detyrat dhe përgjegjësitë përkatëse të këtyre strukturave reflektohen në mënyrë gjithëpërfshirëse në Statutin e Bankës, të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme më 29 qershor 2012, në përputhje me parimet e miradministrimit të vendosura nga kuadri ligjor dhe rregullator i Bankës së Shqipërisë dhe ai i Grupit NBG.

Banka vepron në përputhje me parimet vendore të miradministrimit dhe Kodin e Mirëqeverisjes së Grupit në masën që ky zbatohet në Shqipëri. Në kontekstin e fuqizimit të strukturave të miradministrimit, në vitin 2015 Banka krijoi: (i) Komitetin e Miradministrimit, Emërimeve dhe Shpërblimit; dhe (ii) rishikoi përbërjen dhe kartën e përgjegjësi të Komitetit të Administrimit të Rrezikut në përputhje me standardet e Grupit NBG dhe parimet e miradministrimit të Bazel I dhe II.

## Praktikat e Miradministrimit

Në përpjekje për të ruajtur ekselencën në miradministrim dhe forcuar kuadrin ekzistues të administrimit të rrezikut, Banka ka miratuar politikën dhe praktikën e mëposhtme të miradministrimit; këto politika janë në përputhje me veprimtaritë e saj dhe sigurojnë transparencën dhe efektivitetin e operacioneve.

## Politika e Konfliktit të Interesave për Drejtuesit e Larte

Politika e Konfliktit të Interesave për Drejtuesit e larte e miratuar në vitin 2012 në përputhje me politikën e Grupit synon të forcojë Sistemet e Kontrollit të Brendshëm, si dhe të parandalojë dhe administrojë konfliktet potenciale të interesit midis Bankës dhe administratorëve që mund të kenë një impakt potencial mbi reputacionin dhe interesat e Bankës, klientëve, aksionarëve dhe punonjësve.

## Kodi i etikës

Kodi i Etikës së Grupit, i rishikuar në dhjetor 2015, është përshtatur me kuadrin rregullator vendas dhe reflekton vlerat themelore që Banka, si anëtare e Grupit NBG, mbështet në veprimtaritë e saj. Kodi pasqyron edhe dispozitat ligjore dhe rregullative që lidhen me drejtimin dhe punonjësit e Bankës, në mënyrë që: (i) të mbrojë interesat e punonjësve, klientelës dhe aksionarëve; (ii) të sigurojë operimin e duhur të mjedisit financiar; dhe (iii) të ruajë dhe fuqizojë besueshmërinë, mjaftueshmërinë e kapitalit dhe emrin e mirë të Bankës.

## Politika e Bilbilfryrësit

Në vitin 2015, Banka miratoi Politikën e re të Bilbilfryrësit në përputhje me standardet e Grupit NBG. Politika, së bashku me procedurën përkatëse, përcakton parimet dhe procedurat për paraqitjen e raporteve, ankesave apo komenteve konfidenciale nga çdo palë e interesuar, në mënyrë anonime ose jo. Këto raporte, lidhen kryesisht me sjelljet e ekzekutivëve apo punonjësve që ngrenë shqetësime mbi veprime të parregullta apo të paligjshme në çështjet e kontabilitetit dhe auditimit, të cilat nuk janë në përputhje me parimet dhe rregulloret ndërkombëtare.

Komiteti i Auditit në Bankë është përgjegjës për miratimin dhe monitorimin e vazhdueshëm të zbatimit të këtyre procedurave që ruajnë konfidencialitetin dhe anonimatën e raporteve apo komenteve të marra.

Adresa e emailit të Bankës (info.ac@NBGal.groupNBG.com) shërben si adresë kontakti për paraqitjen e raporteve konfidenciale. Kjo adresë

aksesohet nga Drejtuesi i Përputhshmërisë dhe nga një prej anëtarëve të Komitetit të Auditit.

## Politika e Shpërblimit

Politika e Shpërblimit në Bankë është miratuar nga Këshilli Drejtues më 25 prill 2013 dhe rishikuar në vitin 2015 në përputhje me Politikën e Shpërblimit të Grupit dhe Rregulloren 63/2012 të Bankës së Shqipërisë “Mbi parimet bazë të administrimit të bankave dhe degëve të bankave të huaja dhe kriteret për miratimin e administratorëve të tyre”. Informacion të detajuar në lidhje me këtë gjendet në Seksionin D të këtij raporti.

## ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME DHE TË DREJTAT E AKSIONARËVE

Statuti i Bankës (nenet 12-13) përshkruan modus operandi të Asamblesë së Përgjithshme (AP), të drejtat dhe detyrat kryesore të saj, si dhe të drejtat e aksionarëve. Statuti mund të gjendet në faqen e internetit të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit: [www.qkr.gov.al](http://www.qkr.gov.al).

### Funksionimi dhe përgjegjësitë e Asamblesë së Përgjithshme

Kompetencat: AP është organi më i lartë i vendimmarrjes kolegjiale në Bankë. Rezolutat e ligjshme të saj janë të detyrueshme për të gjithë aksionarët, edhe për ata që mungojnë ose abstenojnë. Të gjithë aksionarët kanë të drejtë të marrin pjesë në AP; ata mund të përfaqësohen nga persona të tjerë, të autorizuar në mënyrën e duhur, në përputhje me dispozitat përkatëse të ligjit. Çdo aksion i jep zotëruesit të tij të drejtën e një vote, siç përcaktohet në ligj. Që prej shndërrimit në një

bankë filial në vitin 2012, Banka ka një aksionar: Bankën Kombëtare të Greqisë sh.a. dhe AP i referohet Asamblesë së Përgjithshme të aksionarit të vetëm.

### AP e Aksionareve është i vetmi organ i shoqërisë që ka të drejtën të vendosë mbi:

- amendimin e Statutit;
- shtrirjen e kohëzgjatjes së veprimtarisë së Bankës, shkriren apo zgjidhjen e Bankës;
- ndryshimin e selisë;
- zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar;
- emetimin e titujve siç përcaktohen në legjislacionin në fuqi;
- emërimin dhe shkarkimin e anëtarëve të Këshillit Drejtues dhe miratimin e shpërblimit të tyre;
- emërimin e ekspertit kontabël të autorizuar dhe anëtarëve të Komitetit të Auditit dhe miratimin e shpërblimit të tyre;
- vendimet mbi shkriren, blerjen dhe likuidimin e Bankës;
- shpërndarjen e fitimit;
- miratimin e Pasqyrave Financiare vjetore të certifikuara nga auditori i pavarur i jashtëm;
- çështje të tjera të përcaktuara shprehimisht në ligjin e zbatueshëm.

### Të drejtat e pakicës

Të drejtat e aksionarëve të pakicës mbrohen në përputhje me dispozitat e zbatueshme të Ligjit Tregtar dhe me ato të Statutit.

Me kërkesë të aksionarëve që përfaqësojnë të paktën 5% të kapitalit aksionar të paguar, Drejtoria e Bankës/Drejtori i Përgjithshëm është i detyruar të thërrasë një mbledhje të jashtëzakonshme të AP e Aksionareve, duke e vendosur datën e saj jo më vonë se 8 ditë nga data kur kërkesa i paraqitet Kryetarit të Këshillit. Kërkesa tregon çështjet e rendit të ditës në përputhje me ligjin e zbatueshëm.



# KËSHILLI DREJTUES DHE ORGANET E TJERA DREJTUESE, ADMINISTRATIVE DHE MBIKËQYRËSE



## Këshilli Drejtues

Banka administrohet nga Këshilli Drejtues (“Këshilli”) që është përgjegjës për drejtimin strategjik, administrimin, mbikëqyrjen dhe kontrollin, me qëllimin final rritjen e vlerës afatgjatë të Bankës dhe mbrojtjen e interesave të shoqërisë në përgjithësi, në përputhje me legjislacionin dhe kuadrin rregullator aktual.

## Përbërja e Këshillit

Këshilli i Bankës përbëhet nga një numër tek anëtarësh, jo më pak se 5, jo më shumë se 9, që zgjidhen nga AP për një mandat jo më të gjatë se 4 vjet. Anëtarët e Këshillit drejtues kanë të drejtën e rizgjedhjes pa kufizim. Shumica e anëtarëve të Këshillit janë individë që në kohën e zgjedhjes dhe gjatë gjithë mandatit të tyre nuk janë të lidhur përmes interesave privatë me Bankën, filialet e saj, bankën mëmë, aksionarët kontrollues, ose Drejtorët Ekzekutivë sipas përkufizimit të dhënë nga Ligji për Bankat. Anëtarët e Drejtorisë, duke përfshirë Drejtorin e Përgjithshëm, mund të jenë anëtarë, me kusht që numri i përgjithshëm i tyre të mos përbëjë shumicën e numrit total të anëtarëve të Këshillit. Banka i kërkon çdo anëtar të paraqesë një deklaratë që konfirmon posedimin e vazhdueshëm të kërkesave të mungesës së konfliktit të interesave, e cila paraqitet çdo vit në Këshill. Vlerësimi i fundit i pavarësisë është kryer në dhjetor 2015. Të gjithë anëtarët, bazuar mbi deklaratat e bëra nga secili prej tyre dhe informacionin e disponuar nga Banka, u gjenden në respektim të kriterëve të mungesës së konfliktit të interesave.

## Anëtarësia/Kualifikimet e Këshillit

Këshilli në detyrë në datën e publikimit të këtij raporti përbëhet nga anëtarët e mëposhtëm:

Këshilli drejtues		Profesioni/përvoja kryesore e punës
Emri		
<b>Konstantinos Bratos</b>		
Pozicioni në Këshill	Kryetar - joekzekutiv	
Data e (ri)zgjedhjes	19.05.2016	
Mbarimi i mandatit	2020	
		Ekonomist. Z. Bratos ka një BSc në ekonomiks nga Universiteti i Pireut, një MSc në Administrimin Ekonomik me Specializim në Administrim Marketingu nga Universiteti i Burgasit (Bullgari). Aktualisht z. Bratos është Ndihmës Drejtor i Përgjithshëm i rikuperimit të Kredive Korporative në NBG International. Ai ka zhvilluar një karrierë të gjatë dhe të shkëlqyer brenda Grupit NBG, duke mbajtur pozicione të nivelit të lartë si Ndihmës Drejtor i Përgjithshëm i Veprimtarive Ndërkombëtare, Kryetar i Këshillit Drejtues të NBG Malta Holdings Ltd, NBG Bank Malta Ltd, Banka NBG Albania, Stopanska Banka AD Shkup dhe NBG Egjipt (rrjeti i degëve), Drejtues Ekzekutiv për Bankingun e Korporatave dhe Biznesit në UBB/ Menaxher i Divizionit të Rrjetit Ndërkombëtar A në NBG, Drejtor i Dytë i Përgjithshëm në Stopanska Banka, Zëvendësdrejtor i Degës së NBG në Boston, Menaxher i Degëve të NBG në Beograd, Sofie dhe Bukuresht. Z. Bratos shërben gjithashtu si Zëvendëskryetar i Këshillit Drejtues të Banca Romaneasca SA dhe Vojvodjanska Banka AD dhe anëtar i Këshillit Drejtues të Bankës së Bashkuar Bullgare. Në fillim të karrierës së vet në NBG ai ka punuar në Divizionin e Auditit dhe në rrjetin e degëve të NBG S.A..
<b>Ioannis Agathos</b>		
Pozicioni në Këshill	CEO/Anëtar	
Data e (ri)zgjedhjes	30.04.2015	
Mbarimi i mandatit	2017	
		Ekonomist. Z. Agathos ka një B.A. në Ekonomiks, diplomë Master në Banking dhe një PhD në Administrim Bankar. Ai ka një karrierë të gjatë dhe të suksesshme në Grupin NBG, duke mbajtur pozicionet e Drejtorit të Përgjithshëm të Operacioneve bankare & Sistemeve IT dhe Drejtorit Ekzekutiv të Korporatave në NBG Qipro, anëtar i Bordit Ekzekutiv i NBG Qipro dhe NBG Management Services., Zëvendës Auditor i Brendshëm i Grupit NBG për bankingun Privat & Korporativ. Z. Agathos ka punuar për shumë vjet si auditor me përvojë të nivelit të lartë në Grupin NBG. Ai është mbajtës i shumë certifikatave trajnimesh dhe specializimesh në shkencat ekonomike, njohurish dhe aftësish në fushat bankare mbi administrimin e produkteve, procesimin, kontabilizimin, korporatat/huadhënien SBB, auditin e brendshëm, administrimin e rrezikut, parandalimin e pastrimit të parave.
<b>Konstantinos Kyriazis</b>		
Pozicioni në Këshill	Zëvendëskryetar	
Data e (ri)zgjedhjes	19.05.2016	
Mbarimi i mandatit	2020	
		Ekonomist. Z. Kyriazis ka një B.A. në ekonomiks. Ai ka një përvojë të gjatë në Grupin NBG ku ka mbajtur pozicione si Sekretar i Komitetit të Auditit, Inspektor, Zëvendësmenaxher dhe Menaxher i Divizionit të Auditit të Brendshëm në NBG S.A.
<b>Dimitrios Vrailas</b>		
Pozicioni në Këshill	Anëtar	
Data e (ri)zgjedhjes	19.05.2016	
Mbarimi i mandatit	2020	
		Matematicien. Z. Vrailas ka një diplomë master shkencor në Sistemet Moderne të Kontrollit. Ai ka një përvojë të gjerë në sistemet bankare, duke punuar si President Ekzekutiv i Ethnodata S.A.(Filial IT i NBG Greqi), Asistent Drejtor i Përgjithshëm në Departamentin e IT.



**Kozeta Sevrani**

Pozicioni në Këshill Anëtare

Fizikante. Zj. Sevrani ka titullin Ass. Profesor dhe PhD in Fizikë. Ajo është aktualisht Shefe e Departamentit të Statistikës dhe Informatikës së Aplikuar në Fakultetin e Ekonomisë të Universitetit të Tiranës. Ajo ka qenë anëtarë e Bordit Mbikëqyrës të INSTAT dhe ka shumë certifikata dhe specializime ndërkombëtare në fushën e saj të praktikës. Zj. Sevrani është organizuese e shumë konferencave ndërkombëtare mbi informatikën e zbatuar dhe një e ftuar e rregullt si lektore e jashtme në universitete të ndryshme ndërkombëtare.

**Sekretari i Këshillit/komiteteve të Këshillit****Jonida Lakuriqi**

Pozicioni në Këshill Drejtuese e Mireadministrimit te Shoqerise

Juriste. Zj. Lakuriqi ka një B.A. në Drejtësi dhe një LL.M. në Drejtën Europiane të Biznesit nga Universiteti i Tiranës. Krahas përvijës së saj në NBG Shqipëri, ajo ka punuar si Drejtuese Ligjore dhe Menaxhere Taksash në Ernst & Young Albania & Kosovo duke themeluar linjën e shërbimeve ligjore në këtë shoqëri për të dy vendet. Gjithashtu, ajo ka mbajtur pozicionin e partneres në zyrën e avokatisë Apicella & Partners, ku dhe ka ofruar shërbime juridike si konsulente e jashtme e Ministrisë së Financave në projekte te rëndesishme koncesionesh publike. Zj. Lakuriqi ka qenë Senior Associate në zyrën e avokatisë Kalo & Associates, në Departamentin e Korporatave & Projekteve duke qenë team leader e disa projekteve të rëndesishme publike dhe private. Ajo është avokate e licencuar, anëtare e Dhomës Shqiptare të Avokatisë që prej vitit 2005. Zj. Lakuriqi ka marrë pjesë në një sere konferenca ndërkombëtare dhe ka publikuar artikuj në revista profesionale dhe juridike ndërkombëtare.

Në përmbushjen e detyrave të tyre, anëtarët e Këshillit respektojnë standardet më të larta etike dhe veprojnë mbi bazën e informacionit të mjaftueshëm, me mirëbesim, me kujdesin dhe përgjegjësinë e duhur, të angazhuar plotësisht ndaj përgjegjësive të tyre dhe në interes të sigurisë dhe qëndrueshmërisë së veprimtarisë bankare dhe financiare, të klientëve dhe të aksionarëve të tyre. Këshilli zgjedh Kryetarin dhe Zëvendëskryetarin e vet. Gjithashtu, Këshilli ka pushtetin e zgjedhjes së Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv të Bankës.

**Përgjegjësitë e Këshillit Drejtues.**

Këshilli Drejtues është përgjegjës për:

- emërimin e Kryetarit dhe Zëvendëskryetarit të Këshillit Drejtues;
- emërimin e Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv;
- përgatitjen e Pasqyrave Financiare për t'iu paraqitur mbledhjes së zakonshme të Asamblesë së Aksionarëve dhe ndarjen e fitimit në bazë të ligjit të zbatueshëm dhe nenit 10 të Statutit;
- hapjen, mbylljen dhe transferimin e degëve dhe zyrave të përfaqësimit;
- blerjen dhe shitjen e pjesëmarrjeve;
- blerjen, shitjen dhe çdo operacion tjetër me aktivet fikse, duke përjashtuar vendimet mbi ato transaksione që janë kompetencë e AP, sic

- përcaktohet shprehimisht nga ligji i zbatueshëm;
- vlerësimin e aktiveve dhe kredive;
- përcaktimin e planeve strategjike;
- miratimin dhe modifikimin e kuadrit të brendshëm rregullator (strategjitë dhe politikat);
- krijimin e komiteteve apo komisioneve;
- çdo çështje tjetër për të cilën është kompetent në përputhje me ligjin e zbatueshëm dhe Statutin.

Këshilli Drejtues mbështetet nga komitetet përgjegjëse që janë krijuar dhe veprojnë për këtë qëllim dhe operacionet e të cilëve janë në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator.

**Emërimi i Drejtorëve/Administratorëve**

Procedura e emërimit dhe kriteret e kualifikimit të drejtorëve/administratorëve të Bankës janë objekt i rregullave të posaçme të vendosura nga Ligji për Bankat dhe nga rregullorja 63/2012 e Bankës së Shqipërisë. Që prej krijimit të tij në tetor 2015, Komiteti për Mirëqeverisjen, Emërimin dhe Shpërblimin është përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të përzgjedhjes dhe propozimit si kandidatë për Këshill të personave që plotësojnë kriteret fit & proper të përcaktuara në rregulloren e sipërpërmendur; emërimi i këtyre personave siguron që Këshilli si organ kolektiv plotëson profilin e kërkuar.

## Frekuenca e mbledhjeve dhe pjesëmarrja e anëtarëve të Këshillit Drejtues

Në bazë të Statutit, mbledhjet e Këshillit zhvillohen të paktën një herë në dy muaj. Në vitin 2015, Këshilli zhvilloi 7 mbledhje.

Sikurse në të shkuarën, pjesëmarrja e anëtarëve të Këshillit ka qenë e qëndrueshme. Në veçanti, gjatë vitit 2015, prania e anëtarëve të Këshillit në mbledhje ishte 100%. Kjo pjesëmarrje në mbledhje siguron kontributin sistematik të të gjithë anëtarëve në drejtimin e veprimtarisë së Bankës, duke lejuar kështu shfrytëzimin e plotë të aftësive profesionale të këtij organi.

Mbledhjet e Këshillit zgjasin mesatarisht 3 orë, kohë kjo e konsideruar e mjaftueshme për përmbushjen e nevojave për trajtimin dhe diskutimin e plotë të çështjeve në rendin e ditës; kjo dhe nga pikëpamja e informacionit të duhur përpara dhe gjatë mbledhjes dhe numrit të mbledhjeve të mbajtura.

Në vitin 2016, Këshilli ka zhvilluar 3 mbledhje në datën e miratimit të këtij raporti.

## Vetëvlerësimi vjetor i Këshillit

Këshilli dhe Komiteti i Auditit kryejnë, me baza vjetore, një vetëvlerësim performance për efektivitetin e punës së tij si organ kolegjal dhe vlerësimi në aftësive, përvojës dhe njohurive të çdo anëtari. Vetëvlerësimet kryen mbi bazën e pyetësorëve, që konsistojnë në një përshkrim të çështjeve që mbulojnë të gjitha aspektet e veprimtarisë së Këshillit dhe të Komitetit të Auditit.

## Komitetet e Këshillit: përbërja dhe funksionimi

Në lidhje me detyrat e tyre të posaçme, komitetet e

brendshme të Këshillit luajnë një rol të rëndësishëm në kërkimin, analizën dhe studimin e thelluar të çështjeve të propozuara në Këshill. Këto veprimtari lehtësojnë përmbushjen e detyrave, duke e çuar në vendimarrje më të arsyetuar, pa kufizuar pushtetet dhe përgjegjësitë e Këshillit dhe duke rritur efektivitetin dhe eficiencën e punës së tij.

Në krijimin e komiteve, Këshilli ka marrë parasysh kërkesat e pavarësisë dhe karakteristikat profesionale dhe përvojën e anëtarëve të tij, në mënyrë që kompetencat dhe aftësitë profesionale të anëtarëve të çdo komiteti të jenë ato të duhura për detyrat e ngarkuara; kështu sigurohet përmbushja e detyrave në kohën e duhur.

Veprimtaritë e çdo komiteti bashkërendohen dhe drejtohen nga një kryetar i caktuar nga Këshilli. Detyrat e komiteve përcaktohen në rregullore të posaçme.

Këshilli ka krijuar komitetet e mëposhtme:

### Komiteti i Auditit

Komiteti i Auditit është krijuar në 29 qershor 2012 dhe funksionon në përputhje me dispozitat e Ligjit për Bankat (nenet 33 dhe 38). Anëtarët e Komitetit zgjidhen nga AP, ndërsa Kryetari caktohet nga Këshilli. Komiteti përbëhet nga 3 anëtarë, dy prej të cilëve janë të pavarur dhe njeri është joekzekutiv. Një prej anëtarëve vepron si këshilltar financiar në çështjet e lidhura me IFRS dhe kërkesat e GAAP vendor. Anëtarët e Komitetit caktohen me një mandat katërvjeçar, i cili mund të rinovohet pa kufizim.

Komiteti i Auditit në detyrë në kohën e publikimit të këtij raporti përbëhet nga anëtarët e mëposhtëm:

Komiteti i Auditit		
Emri	Pozicioni në komitet	Profesioni/përvoja e punës
<b>Konstatinos Kyriazis</b>	Kryetar i pavarur	Siç përcaktohet në tabelën më sipër.
Data e (ri)zgjedhjes	18.06.2016	
Mbarimi i mandatit	2020	

<b>Anastasios Lizos</b>	Anëtar joekzekutiv	Zotëron diplomë MBA në Bankingun Financiar, Certifikatë in Auditin e Brendshëm Bankers Trust N.Y (3/96), Auditin e Brendshëm KPMG (5/96), NPL's Programi Bankar Inter-Alpha France (5 dhe 11/2006). Z. Lizos ka një karrierë të gjatë me Grupin NBG ku ka mbajtur pozicione të tilla si Zëvendës drejtor në Divizionin e Rrjetit Ndërkombëtar A/B/ auditor i brendshëm. Ai është drejtor i pavarur në Stopanska Banka, NBG Leasing d.o.o (Kryetar i Komitetit të Auditit), UBB, Voivodanska Banka Serbi (anëtar i Komitetit të Rrezikut), SABA, (Komiteti i Shpërblimit), NBG Bank Maltë, Interlease Bulgari.
Data e (ri)zgjedhjes	30.06.2016	
Mbarimi i mandatit	2020	
<b>Teit Gjini</b>	Anëtar, i pavarur, ekspert financiar	Zotëron BA në Finance/Kontabilitet nga Universiteti i Tiranës. Ai është ekspert kontabël i autorizuar dhe partner drejtues dhe audit i MAZARS Albania, shoqëri ndërkombëtare Audit & Konsulencë, anëtar i Bordit të Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar, Shqipëri, anëtar i Bordit Mbikëqyrës të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, auditor i brendshëm i Bankës Ndërkombëtare Tregtare, Shqipëri, CFO i Eurovia dhe lektor i brendshëm i kontabilitetit të drejtimit në Fakultetin e Ekonomisë së Universitetit të Tiranës.
Data e (ri)zgjedhjes	22.09.2012	
Mbarimi i mandatit	2016	

Në vitin 2015, Komiteti i Auditit është mbledhur 4 herë me pjesëmarrje të plotë të të gjithë anëtarëve. Gjatë vitit, Komiteti ka: (i) shqyrtuar Pasqyrat Financiare tremujore dhe vjetore të Bankës; (ii) monitoruar mbi baza tremujore dhe vlerësuar mbi baza vjetore funksionimin e Divizionit të Auditit të Brendshëm në Bankë; (iii) ka vlerësuar mjaftueshmërinë e sistemeve të auditit të brendshëm në përputhje me kuadrin rregullator të Bankës së Shqipërisë dhe të Grupit, duke siguruar pavarësinë, objektivitetin dhe efektivitetin e operacioneve të tij; (iv) propozuar Këshillit emërimin e Ernst & Young si auditori jashtëm; (v) thirrur për të dëgjuar Menaxherin e Përputhshmërisë mbi çështjet AML/CFT; dhe (vi) vlerësuar dhe paraqitur Këshillit Kodin e Etikës së Financiereve Profesioniste dhe ka rishikuar Kartën e Divizionit të Auditit të Brendshëm.

Në bazë të vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të datës 16.5.2016, mandati i dy anëtarëve, z. Kyriazis dhe z. Lizos është rinovuar deri më 18.5.2020.

Gjatë vitit 2016, Komiteti ka zhvilluar dy mbledhje deri në datën e miratimit të këtij raporti.

Një informacion më i detajuar mbi përbërjen, përgjegjësitë dhe modus operandi të Komitetit përfshihen në Kartën e Komitetit.

### Komiteti i Administrimit të Rrezikut

Në dhjetor 2015, Komiteti i Administrimit të Rrezikut rishikoi Kartën dhe përbërjen e tij në përputhje me standardet e Grupit dhe Bazelit; struktura u

rikompozua me 3 anëtarë, një prej të cilëve është i pavarur dhe një është joekzekutiv. Kryetari dhe anëtarët e Komitetit zgjidhen nga Këshilli. Komiteti ka një të ftuar të përhershëm z. Georgios Panousis, një ekspert rreziku me përvojë të gjerë në administrimin e rrezikut dhe të kapitalit si dhe familjaritet me kuadrin rregullator të zbatueshëm të Grupit. Informacion i detajuar për përgjegjësitë e këtij Komiteti gjendet në Kartën e Komitetit.

### Komiteti i Miradministrimit, Emërimeve dhe Shpërblimit

Komiteti i Miradministrimit, Emërimeve dhe Shpërblimit është krijuar në vitin 2015 në përputhje me kuadrin rregullator vendas, standardet e Grupit NBG mbi parimet e miradministrimit të shoqërisë. Kryetari dhe anëtarët e këtij komiteti caktohen nga Këshilli për një mandat njëvjeçar me të drejtë rizgjedhjeje të pakufizuar. Komiteti përbëhet nga tre anëtarë joekzekutivë, dy prej të cilëve janë të pavarur. Veprimtaria e këtij komiteti konsiston në: (i) ndihmesën e Këshillit në vlerësimin/shpërblimin e anëtarëve ekzekutivë të Këshillit, administratorëve dhe drejtuesve të njësive të mëdha të Bankës; (ii) planifikimin dhe bashkërendimin e procesit të përzgjedhjes së kandidatëve për anëtarë Këshilli dhe drejtorë ekzekutivë të Bankës; (iii) sigurimin e vlerësimit të përputhshmërisë me kuadrin e zbatueshëm rregullator mbi miradministrimin.

Konstantinos Bratos	Kryetar	Joekzekutiv
Kozeta Sevrani	Anëtar	I pavarur
Dimitrios Vrailas	Anëtar	I pavarur

Në vitin 2016, Komiteti ka zhvilluar një mbledhje në datën e miratimit të këtij raporti.

Informacion të detajuar mbi përgjegjësitë e këtij komiteti përfshihet në Kartën e Komitetit.

## Organet drejtuese dhe administrative të Bankës

Organet kryesore drejtuese dhe administrative të Bankës kumarrin pjesë anëtarët ekzekutivë të Këshillit përfshijnë Komitetin Ekzekutiv, ALCO, Komitetin Ekzekutiv të Kredisë, Komitetin e Provigjioneve dhe Fshirjeve, Komitetin e Administrimit të Rrezikut dhe Komitetin e Ngjarjeve të Rrezikshme.

## Komiteti Ekzekutiv

Komiteti Ekzekutiv i Bankës është organi më i lartë që mbështet Drejtorin e Përgjithshëm në ushtrimin e detyrave. Komiteti Ekzekutiv ka pushtete strategjike dhe ekzekutive në lidhje me funksionimin eficient të Bankës dhe monitorimin e ekzekutimit të strategjisë, si dhe autoritet miratues që nuk mund t'i delegohet anëtarëve të drejtimit të Bankës ose organeve të tjera kolegjiale.

Në datën e publikimit të këtij raporti, Komiteti përbëhej nga anëtarët e mëposhtëm:

Emri	Pozicioni në ExCo	Profesioni/përvoja e punës
<b>Ioannis Agathos</b>	Kryetar, CEO	Siç përcaktohet në tabelën e anëtarësisë së Këshillit drejtues më sipër.
<b>Ioannis Antoniadis</b> Data e zgjedhjes	Anëtar, Drejtues Ekzekutiv i Riskut 2015	Z. Antoniadis është Drejtor Ekzekutiv i Riskut i NBG Albania. Përpara së t'i bashkohej NBG Albania në 2007 si Menaxher i Kredisë së Korporatave dhe më pas si Manaxher i Marredhenieve për kompanitë e mëdha në Qendrën e Kredisë në NBG Selanik. Z. Antoniadis është diplomuar për Gjeologji nga Universiteti Aristotel i Selanikut; ai ka një MBA në Banking nga Universiteti i Maqedonisë në Selanik dhe një MBA në Banking nga Open University i Patras. Ai ka marrë pjesë në seminare dhe trajnime të ndryshme në sistemet e administrimit financiar, analizën e kredisë, administrimin e financave të korporatave dhe strategjitë e administrimit të rrezikut të kredisë, administrimin e NPL, etj.
<b>Brunilda Papa (Jakovi)</b> Data e zgjedhjes	Anëtar, Drejtuese Ekzekutive Finances/ Operacioneve 2012	Zj. Papa ka një BA në Financë/Kontabilitet, dhe një MBA në Financë Banking nga University of New York në Tiranë. Zj. Papa ka një karrierë të gjatë që prej krijimit të NBG Albania, ku ka mbajtur pozicione si drejtuese, Menaxhere e Departamentit të Financës & Kontabilitetit. Zj. Papa është përfshirë në të gjithë projektet kryesore të Bankës për implementimin e sistemeve në Bankë. Ajo ka marrë pjesë në shumë seminare dhe trajnime në sistemet e administrimit financiar. Ajo është anëtare e të gjithë komiteteve vendimmarrëse të Bankës.
<b>Aida Apostoli (Tirana)</b> Data e zgjedhjes	Anëtare, Drejtuese Ekzekutive e Bankingut Individual 2012	Zj. Apostoli mban pozicionin e Drejtueses së Bankingut Individual në Bankën NBG Shqipëri që prej korrikut 2011. Përpara kësaj detyre, ajo ka qenë Drejtoreshe e Rrjetit dhe e Shitjeve në NBG Bank Shqipëri, duke filluar nga marsi 2007. Pozicione të tjera të mbajtura brenda Bankës NBG Shqipëri kanë qenë menaxhere dege dhe auditorë e brendshme. Përpara së t'i bashkohej sistemit bankar (në 1996) zj. Apostoli ka punuar për më se një dekadë si pedagoge fizike në një prej universiteteve shtetërore të Tiranës. Zj. Apostoli ka një MBA (2005), një diplomë në Fakultetin Juridik dhe një Diplomë në Fizikë nga Universiteti i Tiranës.



**Anastasios Asimakopoulos**  
Data e zgjedhjes

Anëtar, Drejtues Ekzekutiv i Bankingut Korporativ 2014

Ekonomist. Z. Asimakopoulos është caktuar CCO i Bankës NBG që prej janarit 2014, përgjegjës për administrimin dhe mbikëqyrjen e portofolit tregtar (SME) dhe të korporatave të Bankës. Ai është anëtar i të gjithë komiteteve vendimmarrëse të Bankës. Z. Asimakopoulos ka një përvojë të gjatë brenda Grupit NBG, si auditor i sektorit të auditit të kredisë (prej 2007), i specializuar në auditimin e të gjithë akseptëve të procedurës së financimit për portofolin e SME dhe korporatave të Grupit, në vijim të detyrës së mbajtur si analist kredie për portofolin e SME. Z. Asimakopoulos ka një BSc në Ekonomiks nga Universiteti i Ekonomiksit dhe Biznesit i Athinës, një MBA nga University of Wales, Cardiff Business School. Që prej 2009, ai është gjithashtu anëtar i Institutit Grek të Auditorëve të Brendshëm.

## Komiteti i Administrimit të Aktiveve dhe Detyrimeve (ALCO)

Qëllim kryesor i ALCO është përcaktimi i strategjisë dhe politikës së sektorit financiar të Bankës në lidhje me çështjet që lidhen me strukturimin dhe administrimin e aktiveve dhe detyrimeve, duke marrë parasysh kuadrin rregullator dhe kushtet e tregut, si dhe kufijtë e rrezikut të vendosura nga Banka. Komiteti, në datën e publikimit të këtij raporti, përbëhet nga të gjithë anëtarët e ExCo dhe nga Drejtori i Thesarit, z. Niko Kotonika.

## Komiteti i Administrimit të Ngjarjeve të Rrezikshme

Komiteti i Administrimit të Ngjarjeve të Rrezikshme synon: (i) bashkërendimin efektiv të veprimeve të nevojshme për të trajtuar situatat e paparashikuara që mund të rrezikojnë funksionimin e qetë të Bankës; (ii) informimin, mobilizimin dhe bashkërendimin e njësive përkatëse duke marrë parasysh natyrën, shtrirjen dhe madhësinë e krizës; dhe (iii) zgjidhjen e problemeve që kërkojnë vëmendje të menjëhershme. Komiteti përbëhet nga Drejtimi Ekzekutiv i Bankës si dhe drejtues të tjerë kyç nga disa divizione të

Bankës. Komiteti mbledhet kur është e nevojshme, me ftesë të kryetarit.

## Komitetet e kredisë në Bankë

Veprimtaria e kredisë në Bankë administrohet nga një sistem me pesë nivele komitetesh kredie, i përshkallëzuar sipas diskrecionit në shumën e lehtësisë së kredisë.

## Komiteti i Këshillit Drejtues për Kredinë

Fusha e veprimit të këtij komiteti është miratimi i lehtësive të kredive nga EUR 5 milionë deri në EUR 200 milionë, me propozim të Komitetit Ndërkombëtar të Kredisë së Korporatave të Grupit NBG (KNKK). Komiteti përbëhet nga të gjithë anëtarët e Këshillit Drejtues.

## Komiteti Ekzekutiv i Kredisë së Korporatave

Ky komitet është krijuar në korrik 2012 dhe qëllimi i tij është miratimi i lehtësive të kredive nga EUR 1.01 milion deri në EUR 4.99 milionë. Në datën e publikimit të këtij raporti, Komiteti përbëhet nga këta anëtarë:

Kryetar	Ioannis Agathos	CEO
Anëtar	Ioannis Kagioulis	Drejtore i departamentit të kredisë të Grupit ndërkombëtar NBG (me fuqi vetoje)
Anëtar	Theodoros Saidanis	Përfaqësues i departamentit të veprimtarive ndërkombëtare të NBG
Anëtar	Ioannis Antoniadis	Drejtues Ekzekutiv i Riskut
Anëtar	Anastasios Asimakopoulos	Drejtues Ekzekutiv i Bankingut të Korporatave

## Komiteti i Kredive të Korporatave

Komiteti i Kredive të Korporatave është krijuar në korrik 2012 dhe fusha e veprimtarisë së tij është miratimi i lehtësive të kredive nga EUR 300,001 deri në EUR 1 milion. Në datën e publikimit të këtij raporti, Komiteti përbëhet nga anëtarët e mëposhtëm:

Kryetar	Ioannis Agathos	CEO
Anëtar	Ioannis Antoniadis	Drejtues Ekzekutiv i Riskut (me fuqi vetoje)
Anëtar	Anastasios Asimakopoulos	Drejtues Ekzekutiv i Bankingut Korporativ

Një përfaqësues i Departamentit Ndërkombëtar të Kredisë në Grupin NBG merr pjesë në vendimmarrjen e Komitetit për: (i) të gjitha ekspozimet nga EUR 0,75 milion deri në EUR 1 milion; dhe (ii) të gjitha lehtësitë në përgjegjësi të Komitetit të klasifikuara në kategorinë GB të rrezikut të brendshëm.

## Komiteti i Kredisë Tregtare

Fusha e veprimtarisë së komitetit të kredisë tregtare është miratimi i lehtësive të kredive deri në EUR 300,000. Në datën e publikimit të këtij raporti, komiteti përbëhet nga anëtarët e mëposhtëm:

Kryetar	Ioannis Antoniadis	Drejtues Ekzekutiv i Riskut (me fuqi vetoje)
Anëtar	Anastasios Asimakopoulos	Drejtues Ekzekutiv i Bankingut Korporativ
Anëtar	Aida Apostoli	Drejtuese Ekzekutive e Bankingut Individual

## SHPËRBLIMI I KËSHILLIT DHE I KOMITETEVE TË KËSHILLIT

### Politika e shpërblimit në Bankën NBG Albania

Politika e shpërblimit e Bankës NBG Albania është hartuar nga burimet njerëzore në bashkëpunim me departamentet e Përputhshmërisë dhe Miradministrimit të Bankës. Politika është në përputhje me udhëzuesit dhe parimet e Grupit NBG dhe është miratuar nga Këshilli Drejtues. Politika e shpërblimit zbatohet ndaj të gjithë punonjësve të Bankës në qendër dhe në rrjetin e degëve.

### Objektivat kryesorë të Politikës së shpërblimit janë:

- të sigurojë së Banka vepron në përputhje të plotë me kuadrin rregullator vendas mbi shpërblimet;
- të sigurojë implementimin e udhëzuesve dhe parimeve bazë të Grupit;
- të ndajë procedurat dhe përgjegjësitë përkatëse dhe implementimin e duhur të tyre;
- të sigurojë transparencë në lidhje me shpërblimin e personelit të Bankës;
- të minimizojë rreziqet potencialë të shkaktuara gjatë implementimit të parimeve të shpërblimit

të personelit të identifikuar në këtë politikë. Politika e shpërblimit të Drejtuesve të lartë zbatohet ndaj kategorive të mëposhtme të personelit:

- anëtarëve joekzekutivë të Këshillit Drejtues dhe anëtarëve të Komitetit të Auditit;
- anëtarëve të Komitetit Ekzekutiv;
- funksioneve të pavarura të kontrollit: Drejtuesit të Auditit të Brendshëm, Drejtuesit të Miradministrimit dhe Menaxherit të Përputhshmërisë;
- ekzekutivëve të tjerë veprimtaritë profesionale të të cilëve kanë një impakt material mbi profilin e rrezikut të Bankës: menaxhereve të Burimeve Njerëzore, Ligjorit, IT dhe Thesarit.

Struktura e shpërblimit për personelin e Bankës NBG Shqipëri përbëhet nga përbërës fiks dhe variabël:

- përbërësit fiks përfaqësojnë një proporcion mjaftueshmërisht të lartë të totalit të shpërblimit krahasuar me përbërësit variabël dhe përfshijnë: (i) cash fiks; (ii) aksione\* fikse; dhe (iii) instrumente të tjerë fikse.
- përbërësit variabël janë të përshtatshëm me kushtet e tregut dhe natyrën e punës për të cilën paguhet dhe përfshijnë: (i) cash variabël; (ii) aksione\* variabël; dhe (iii) instrumente të tjera variabël. Gjatë vitit 2015, asnjë shpërblim nuk është paguar në aksione apo në ndonjë instrument tjetër përveç cash-it.
- shpërblimi variabël paguhet vetëm i kushtëzuar nga pozicioni financiar i përgjithshëm i Bankës

dhe justifikohet sipas performancës si Bankës dhe të njësisë së përfshirë.

### **Shpërblimi i anëtarëve të Këshillit, Drejtorëve Ekzekutivë dhe Administratorëve**

Shpërblimi i CEO është në përputhje me politikën e shpërblimit të Bankës dhe të Grupit, si dhe me praktikat më të mira të industrisë. Kjo në mënyrë që të reflektojë mjaftueshëm kohën dhe përpjekjet e CEO për të kontribuar në punën e Këshillit dhe Komiteteve të tij dhe njëkohësisht të administrojë veprimtarinë e përditshme dhe operacionet e Bankes.

## **SHPËRBLIMI I KËSHILLIT DHE I KOMITETEVE TË KËSHILLIT**

### **Politika e shpërblimit në Bankën NBG Albania**

Politika e shpërblimit e Bankës NBG Albania është hartuar nga burimet njerëzore në bashkëpunim me departamentet e Përputhshmërisë dhe Miradministrimit të Bankës. Politika është në përputhje me udhëzuesit dhe parimet e Grupit NBG dhe është miratuar nga Këshilli Drejtues. Politika e shpërblimit zbatohet ndaj të gjithë punonjësve të Bankës në qendër dhe në rrjetin e degëve.

### **Objektivat kryesorë të Politikës së shpërblimit janë:**

- të sigurojë së Banka vepron në përputhje të plotë me kuadrin rregullator vendas mbi shpërblimet;
- të sigurojë implementimin e udhëzuesve dhe parimeve bazë të Grupit;
- të ndajë procedurat dhe përgjegjësitë përkatëse dhe implementimin e duhur të tyre;
- të sigurojë transparencë në lidhje me shpërblimin e personelit të Bankës;
- të minimizojë rreziqet potencialë të shkaktuara gjatë implementimit të parimeve të shpërblimit të personelit të identifikuar në këtë politikë.

Politika e shpërblimit të Drejtuesve të lartë zbatohet ndaj kategorive të mëposhtme të personelit:

- anëtarëve joekzekutivë të Këshillit Drejtues dhe anëtarëve të Komitetit të Auditit;
- anëtarëve të Komitetit Ekzekutiv;
- funksioneve të pavarura të kontrollit: Drejtuesit të Auditit të Brendshëm, Drejtuesit të Miradministrimit dhe Menaxherit të Përputhshmërisë;
- ekzekutivëve të tjerë veprimtaritë profesionale të të cilëve kanë një impakt material mbi profilin e rrezikut të Bankës: menaxhereve të Burimeve Njerëzore, Ligjorit, IT dhe Thesarit.

Struktura e shpërblimit për personelin e Bankës NBG Shqipëri përbëhet nga përbërës fiks dhe variabël:

- përbërësit fiks përfaqësojnë një proporcion mjaftueshëm të lartë të totalit të shpërblimit krahasuar me përbërësit variabël dhe përfshijnë: (i) cash fiks; (ii) aksione\* fikse; dhe (iii) instrumente të tjerë fikse.
- përbërësit variabël janë të përshtatshëm me kushtet e tregut dhe natyrën e punës për të cilën paguhen dhe përfshijnë: (i) cash variabël; (ii) aksione\* variabël; dhe (iii) instrumente të tjera variabël. Gjatë vitit 2015, asnjë shpërblim nuk është paguar në aksione apo në ndonjë instrument tjetër përveç cash-it.
- shpërblimi variabël paguhet vetëm i kushtëzuar nga pozicioni financiar i përgjithshëm i Bankës dhe justifikohet sipas performancës si Bankës dhe të njësisë së përfshirë.

### **Shpërblimi i anëtarëve të Këshillit, Drejtorëve Ekzekutivë dhe Administratorëve**

Shpërblimi i CEO është në përputhje me politikën e shpërblimit të Bankës dhe të Grupit, si dhe me praktikat më të mira të industrisë. Kjo në mënyrë që të reflektojë mjaftueshëm kohën dhe përpjekjet e CEO për të kontribuar në punën e Këshillit dhe Komiteteve të tij dhe njëkohësisht të administrojë veprimtarinë e përditshme dhe operacionet e Bankes.

Gjatë vitit 2015 asnjë shpërblim (fiks apo variabël) nuk u është dhënë Kryetarit dhe anëtarëve ekzekutivë të Këshillit, ndërsa shpërblimi i anëtarëve të pavarur joekzekutivë është një pagesë fikse që nuk përfshin ndonjë bonus apo pjesëmarrje në aksione në përputhje me Politikën e shpërblimit të Bankës dhe vendimet e AP.

AP e Aksionareve, me propozim të Këshillit, miraton shpërblimin e anëtarëve të pavarur të Këshillit dhe të Komitetit të Auditit për vitet vijues financiare, përveçse kur vendoset ndryshe nga AP e Aksionareve.

Në 2015, anëtarëve të pavarur të Këshillit dhe të Komitetit të Kontrollit u është paguar një tarifë fikse

për pjesëmarrje në mbledhje. Skema e shpërblimit nuk parashikon ndonjë kompensim tjetër shtesë në formën e bonuseve apo pjesëmarrjes në aksione.

Tabela e mëposhtme përshkruan kompensimet e Këshillit dhe komiteteve të Këshillit për mbledhjet gjatë vitit 2015, si dhe shpërblimin e ekzekutivëve dhe administratorëve të Bankës.

	Anëtarët e pavarur të Këshillit dhe të komitetit të auditit	Anëtarët e Komitetit ekzekutiv	Funksionet e pavarura të kontrollit	Ekzekutivë të tjerë
Numri	4	5	3	4
Shpërblimi vjetor fiks në total (në EUR):	14,500	267,427	110,995	88,386
fiks në cash	14,500	267,427	110,995	88,386
fiks në aksione dhe në instrumente të lidhura me to	-	-	-	-
fiks në lloje të tjerë instrumentesh	-	-	-	-
Shpërblimi vjetor variabël në total (në EUR):	-	-	-	-
variabël në cash	-	-	-	-
variabël në aksione dhe në instrumente të lidhura me to	-	-	-	-
variabël në lloje të tjerë instrumentesh	-	-	-	-

## SISTEMET E KONTROLLIT TË BRENDSHËM DHE ADMINISTRIMIT TË RREZIKUT

### Tiparet kryesore të sistemit të kontrollit të brendshëm

Duke synuar garantimin e një reputacioni të mirë dhe besueshmërisë nga aksionarët, klientët, investitorët, autoriteti mbikëqyrës dhe autoriteteve të tjera të pavarura rregullatore, Banka ka forcuar vazhdimisht Sistemin e Kontrollit të Brendshëm (SKB). SKB i referohet serisë së kontrolleve të vazhdueshme-

te automatizuara, gjysme te automatizuara dhe kontrollet manuale si dhe proceseve që mbulojnë të gjitha veprimtaritë; ai është dizenuar për të siguruar që Banka dhe Grupi operojnë efektivisht. SKB synon përmbushjen e objektivave kryesore të mëposhtëm:

- Implementim konsistent të strategjisë së biznesit të Grupit përmes përdorimit eficient të burimeve në dispozicion;
- Identifikimin dhe administrimin e rreziqeve të marra përsipër, dhe ne pergjithesi te risqeve qe Bankave eshte e ekspozuar;
- Plotësinë dhe besueshmërinë e të dhënave, shifrave dhe informacionit të nevojshëm për përcaktimin e saktë dhe në kohën e duhur të pozicionit financiar të Grupit dhe prodhimin



- e pasqyrave financiare të besueshme për depozitim tek autoritetet shqiptare dhe të huaja;
- Përputhshmërinë me kuadrin institucional vendor dhe ndërkombëtar që rregullon operimin e Bankës dhe të Grupit, duke përfshirë rregullohet e brendshme, sistemet e IT dhe kodin e etikës.
- Miratimin e praktikave më të mira të miradministrimit;
- Parandalimin dhe shmangien e çdo gabimi dhe parregullsie që mund të rrezikojë reputacionin dhe interesin e Bankës, aksionarëve dhe klientëve.

Këshilli, me ndihmën e komiteteve, në kontekstin e shqyrtimit të strategjisë së korporatës dhe rreziqeve të mëdha të biznesit, miraton politika që sigurojnë një SKB të duhur dhe efektiv për Bankën dhe Grupin. Administrimi është përgjegjës për krijimin dhe ruajtjen e kontrolleve dhe procedurave të duhura, në varësi të natyrës së veprimtarive dhe rreziqeve të marra përsipër, për të vlerësuar mangësitë e SKB dhe për të ndërmarrë veprimet e nevojshme korrigjuese.

Auditi i Brendshëm, i cili raporton direkt në Këshillin drejtues nepermjet Komitetit të Kontrollit ploteson kuadrin e administrimit të riskut duke u fokusuar në efektivitetin e mjedisit të kontrollit dhe dorezon në Komitetin e Kontrollit një raport të vecantë vjetor mbi integritetin dhe efikasitetin e SKB.

Në baze tremujore dhe vjetore Divizioni i Kontrollit të Brendshëm raporton në Njesinë e Auditit të Brendshëm të Grupit aktivitetin e tij dhe rezultatet e kontrolleve të kryera.

### **Kuadri i Administrimit të Rrezikut**

Banka synon të miratojë praktika në lidhje me qeverisjen e administrimit të rrezikut, duke marrë parasysh të gjitha udhëzimet dhe kriteret rregullatore të vendosura nga Banka e Shqipërisë dhe nga Grupi. Kuadri i Administrimit të Rrezikut përfshin një numër përbërësish të ndryshëm. Në veçanti, Këshilli ka krijuar Komitetin e Rrezikut që mbikëqyr të gjithë funksionet e administrimit të rrezikut në Bankë. Njësia e Administrimit të Rrezikut raporton dhe mbikëqyr nga Drejtuesi Ekzekutiv i Bankës, i cili raporton të Komiteti i Administrimit të Rrezikut.

ALCO përcakton udhëzimet e përgjithshme për administrimin e aktiveve dhe detyrimeve. ALCO përcakton strategjinë dhe politikën e Bankës në

çështjet e lidhura me strukturimin dhe administrimin e aktiveve dhe detyrimeve duke marrë parasysh kushtet aktuale të tregut dhe kufijtë e rreziqeve të vendosura nga Banka.

Auditi i Brendshëm vepron edhe si një shqyrtues i pavarur, i fokusuar tek efektiviteti i kuadrit të administrimit të rrezikut dhe mjedisit të kontrollit.

### **Përputhshmëria rregullatore dhe mirëqeverisja**

Departamenti i Përputhshmërisë është funksionalisht i pavarur nga njësitë e tjera të Bankës dhe është përgjegjës për monitorimin dhe kontrollin e rregullt të çështjeve dhe raporteve që kanë të bëjnë me përputhshmërinë ligjore dhe rregullatore në Bankë. Ky departament siguron parandalimin në kohën e duhur të shkeljeve potenciale të rregullave dhe akteve, mbikëqyr implementimin e politikave të tilla si ajo në lidhje me parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit, konfliktin e interesave të administratorëve, antikorrupsionin dhe politikat e miratuara në përputhje me ligjin për AML.

Raporti vjetor mbi aktivitetin dhe operacionet e Divizionit të Përputhshmërisë i paraqitet Divizionit të Përputhshmërisë së Grupit NBG.

Menaxheri i Departamentit të Përputhshmërisë raporton të Këshilli Drejtues dhe të Drejtorit të Përgjithshëm.

Divizioni i Mirëqeverisjes së Shoqërisë (Corporate Governance) përfshin Sekretariatit e Këshillit dhe komiteteve të Këshillit dhe miradministrimin në Bankë. Fusha e veprimtarisë së tij është përafrimi dhe përshtatja e kriterëve aktuale rregullatore në nivelin kombëtar dhe atë të Grupit, nisur nga rëndësia e rritur që çështjet e miradministrimit marrë gjatë dekadës së fundit në administrimin e shëndetshëm të Bankës. Që prej krijimit, Divizioni i Mirëadministrimit të Shoqërisë ka mbështetur Bankën dhe në veçanti Këshillin në krijimin dhe përmirësimin e organeve drejtuese dhe komiteteve, monitorimin dhe mbikëqyrjen e çështjeve të lidhura me miradministrimin, projektet/ çështjet sensitive për Këshillin dhe marrëdhënien me autoritetet mbikëqyrëse. Drejtuesi i Mirëadministrimit të Shoqërisë, i cili vepron edhe si lehtësues dhe këshilltar i Këshillit dhe i Drejtorit të Përgjithshëm, raporton të Drejtorit të Përgjithshëm dhe të Këshilli Drejtues. Gjithashtu, ky funksion i ofron mbështetje dhe garanton kontakte me organet e shoqërisë me përgjegjësi për administrimin e Bankës për të gjitha çështjet me interes për Këshillin. Në përmbushjen e

detyrave të veta, Divizioni i Qeverisjes së Shqerise ndërvepron me departamentet e tjera të Bankës dhe të Grupit.

Raporti i plote vjetor në formën e deklaratës së Qeverisjes së Shoqerise mbi aktivitetet e organeve Dretjuese të Bankës i paraqitet Këshillit Drejtues dhe AP të Aksionareve të Bankës.

### **Administrimi i rrezikut e lidhur me procesin e përgatitjes së Pasqyrave Financiare**

Administrimi është përgjegjës për krijimin dhe ruajtjen e Kontrollleve të mjaftueshme të Brendshme mbi Raportimin Financiar (KBRF). Këto ofrojnë siguri të arsyeshme mbi besueshmërinë e pasqyrave financiare dhe raporteve që përgatiten në përputhje me parimet përgjithësisht të pranueshme të kontabilitetit. Politikat dhe procedurat e Bankës ofrojnë siguri të arsyeshme që transaksionet regjistrohen siç kërkohet, faturat dhe shpenzimet bëhen vetëm me autorizimin e administrimit dhe çdo blerje, përdorim apo disponim i paautorizuar i aktiveve të Bankës parandalohet apo zbulohet në kohën e duhur. Këto politika dhe procedura mbështeten nga sistemet e duhura të IT dhe kontabilitetit.

Komiteti i Auditit është përgjegjës për monitorimin dhe vlerësimin vjetor të mjaftueshmërisë dhe efektivitetit të KBRF në Bankë, mbështetur mbi raportet e paraqitura nga Departamenti i Financës dhe nga auditorët e jashtëm. Komiteti i Auditit monitoron procesin e përgatitjes së Pasqyrave Financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (IFRS) dhe Parimet e Kontabilitetit të Pranuar Gjerësisht në Shqipëri (GAAP vendor); Komiteti i raporton Këshillit. Gjithashtu Komiteti i Auditit monitoron progresin e veprimeve korigjuese të ndërmarra në kontekstin e Kontrollleve të Brendshme mbi Raportimin Financiar.

Auditi i Brendshëm (AB) është i pavarur administrativisht nga njësitë e tjera të Bankës. Drejtuesi i Auditit të Brendshëm emërohet/shkarkohet nga Këshilli, mbështetur mbi propozimin e Komitetit të Auditit dhe me rekomandimin e Drejtuesit Ekzekutiv të Grupit. Emërimi apo shkarkimi i komunikohet Bankës së Shqipërisë. Drejtuesi i Auditit të Brendshëm raporton mbi veprimtaritë e AB të Drejtori të Përgjithshëm, Komiteti i Auditit dhe të Këshilli, përmes këtij të fundit, në mënyrë tremujore. Ai mban gjithashtu një linjë raportimi të Drejtuesit Ekzekutiv të Grupit NBG. AB kryen vlerësime sistematike të sistemeve të kontrollit të brendshëm

në Bankë, për të vlerësuar mjaftueshmërinë dhe efektivitetin e kuadrit të administrimit të rrezikut dhe mirëqeverisjes të vendosura nga administrimi.

Auditori i jashtëm, përgjatë vitit financiar, raporton të Komiteti i Auditit çdo mangësi të madhe ose dobësi materiale të identifikuar në KBRF gjatë auditit. Komiteti i Auditit i propozon Këshillit Drejtues veprimet e nevojshme korigjuese dhe monitoron implementimin e tyre. Gjithashtu, Komiteti i Auditit bën edhe propozime mbi emërimin e auditorëve të jashtëm, shërbimeve të paramiratuara të ofruara ndaj Bankës dhe monitoron bilancin e shërbimeve audit dhe jo audit në mënyrë që të sigurojë pavarësinë e auditorit të jashtëm.

### **Vlerësimi i kontrolleve të brendshme mbi raportimin financiar**

Posaçërisht për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me US GAAP dhe në përputhje me Sarbanes-Oxley Act - Seksion 404 SOX, administrimi kryen për llogari të Grupit një vlerësim vjetor të efektivitetit të KBRF të Bankës, mbështetur mbi kuadrin e përcaktuar nga Committee of Sponsoring Organizations of the Treadway Commission in Internal Control - 2013 Integrated Framework (COSO) duke u fokusuar në kontrollet e brendshme, menaxhimin e riskut të sipërmarrjes dhe mashtrimet. Rezultatet e vlerësimit përfshihen në raportin vjetor të Grupit dhe depozitohen 20-F të US Securities Exchange Committee (SEC). Vlerësimi kryhet nga Departamenti i Financës dhe ka të bëjë me shqyrtimin e eficiencës së mekanizmave të kontrollit që janë identifikuar në proceset kritike në nivel Bankë

### **Vlerësimi i kontrolleve dhe procedurave të publikimit**


Drejtori i Përgjithshëm dhe Drejtuesi Ekzekutiv i Financës kryejnë një vlerësim të efektivitetit të kontrolleve dhe procedurave të publikimit në Bankë dhe i paraqesin përfundimet përkatëse të cilat depozitohen në Departamentin SOX të Grupit. Kontrollat dhe procedurat e publikimit përkufizohen si kontrolle dhe procedura të dizenuara për të siguruar së informacioni financiar dhe jofinanciar i nevojshëm për tu publikuar në raportet e paraqitura sipas US Securities Exchange Act të vitit 1934 regjistrohet, trajtohet, përmbledhet dhe raportohet në mënyrë të duhur. Për vlerësimin e procedurave dhe kontrolleve të publikimit, zbatohet metoda e vetëvlerësimit nga menaxherët e njësive të përfshira të Bankës.



# STRUKTURA ORGANIZATIVE



ASAMBLEJA E AKS  
Banka NBG Albar





IONEREVE  
hia S.A

ES

SHHEM

QEVERISJA  
KORPORATIVE

Divizioni i  
Pajtueshmerise se Grupit

DIVIZIONI I  
PAJTUESHMERISE

DREJTOR I RISKUT  
Risk (REZIKU)

DREJTORE  
E OPERACIONEVE  
Operacionet

DIVIZIONI I ANALIZES  
SE REZIKUT PER  
KREDITE INDIVIDUALE

DIVIZIONI  
I MENAXHIMIT  
TE REZIKUT

DIVIZIONI I REKUPERIMIT  
TE KREDIVE NE VONESE

OFICERI I SIGURISE  
PER TEKNOLOGJINE  
DHE INFORMACIONIN

DIVIZIONI I  
FINANCES &  
KONTABILITETIT

DIVIZIONI I  
TEKNOLOGJISE  
INFORMACIONIT

DIVIZIONI I  
SHERBIMEVE  
BANKARE

DIVIZIONI I ORGANIZIMIT  
TE PROCESEVE  
TE BIZNESIT

DIVIZIONI I  
PAJTUESHMERISE

NEN DIVIZIONI I  
ADMINISTRATES  
DHE PROKURIMEVE

NEN DIVIZIONI I  
ADMINISTRIMIT  
TE KREDIVE

DEPARTAMENTI I  
VLERESIMIT TE  
PASURIVE TE  
PALUAJTSHME

DEPARTAMENTI I  
MENAXHIMIT  
TE KESH-it  
& SIGURISE FIZIKE

# SHËRBIMET BANKARE PËR KONSUMATORËT

Duke u fokusuar në një model biznesi që merr në konsideratë si pritshmëritë e klientëve, ashtu dhe politikat e kujdesshme të riskut, Banka NBG Albania, shënoi një rritje të moderuar të portofolit të kredisë, mbështetur gjithashtu nga një bazë depozitash.

Për shkak të rrethanave të caktuara ekonomike dhe financiare në vendet fqinjë, viti 2015 ishte një vit vecanërisht sfidues, duke marrë në konsideratë ndikimin që kjo situatë pati në bazën e depozitave të Bankës, e cila u prek nga shqetësimi i klientëve lidhur me stabilitetin ekonomik të rajonit. Duke vepruar në mënyrë pro-aktive, Banka arriti me sukses të parandalojë rrjedhjen dhe të rikuperojë situatën brenda pak muajsh. Kontributi më domethënës ishte ai nga depozitat me afat, gjë që konfirmon stabilitetin e Bankës në treg dhe besimin e rifituar tek klientët.

Banka NBG Albania në vazhdimësi pasuroi gamën e produkteve të saj të depozitave dhe në të njëjtën kohë adoptoi praktika të përfaqësues specifike për segmente të ndryshme klientele, duke ofruar paketa ofertash të ndryshme dhe shërbime të përshtatshme bankare.

Në linjë me trendin aktual të tregut, Banka vazhdoi të mbante pozicionin e saj si një ndër lojtarët kryesorë në kredihënien për individët. Struktura e portofolit të kredive vazhdon të favorizojë përfaqësimin e balancuar, duke ruajtur raportin mes kredive të siguruar dhe atyre të pasiguruara, e cila është një strategji që Banka NBG Albania ka pasur që në fillimet e krizës ekonomike globale.

Kredia për shtëpi: Viti 2015 ishte një vit sfidues për produktet e kredisë për shtëpi, si për sa i përket kufizimit të tërheqjes ashtu dhe për gjenerimin e blerjeve të reja. Duke operuar në një treg shumë likuid, me vemendje të vecantë ndaj kredihënies nga njëra anë dhe duke ulur normën e interesit në kufirin

historik më të ulët nga ana tjetër, bëri që procesi i kufizimit të tërheqjes të rezultojë kompleks dhe i vështirë. Pavarësisht kësaj, rezultatet ishin pozitive, falë implementimit të politikave të duhura dhe praktikave fleksibël të rjetit tonë të degëve.

Në drejtim të gjenerimit të blerjeve të reja, Banka u avantazhua nga reputacioni i saj i qendrueshëm në treg, profesionalizmi i menaxhimit të degëve dhe sigurisht ofertat e shumta promovionale që në vazhdimësi tërhoqën klientë të rinj. Produkti i vitit ishte 4X4, i cili u dha klientëve cmim të ulët dhe nivel të lartë komoditeti.

Kredia Konsumatore: Gjatë 2015 vazhdoi i njëjti trend i diktuar nga strategjia e ndjekur nga Banka për një kredihënie konsumatore të kujdesshme. Kredia konsumatore, si produkt, u mbështet nga disa fushata marketingu, si dhe nga një skemë e menduar mirë shpërblimi për performuesit më të mirë. Është me vlerë, këtu, të theksohet se protofoli ynë i kredive të pasiguruara, mbetet shumë cilësor.

Rrjeti i degëve: Kënaqësia e klientit dhe cilësia e shërbimit mbetet në fokus të punës dhe aktivitetit të Rrjetit. Kujdes i vecantë iu kushtua rolit të linjës së parë të shitjeve në terren dhe funksioneve këshilluese, duke përmirësuar teknikat e shitjeve, aftësitë negociuese dhe kuptimin e nevojave të klientëve dhe biznesit.

Duke pasur si synim produktivitetin dhe efikasitetin e Rrjetit, gjatë 2015-ës Banka ndërmoi aksione të targetuara si: riorganizim të procedurave dhe proceseve, thjeshtëzimin dhe reduktimin e dokumentacionit të nevojshëm dhe cetralizimin e disa aktiviteteve/ operacioneve. Një shtysë dhe ndihmë e madhe në këtë drejtim, ishte përmirësimi i sistemeve I.T. të Bankës.



# BANKINGU TREGTAR DHE I KORPORATAVE

## Ne përpiqemi të fuqizojme klientët tanë për të drejtuar biznese më të mira

Aktiviteti kreditues i Bankingut Tregtar dhe Korporatave, gjatë vitit 2015 u përqëndrua në çështjet kryesore si më poshtë:

- Ripërcaktimi dhe rivendosja e prioriteteve të rrezikut ndërmarrës të Bankës; ndryshimi/pasurimi i proceseve të punës duke mbajtur në fokusin final rritjen e sigurisë së portofolit, zgjerimin me kujdes të aktivitetit kreditues për një klientelë të zgjedhur me kujdes dhe zvogëlimin e portofolit të kredive jo performuese (NPL-it) të cilat janë një sfidë për sektorin bankar Shqiptar.
- Zgjerimi i kujdesshëm dhe mbajtja e pjesës ekzistuese të tregut në mënyrë që të mbrohet emri i mirë dhe i fuqishëm i NBG në nivelin e kredimarësve të Korporatave dhe atyre tregtare;
- Mbajtja në një nivel të kënaqshëm të të ardhurave në bazë nominale dhe efektive;
- Monitorim nga afër i mbarëvajtjes së portofolit dhe ndërmarrja e veprimeve të shpejta për të siguruar një cilësi të aseteve; Maksimizim i arkëtimit nga portofoli problematik i cili menaxhohet nga njësia e Work Out-it; Shfrytëzimin e potencialit për ristrukturimin e kredive të bizneseve që operojnë, të cilët aktualisht janë nën mungesë të likuiditetit, me qëllim për të rritur vazhdimësinë e tyre; Ruajtja e kolateraleve dhe cilësisë së portofolit;
- Zbatim rigoroz i Politikës së Kredihënies,

udhëzimeve të brendshme përkundrejt procedurave të ndjekura për kredihënien, publikimin e Manualit Operacional/proceseve për standardizimin e procedurave të kreditimit, implementimin e sistemit të vlerësimit në bashkëpunim me Divizionin e Riskut për matjen e nivelit të riskut të kredive;

- Forcimi i sistemit të kontrollit të brendshëm për të minimizuar rreziqet e trashëguara dhe të mbetura;
- Përfshirja e Rrjetit të Degëve në procesin e fillimit të kredihënies dhe atë të monitorimit.

Veprimet e përmendura sa më sipër ndikuan në fuqizimin e pozitës së përgjithshme të Bankës përkundrejt grupit të përzgjedhur të një klientele sensitive. Përsa i përket portofolit aktual, Banka NBG Albania Sh.A. ka krijuar një bazë solide për zgjerimin e portofolit, mbajtjen dhe menaxhimin e tij, të karakterizuar nga ekspozime të mirë kolateralizuara, shmangien e çdo hyrje të re në sektorin e kredive jo performuese (NPL – ve), minimizimin e shtimit të provigjoneve.

Duke konsideruar qasjen në fjalë, përgjatë vitit 2015 rezultatet e Divizionit të Korporatave dhe atij Tregtar krijuan një precedent për Bankën dhe ndërtuan themelet e duhura për angazhimin në ofrimin e shërbime më të mira për komunitetin e biznesit dhe për të kontribuar në potencialin e rritjes së ekonomisë lokale.

# ADMINISTRIMI I RREZIKUT

Gjatë vitit 2015 Banka NBG Albania ka vazhduar të ndjekë politikën e saj të kujdesshme ndaj rrezikut duke i kushtuar vëmendje të veçantë përmirësimit të vazhdueshëm dhe zbatimit të kuadrit të brendshëm të administrimit efektiv të rrezikut. Bordi i Drejtorëve ka miratuar përditësimet dhe përmirësimet e politikave dhe procedurave ekzistuese që rregullojnë procesin e administrimit të rrezikut të cilat ndihmojnë për të drejtuar biznesin në mënyrë efikase.

Strategjia e rrezikut siguron që qëllimet e biznesit të ndiqen dhe arrihen në mënyrë të kontrolluar ndaj rrezikut. Sistemet e kontrollit të brendshëm ndihmojnë për të mbrojtur asetet e Bankës, për parandalimin dhe zbulimin e mashtrimit, duke pasur si objekt final ruajtjen e investimeve të aksionerit tonë.

Standardet e administrimit të rrezikut janë vendosur për të arritur ekuilibrin e kënaqshëm ndërmjet vëllimit dhe rentabilitetit të operacioneve me rreziqet që lidhen me to. Është arritur të bëhet përputhja me praktikën më të mira dhe pajtueshmëria me kërkesat rregullatore. Ndërgjegjësimi i rrezikut ndër-bankar dhe kultura e orientuar drejt administrimit të rrezikut është promovuar tek të gjithë të punësuarit nëpërmjet trajnimeve të specializuara dhe atyre në vendin e punës.

Të gjitha strukturat e Bankës janë pajisur me mjetet e duhura, me staf të arsimuar e me përvojë në mënyrë që të përmbushin rregullat dhe nevojat e tregut.

Banka ka realizuar ndryshime në strukturën organizative të rrezikut me qëllim që të:

- Shmangë konfliktet e interesit,
- Aplikohet në maksimumin e mundshëm në të gjitha aktivitetet e saj principi i katër syve,
- Përforcojë ekipe të përkushtuara për të synuar objektivat për rritjen e sigurt të biznesit në kohë,
- Shërbimet këshillimore mbi programe për zbutjen e rrezikut si dhe të ristrukturimeve,
- Mundësohet përpunimi efikas i kredive me probleme.

## Rreziku i Kredisë

Rreziku i kredisë është rreziku i humbjes së kryegjësë ose humbjes së një shpërblimi financiar që rrjedh nga dështimi i një huamarrësit për të shlyer një kredi ose përndryshe të përmbushë një detyrim kontraktor. Rreziku i kredisë lind sa herë që një huamarrës pret të përdorë flukset monetare të ardhshme për të paguar një borxh aktual. Investitorët kompensohen për marrjen e rrezikut të kredisë me anë të pagesave të interesit nga huamarrësit ose emetuesi i borxhit.

Korniza e rrezikut të kredisë së Bankës NBG Albania Sh.A përditësohet rregullisht përsa i përket procesit të identifikimit në kohën e duhur, monitorimit dhe matjes së rrezikut të kredisë, së bashku me metodologjitë, proceset dhe programet e lidhura. Gjatë vitit 2015, Banka ka vijuar të zbatojë politikë të kujdesshme të kreditimit, duke vënë theksin në standardet e përshtatura për vlerësimin e limiteve të kredive, miratimit, rinovimit dhe monitorimit të ekspozimeve kreditore. Politikat dhe manualët e kreditimit të Bankës janë gjithmonë të përshtatura me standardet rregullatore, me kërkesat dhe nevojat e tregut në mënyrë që të plotësojë kërkesat e konsumatorëve dhe cilësinë e aktiveve. Vlerësim i detajuar i rrezikut kryhet përpara çdo vendimmarrje për kreditim.

Banka vazhdimisht monitoron nivelet e rrezikut të kredisë nëpërmjet limiteve rregullatore dhe limiteve të brendshme të vendosura, dhe siguron që ekspozimi ndaj rrezikut të kredisë të jetë në kuadër të apetitit të Bankës ndaj rrezikut, i materializuar në buxhet. Kriteria të posaçme të rrezikut lidhen me çdo produkt dhe me grupe specifike të përcaktuara. Stres teste të rregullta dhe të përshtatshme janë bërë për vlerësimin e portofoleve të kredive individuale dhe të korporatave, dhe sipas nevojës janë propozuar planet përkatëse të veprimit.

Vëmendje e veçantë i kushtohet përmirësimit të sistemeve të brendshme për të mbështetur procesin e përgjithshëm. Sistemi për vlerësimin e sjelljes për kartat e kreditit është operativ, një sistem i ri hibrid është në përpunim për kreditë konsumatore të pasiguruara dhe kreditë hipotekare, si dhe një sistem i ri (modeli rating) është i instaluar



për të mbështetur procesin e vendimmarrjes për kreditë e biznesit.

Pas periudhës së nevojshme të testimit dhe akordimit, sistemi për vlerësimin e produkteve për kredi konsumatore do të bëhet mjet vendimmarrës dhe do të forcojë procesin e vendimmarrjes së Bankës.

Ndërsa për kreditë e biznesit, pas periudhës së kërkuar për kryerjen e testimit dhe akordimit, modeli rating ka filluar të përdoret si mjet vendimmarrjeje në Maj 2016, duke forcuar procesin e vendimmarrjes së Bankës.

## Administrimi i Kredive të Këqija

Gjatë vitit 2015, Banka ka miratuar politikat dhe procedurat për riposidim të kolateraleve. Kjo procedurë është konsideruar të jetë një modalitet shtesë me qëllim për të rritur të hyrat nga kreditë me probleme nëpërmjet marrjes në pronësi të kolateraleve mbi baza selektive. Objektivi kryesor është për të siguruar mekanizmat dhe veprimet e duhura për të mbrojtur interesat e Bankës pas përfundimit të pa-suksesshëm të procesit të përmbarrimit. Megjithatë, shtylla kryesore vazhdon të mbetet likuidimi i kolateraleve gjatë procesit të përmbarrimit, përderisa ajo ofron alternativën më të shpejtë dhe më efektive në drejtim të rezultateve dhe burimeve.


## Rreziku i Likuiditetit

Komiteti për Menaxhimin e Aseteve dhe Detyrimeve është organi përgjegjës për administrimin e rrezikut të likuiditetit. Divizioni i Thesarit është përgjegjës për menaxhimin e nevojave të përditshme për likuiditet.

Rreziku i likuiditetit është i qeverisur me anë të politikës “Për administrimin e rrezikut të likuiditetit”, miratuar nga Bordi i Drejtorëve. Objektivi kryesor i politikës është për të përshkruar kuadrin bazë të parimeve dhe matricave të cilat banka ndjek në mënyrë që të jetë në gjendje të trajtojë me sukses nevojat e likuiditetit në të gjitha kohët.

Banka përdor teknikat dhe mjetet sistematike për të siguruar menaxhimin e përshtatshëm dhe në kohë të likuiditetit. Banka ka përcaktuar limitet e likuiditetit në përputhje me kërkesat rregullatore lokale si edhe në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare bankare.

Analiza e skenarëve të stres testeve është një pjesë integrale e administrimit të rrezikut të likuiditetit. Skenarët përpiqen të kapin efektet në nivelet e likuiditetit të bankës nëpërmjet simulimeve të situatave të ndryshme të stresit. Banka kryen çdo tre muaj testimin e stresit të likuiditetit, dhe rezultatet e tij janë diskutuar në Komitetin për Menaxhimin e Aseteve dhe Detyrimeve dhe në Bordin e Drejtorëve. Përveç sa më sipër Banka ka në vend një Plan Emergjence Financimi i cili përshkruan në detaje se si do të menaxhohen ngjarjet e stresit të likuiditetit.



## Raporti i Likuiditetit

Ky është niveli i raportit të aktiveve likuide ndaj totalit të depozitave brenda një viti. Niveli i zotërimeve të mjeteve likuide në bilanc reflekton qasjen e matur të politikave dhe praktikës së likuiditetit të Bankës. Banka ka ruajtur raporte të shëndetshme likuiditeti, të cilët ishin mbi objektivin rregullator prej 30%. Analiza e skenarëve dhe e stres testeve luan një rol

të rëndësishëm në kuadrin tonë të menaxhimit të rrezikut të likuiditetit. Kjo përfshin gjithashtu një vlerësim të likuiditetit të asetëve, që nënkupton karakteristikat e inventarit tonë të asetëve, sipas skenarëve të ndryshëm të stresit.

Stres Testet e Likuiditetit tregojnë se Banka ka një Likuiditet të përshtatshëm edhe në një skenar të rënduar stresi.

Tabela në vijim tregon rezultatet e stres testit të bazuar në skenarin e mëposhtëm:

-20% Tërheqje depozitash  
Në 000 (mijë) Euro

Monedha	Nevojat per fonde	Likuiditeti i Disponueshëm	Likuiditeti i Disponueshëm Neto
ALL	16,740	24,350	7,610
FCY	17,693	42,586	24,893

## Rreziku i Tregut

Rreziku i tregut është ekspozimi ndaj një ndryshimi të pafavorshëm në vlerën e tregut të pozicioneve tregtare dhe të investimeve, që vjen si pasojë e një ndryshimi në çmime dhe në norma.

Ky pozicion rezulton nga dinamika e vete tregut dhe nga aktivitetet investuese. Faktorët e rrezikut të tregut janë rreziku i monedhës dhe rreziku i normës së interesit. Për secilën kategori të rrezikut të tregut Banka është e ekspozuar siç përshkruhet më poshtë:

- Rreziqet e këmbimit valutor lindin nga ekspozimet ndaj ndryshimeve të normave spot dhe të ardhshme, si edhe nga luhatjet e kursit të këmbimit
- Rreziqet e normës së interesit rezultojnë

nga ekspozimet ndaj ndryshimeve në nivelin dhe formën e kurbës së interesit, nga paqëndrueshmëria e normave të interesit dhe nga rreziku i opsionit.

## Korniza e Rrezikut të Kurseve të Këmbimit

Divizioni ynë i Thesarit është përgjegjës për administrimin e pozicionit të hapur të monedhës, duke respektuar kufirin e përcaktuar nga Divizioni i Menaxhimit të Riskut të Grupit. Në përputhje me politikën e Bankës, pozicioni monitorohet në bazë ditore nga Zyra e Suportit, si edhe nga Njësia e Rrezikut Operacional dhe Tregut.

Tabela më poshtë tregon ekspozimin e Bankës ndaj rrezikut të kursit të këmbimit në monedhë të huaj më 31 Dhjetor 2015

Monedha	Pozicioni Neto	Pozicioni Neto /Kapitali Regulator
EUR	1,849	0.27%
USD	91	5.36%
GBP	4	0.01%
AUD	6	0.02%

## Struktura dhe Qeverisja e Administrimit të Rrezikut të Normës së Interesit

Banka bën të mundur që të gjithë ekspozimet ndaj rrezikut të tregut të jenë në përputhje me strategjinë e saj të biznesit dhe brenda tolerancës së saj të rrezikut. Qëllimet e Bankës janë kryesisht për:

- të përcaktuar tolerancën e Bankës ndaj rrezikut të tregut;
- të siguruar që ekspozimi i Bankës ndaj rrezikut të tregut në përgjithësi të mbahet në nivele që përputhen me kapitalin në dispozicion; dhe
- për të siguruar që administrimi dhe personat përgjegjës për administrimin e rrezikut të tregut posedojnë ekspertizë të shëndoshë dhe njohuri për të kryer funksionin e administrimit të rrezikut, që përfshin krijimin e metodologjive të qëndrueshme dhe të besueshme për identifikimin, matjen, kontrollin, monitorimin dhe raportimin e rrezikut të tregut në mënyrë konsistente në të gjithë bizneset brenda bankës.

Komiteti për Menaxhimin e Aseteve dhe Detyrimeve është organi përgjegjës për përcaktimin e politikave të rrezikut të tregut dhe monitorimin e zbatimit të tyre nga ana e Bankës. Banka rregullisht vlerëson këto rreziqe dhe ka krijuar politika dhe praktika biznesi për t'u mbrojtur kundër efekteve negative ndaj ekspozimit të këtyre rreziqeve dhe jo vetëm. Raportet e rrezikut të tregut iu paraqiten rregullisht Komitetit dhe Bordit të Drejtorëve nga Njësia e Rrezikut Operacional dhe Tregut.

Banka analizon efektet e rrezikut të normës së interesit nga pikëpamja e fitimeve dhe nga pikëpamja e Vlerës Ekonomike.

Nga Pikëpamja e Fitimeve, fokusi i analizës vihet tek ndikimi i ndryshimeve në normat e interesit të përlogaritura ose të ardhurat e raportuara në të ardhmen e afërt, zakonisht për një ose dy vitet e ardhshme.

Komponenti i të ardhurave që tërheq më shumë vëmendjen është zëri “Të ardhurat neto nga Interesi”, i cili përkufizohet si diferenca ndërmjet të ardhurave totale nga interesi dhe shpenzimeve totale nga interesi që lindin nga zërat e bilancit të bankës.

Rezultati i analizës së ndjeshmërisë në 31 Dhjetor 2015 është si më poshtë:

- Përqindja e efektit në kapitalin rregullator të një ndryshimi prej 200 pikësh përqindje/bazë e të ardhurave neto nga interesi ishte 2.16%

### **Pikëpamja e Vlerës Ekonomike**

Variacionet në normat e interesit të tregut gjithashtu ndikojnë në vlerën ekonomike të aktiveve dhe pasiveve të bankës. Kështu, ndjeshmëria e vlerës ekonomike të Bankës ndaj luhatjeve të normave të interesit është një faktor tejet i rëndësishëm dhe që konsiderohet nga aksionerët, menaxhimi, dhe gjithashtu nga mbikëqyrësit. Vlera ekonomike e një instrumenti përfaqëson një vlerësim të vlerës aktuale të flukseve të veta neto të pritshme të parasë, të zbritura për të pasqyruar normat e tregut. Për ta shtjelluar më tej, vlera ekonomike e kapitalit të Bankës është vlera aktuale e flukseve neto të pritshme të parasë së Bankës, që përcaktohet si flukset e pritshme të parasë nga aktivet minus flukset e pritshme të parasë nga detyrimet. Në këtë kuptim, perspektiva e vlerës ekonomike pasqyron pikëpamjen e ndjeshmërisë së kapitalit të Bankës ndaj luhatjeve të normave të interesit. Banka përdor kohëzgjatjen e modifikuar e cila është një transformim i kohëzgjatjes Macaulay për të llogaritur ndryshimin në vlerën ekonomike të kapitalit që korrespondon me një zhvendosje marginale dhe paralele të kurbës së interesit.

Rezultati i analizës së ndjeshmërisë më 31 Dhjetor 2015 është si më poshtë:

- Përqindja e ndryshimit në ekspozimin e librit të bankës ndaj kapitalit rregullator për një ndryshim nga 200 pikësh përqindje ishte 2.93%

### **Rreziku Operacional**

Rreziku operacional është rreziku i humbjes si rezultat i proceseve të brendshme të papërshtatshme apo të dështuara, si pasojë e njerëzve dhe sistemeve, ose si efekt i ngjarjeve të jashtme. Sipas përkufizimit të marrëveshjes Bazeli II të miratuar nga Banka, rreziku operacional përfshin rrezikun ligjor dhe të

përputhshmërisë, por përjashton rreziqet e tjera të tilla si atë strategjik dhe të reputacionit.

Qëllimi i Politikave të Administrimit të Rrezikut Operacional është të sigurojë që të gjithë aktorët e Bankës, përfshirë Bordin e Drejtorëve, Menaxhimin Ekzekutiv dhe atë të Lartë, si edhe Stafin, të menaxhojnë rrezikun operacional në Kornizën e formalizuar dhe harmonizuar me objektivat e biznesit. Struktura dhe Qeverisja e Administrimit të Rrezikut Operacional

Struktura qeverisëse e Administrimit të Rrezikut Operacional të Bankës është bazuar në modelin e “tre linjave të mbrojtjes”. Veçanërisht:

- Linja e parë e Mbrojtjes përfshin të gjitha njësitë e Bankës, secila direkt përgjegjëse për kontrollin dhe minimizimin e rrezikut operacional në kuadër të aktiviteteve të saj të biznesit në pajtim me standardet dhe politikat e Bankës.
- Linja e dytë e Mbrojtjes përfshin Njësinë e Menaxhimit të Riskut, i cili është kryesisht përgjegjës për zhvillimin dhe paraqitjen e metodologjive, mjeteve dhe udhëzimeve që do të përdoren në nivel njësie për administrimin e rrezikut operacional, i mbështetur nga njësi të tjera të specializuara të tilla si Njësia e Pajtuashmërisë, ajo Ligjore, e Proceseve të Biznesit, e Burimeve Njerëzore, e Sigurisë, e Teknologjisë Informative, etj. Gjithashtu, monitorimi i rrezikut operacional dhe asistimi në veprimet lehtësuese po ashtu i përkasin kësaj linje të mbrojtjes.
- Linja e tretë e Mbrojtjes është Auditimi i Brendshëm, i cili është përgjegjës për të siguruar në mënyrë të pavarur që Korniza e Administrimit të Rrezikut Operacional është efektive, e përshtatshme dhe që funksionon me integritet.

Administrimi i Rrezikut Operacional mbikëqyret nga Komiteti i Rrezikut Operacional i cili raporton në Komitetin e Riskut të Bordit të Drejtorëve. Korniza e Menaxhimit të Rrezikut Operacional përbëhet nga proceset e mëposhtme:

- Vetë-Vlerësimi i Rrezikut dhe Kontrollit
- Treguesit kryesorë të rrezikut
- Mbledhja e të dhënave për Humbjet
- Planet e Veprimit

Vetë-Vlerësimi i Rrezikut dhe Kontrollit është një komponent kyç i kuadrit të rrezikut operacional të Bankës dhe nënkupton që në bazë gjashtëmujore çdo njësi e biznesit të Bankës në mënyrë proaktive të identifikojë dhe të vlerësojë rreziqet e saj të rëndësishme operationale, dhe të kontrollojë që masat për menaxhimin e këtyre rreziqeve po zbatohen siç duhen.

Treguesit kryesorë të rrezikut janë masa që gjurmojnë profilin e rrezikut të bankës. Çdo njësi biznesi në bashkëpunim me Njësine e Rrezikut Operacional të Bankës zhvillon dhe monitoron treguesit kryesorë të rrezikut për rreziqet e saj thelbësore.

Për këtë arsye, Banka, për qëllime Administrimit të

Rrezikut Operacional, përcakton si Tregues Kyç të Rrezikut çdo variable të thjeshtë ose të kombinuara e të dhënave, e cila lejon vlerësimin e një situate që ekspozon Bankën ndaj rrezikut operacional, si dhe trendin e saj, duke monitoruar / krahasuar vlerat e saj me kalimin e kohës.

## Matja e Rrezikut Operacional

We calculate and measure the regulatory capital for operational risk using the “standardized approach”. Capital requirement for Operational Risk as of December 31, 2015 was at the value of Euro 1.29 mio.

Viti	2014	2015
Kërkesa për kapital	1.29	1.35

### Pikëpamje

Banka është në një udhëtim për të mbjell praktikatat e administrimit të rrezikut operacional të fuqishme, kulturën dhe mjedisin përtej përputhjes me kërkesat rregullative, por si një vlerë e shtuar që rrit dhe kontribuon në vlerën e palëve të përfshira dhe në ekzistencën afatgjatë dhe në mbijetesën e institucionit.


### BAZEL II

Marrëveshja Bazel II është bërë standard i përbashkët për administrimin e rrezikut dhe të mjaftueshmërisë së kapitalit në të gjithë Europën gjatë viteve të fundit, duke formuar aktualisht korpusin kryesor të rregullave të kujdesshme nëpër Evropë.

Një kuadër i ri rregullator është në fuqi nga Marsi 2015 bazuar në thelbin e Marrëveshjes së Bazel II, që korrespondon me direktivat evropiane dhe një sërë udhëzimesh të menaxhimit të rrezikut të bazuar në parimet e administrimit të shëndoshë të rrezikut të lëshuar nga Komiteti i Bazelit.

Si rezultat, Banka NBG Albania Sh.A ka:

- identifikuar mangësitë dhe të përmirësuar praktikatat e saj aktuale të menaxhimit të rrezikut, ndaj rregullave dhe standardeve të Bazel II për të siguruar përputhshmërinë me kërkesat përkatëse të Bankës së Shqipërisë për llojet e rrezikut të mëposhtme:
  - Rreziku i Kredisë: Metoda e Standardizuar
  - Rreziku i tregut: Metoda e Standardizuar
  - Risku Operacional: Metoda e Standardizuar
- Kemi përcaktuar një division të dedikuar për drejtimin dhe ndjekjen e përputhshmërisë me kërkesat e Bankës së Shqipërisë dhe përmirësimin e funksionit të administrimit të rrezikut dhe procedurave për Llogaritjen e Mjaftueshmërisë së Kapitalit.
- Në mënyrë të përshtatshme në division është inkorporuar edhe Njësia e Rrezikut Operacional.





# BURIMET NJEREZORE

Gjate vitit 2015 Divizioni i Burimeve Njerezore u fokusua ne te qenit proaktiv ne adoptimin e projekteve te Menaxhimit, persa i perket ndryshimeve kulturore dhe strukturore dhe per te rritur eficencen e pergjegjesine, per te permiresuar sherbimin ndaj klienteve dhe metodat e administrimit.

Te gjitha projektet e ndermarra nga Divizioni i Burimeve Njerezore sollen ne linjen e duhur objektivat e tij te dedikuar ndaj zhvillimit te fuqise punetore, me synim drejtimin e objekteve strategjike dhe prioriteteve dhe veproi ne fakt si nje "mundesues" duke ofruar sherbime te lidhura me BNJ dhe mbeshtetje per te gjitha njesite e Bankes.

## Vlerat ne Pune

Synimi i Politikes se Burimeve Njerezore eshte te krijoje dhe ruaje nje mjedis pune sa terheqes aq edhe stimulus profesionalisht.

Banka perfiton nga potenciali i punonjesve te saj me edukim te larte, te mire-informuar dhe te orientuar drejt arritjes se targeteve, punonjes te cilet reagojne ndaj nevojave te kolegeve te tjere, klienteve dhe ambientit. Gjate vitit 2016, punonjesit tane jane karakterizuar nga aftesia dhe perpjekjet per te arritur standarte gjithnje e me te larta te performances. E gjithje kjo solli nje komunitet pune mbeshtetes, i cili vlereson profesionalizmin dhe praktikat e mira.

Mundesite e barabarta te punesimit dhe trajtimi i barabarte kane mundesuar qe 49 individe te sigurojne punesim afatgjate ose afatshkurter ne brendesi te kompanise sone.

Me shume se 55 studente perfituan nga programet e internshipeve/praktikave qe ne ofrojme dhe moren njohuri te dobishme mbi Bankingun, aftesi dhe experience te vlefshme pune.

## Ndryshimet Organizative

Gjate vitit 2015, me synimin per te thelluar njohurite Bankare dhe per te rritur eficencen e operacioneve dhe sherbimeve te ofruara ndaj klienteve, jane ndermarre disa ndryshime organizative ne njesite e Bankes.

Pergjate vitit, Menaxhimi i Bankes paraqiti:

- Riorganizimine (I) Operacioneve; (II) Divizionin e Rikuperimit te Kredive, ne brendesi te Njesise se Riskut, (III) Divizionin e Pajtueshmerise, duke perfshire ketu centralizimin e aktiviteteve te Urdherave te Bllokimit ne nje Departament te vetem;
- Implementimin e linjave te reja te aktivitetit, te tilla si: (I) Divizioni i Menaxhimit te Riskut, ne brendesi te Njesise se Riskut, (II) Departamenti i Administrimit te Kesh-it dhe Sigurise Fizike, ne brendesi te Njesise se Operacioneve.

## Trajnimet dhe Zhvillimi

Banka inkurajon punonjesit qe te zhvillojne me tej aftesite dhe profesionalizmin e tyre nepermjet nje game te gjere metodash.

Gjate vitit punonjesit (te Degeve dhe Drejtorise Administrative) jane trajnuar mbi afersisht 50 tema te ndryshme, ku numri total i pjesemarresve eshte 485.

Vlen te permendet se gjate vitit 2015, pervec metodologjive standarte si trajnimet ne vendin e punes, sallat specifike, seminareve dhe workshop-eve eshte aplikuar ne menyre te sukseshme metodologjia e re e Seminareve E-Learning (mesimi online) per 12 tema te ndryshme.

Rezultati i inestimeve te tilla per trajnime, eshte zhvillimi ne kariere dhe promovimi ne nivele me te larta hierarkike i 16.5% te burimeve tona te brendshme.

## Perfitimet e Stafit, Shendetit dhe Mireqenia

Banka i mundeson stafit te saj nje varg perfitimesh per te mbeshtetur ecurine e tyre profesionale dhe personale, si dhe per te krijuar nje balance te shendetshme pune-jete. Midis te tjerave, ne vitin 2015 jane rishikuar: Politika per Kredite e Stafit, e cila perfshiu nje liste cmimesh me kushte konkurruese; paketa e kontrollit mjekesor, kostoja e se ciles eshte rritur me pothuajse 50% ne krahasim me vitin e kaluar.

## Te dhena Statistikore dhe Demografike per 2016

Numri Total i Stafit 2015	303 (numri i personelit ne fund te vitit 288)
Diplome Universiteti	~100% (vetem 1 rast)
Studime Pasuniversitare	27 % (pershire rastet ne progres)
Gjuhe te Huaja (kryesisht Anglisht)	~90% njohin te pakten nje gjuhe
Mosha mesatare e punonjesve (stafi total)	39 vjec
% e Stafit sipas Gjenerates	Gjenerata Y (22-35) 38%
	Gjenerata Z (36-50) 55%
	Baby Boomers (mbi 51 vjec) 7%
Kohezgjatja Mesatare e Sherbimit te Punonjesve	6.6 vite pune

## Rrjeti i Degeve

Numri Total i Punonjesve	145 – 48% e personelit te plote
Mosha mesatare e punonjesve (clerical staff)	33 vjec
Gjinia	~23% e personelit Meshkuj & 77% Femra

## Drejtoria Administrative

Numri Total i Punonjesve	158 – 52% e numrit te pergjithshem te punonjesve
Mosha mesatare e punonjesve (clerical staff)	35 vjec
Gjinia e Personelit	~36% Meshkuj & 64% Femra

## Kushtet e Punesimit

me Kohe te plote/me Kohe te Pjesshme	vetem 0.3% jane me kohe te pjesshme
--------------------------------------	-------------------------------------

## Te dhena mbi qarkullimin e personelit 2015

Qarkullimi i Pergjithshem i Personelit(QPP)	8.9%
Qarkullimi i Personelit ne Dege (QPD)	4.6 % (i QPP)
	(14.3 % e Drejtoreve te Degeve & 85.7% e numrit te specialisteve ne dege)
Administrative Office Turnover (AOT)	4.3% (of the OPT)
Qarkullimi i Personelit te Drejtorise	
Administrative (QPDA)	4.3% (e QPP)
	(31 % of Menaxheret e Linjes se pare dhe te dyte & 69% e numrit te specialisteve te Drejtorine Administrative)

## Te dhena shtese mbi qarkullimin e personelit 2016

Spektori i bankingut	25.92% e QPP
Spektori Privat	18.52% e QPP
Migracion	18.52% e QPP
Spektori Publik	3.7 % e QPP
Te tjera	33.34% e QPP

# PAJTUESHMERIA

TPër sa i përket funksioneve , Divizioni i Pajtuësëmërisë është i pavarur nga njësitë e tjera të Bankës dhe është përgjegjës për monitorimin dhe kontrollin e vazhdueshëm të çështjeve dhe raporteve që kanë të bëjnë me pajtuësëmërinë ligjore dhe rregullatore të Bankës. Divizioni i Pajtuësëmërisë siguron parandalimin në kohë të rreziqeve që lidhen me shkeljet e mundshme të rregullave dhe akteve ligjore, mbikëqyr zbatimin e politikave të tilla si Parandalimi i Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit, dhe konfliktit të interesave të drejtuesve të lartë, etj.

Në kontekstin e arritjes së standarteve të larta etike brenda Bankës, krahas Procedurës “Per sinjalizimin”, u hartua një politikë e re “Per sinjalizimin” duke zgjeruar kështu më tej kuadrin aktual për dërgimin e raporteve konfidenciale për parandalimin dhe shmangien e parregullsive që mund të venë në rrezik reputacionin dhe interesat e Bankës dhe klientëve të saj.

Aplikacioni i Skanimit Online (TOSA) në sistemin e bankes është zëvendësuar me një aplikacion të ri të quajtur FACTIVA. Të gjitha listat shkarkohen automatikisht nga Dow Jones dhe hidhen në sistemin e bankës. Çdo regjistrim/modifikim i klientit apo transaksioneve që kryen ai, kontrollohen në kohë reale kundrejt listës me qëllim që Banka

të mos i lejojë subjektet e përfshira në Listat Ndërkombëtare të Sanksioneve të kryejnë veprime bankare .

Gjithashtu në versionin Customer, Industry të sistemit të Bankës ku regjistrohen subjektet juridike, kemi shtuar disa fusha të reja për regjistrimin e personave përfaqësues të një biznesi të cilët kanë të drejtën të kryejnë transaksione në llogaritë e kompanisë. Gjithashtu në këtë version tani është e mundur që të regjistrohen madje dhe aksionerët e një kompanie, ku sipas kuadrit rregullator kërkohet identifikimi i aksionerëve që zotërojnë të paktën 25% të aksioneve apo më tepër. Këto ndryshime në versionin Customer, Industry, që lidhen me personat që kanë të drejtë të veprojnë me llogaritë e kompanisë, janë ndryshime teknike, të cilat më pas do të shoqërohen me regjistrimin e specimentit të firmës, prokurës apo dokumente të tjera si imazhe në sistem. Ky regjistrim i skanimeve të dokumenteve që vërtetojnë të drejtat vepruese në llogaritë e kompanisë, do të bëjë të mundur verifikimin e shpejtë të të drejtave të klientëve individë që të veprojnë me llogaritë pa qenë e nevojshme hapja e dosjes fizike të klientit. Zbatimi i vazhdueshëm i pajtuësëmërisë rregullatore efektive në nivel banke do të mbetet objektivi kryesor i Bankës për vitin 2016.



# AUDITIMI I BRENDSHËM

Divizioni i Auditimit të Brendshëm të Bankës është një funksion i pavarur, objektivi i të cilit është të ofrojë shërbime sigurie dhe këshilluese të dizenuara për të shtuar vlerë dhe përmirësuar efektivitetin operacional të Bankës. Auditimi i Brendshëm kontribuon në arritjen e objektivave të Bankës duke a) sjellë një vlerësim sistematik dhe të disiplinuar dhe përmirësimin e efektivitetit të qeverisjes, menaxhimit të rrezikut dhe mjedisit të kontrollit të brendshëm të Bankës, b) rekomanduar masat e duhura për të minimizuar rrezikun dhe për të përmirësuar efikasitetin dhe efektivitetin e politikave dhe procedurave të Bankës, dhe c) monitoruar implementimin e veprimeve korrigjuese të miratuara nga menaxhimi.

Divizioni i Auditimit të Brendshëm është administrativisht i pavarur nga njësitë e tjera të Bankës. Drejtuesi i Auditimit të Brendshëm caktohet dhe shkarkohet nga Bordi i Drejtorëve të Bankës, me rekomandimin e Komitetit të Auditimit, Drejtorit Ekzekutiv të Bankës dhe me pëlqimin e Drejtorit Ekzekutiv të Auditimit të Grupit NBG. Drejtuesi i Auditimit të Brendshëm raporton funksionalisht, nëpërmjet Komitetit të Auditimit, te

Bordi i Drejtorëve të Bankës dhe administrativisht, drejtpërdrejt te Drejtorit Ekzekutiv të Bankës, ndërkohë raporton gjithashtu për qëllimet e Grupit, te Drejtorit Ekzekutiv të Auditimit të Grupit NBG.

Bordi i Drejtorëve të Bankës miratoi ndryshimet e Statutit të Divizionit të Auditimit të Brendshëm në Tetor 2015, duke përfshirë në të Udhëzimet e përditësuara të Baselit dhe të standardeve të IIA (Instituti global i Auditimit të Brendshëm). Ky Statut përcakton qëllimin, fushën, autoritetin dhe përgjegjësinë e Auditimit të Brendshëm.

Divizioni i Auditimit të Brendshëm operon si një funksion i integruar i Grupit përmes të gjitha Njësive të Auditimit të Brendshëm të Grupit NBG, duke përdorur të njëjtat:

- metodologji të auditimit të brendshëm, duke përfshirë udhëzimet dhe politikat të cilat janë zhvilluar nga Divizioni i Auditimit të Brendshëm të Grupit NBG dhe ndjekin parimet e COSO dhe Standardet Ndërkombëtare për Praktikën Profesionale të Auditimit të Brendshëm të Institutit të Auditorëve të Brendshëm (IIA). Që prej tremujorit të fundit të vitit 2014, metodologjia e auditimit të brendshëm është përditësuar në përputhje të plotë me kuadrin e COSO 2013.
- program të auditimit të brendshëm EGRC, duke qenë një mjet i rëndësishëm për auditorët e brendshëm me qëllim forcimin e mëtejshëm të menaxhimit të përgjithshëm të procesit të auditimit të brendshëm, nëpërmjet standardizimit të aktiviteteve të auditimit të brendshëm dhe të shkëmbimit të informacionit midis auditorëve të Grupit.

Divizioni i Auditimit të Brendshëm është vlerësuar në vitet 2013 - 2014 nga Sektori i Sigurimit të Cilësisë dhe të Mbikëqyrjes - të Divizionit të Auditimit të Brendshëm të Grupit NBG. Në bazë të vlerësimit të kryer, mendimi i përgjithshëm është se aktiviteti i Auditimit të Brendshëm Përgjithësisht Përputhet me Standardet dhe me Metodologjinë e Auditimit të Brendshëm të Grupit NBG dhe Përgjithësisht Përputhet me Kodin e Etikës.

Kompetenca profesionale dhe zhvillimi i vazhdueshëm profesional është një ndër prioritetet e Divizionit të Auditimit të Brendshëm përmes angazhimit të auditorëve të brendshëm në programet ndërkombëtare të çertifikimit profesional (p.sh. CIA, ACCA) dhe trajnimeve të shpeshta (për Mashtrimin, IT, CIA, COSO, mjetet dhe teknikat e Auditimit etj).





# PERGJEGJESIA SOCIALE

## NJE BANKE E PERGJEGJSHME PER TE GJITHE

Një nga vlerat themeluese dhe principet bazë të Bankës NBG që nga themelimi i saj ka qenë kontributi i saj për përmirësimin dhe prosperitetin e shoqërisë shqiptare, nga çfarë varet sukcesi afatgjatë i Bankës si edhe qëndrueshmëria e biznesit. Duke u mbështetur në këto parime, Banka NBG Albania ka zhvilluar një kulturë korporative që reflekton dëshirën e Bankës për të funksionuar në mënyrë të përgjegjshme në të gjitha sektorët që kontribuojnë në rritjen e qëndrueshme, duke përfshirë tregun, aksionerët, punonjësit, shoqërinë në tërësi si edhe mjedisin. Duke ndërmarrë rolin e “qytetarit të ndërgjegjshëm” përkrah shoqërisë ku operon, gjatë vitit 2015, Banka NBG ka treguar vazhdimisht respektin e saj për vlerat njerëzore, mirëqenien e komunitetit, suportin dhe edukimin e brezit të ri në shkollë dhe universitete, bashkëpunimin me institucionet publike, ruajtjen e gjuhës shqipe, sportit, kulturës dhe mbrojtjen mjedisore.

## Banka NBG Albania, dhuron pajisje për Drejtorinë Arsimore Sarandë

Banka NBG Albania Sh. A dhuroi pajisje për Drejtorinë Arsimore Tiranë.



## Banka NBG Albania feston me fëmijët jetim në komunitet

Banka NBG Albania ishte pjesë e aktiviteteve të organizuara nga Dega e Kryqit të Kuq, Tiranë, me rastin e 1 Qershorit. Aktiviteti mblodhi në festime 100 fëmijë jetim të cilët jetojnë në komunitet. Banka NBG Albania, mbështeti këtë aktivitet duke dhuruar pako dhuratash për fëmijët.



## Banka NBG Albania, mbështeti fshatin e fëmijëve SOS

Si pjesë e angazhimit të saj në ndihmë të komunitetit dhe njerëzve në nevojë, Banka NBG Albania mbështeti përmes blerjes së biletave për stafin e saj, një eveniment të organizuar për të mbledhur fonde për fshatin e fëmijëve SOS. Evenimenti u organizua nga Ambasada Austriake dhe Teatri i Operas dhe Baletit, me pjesëmarrjen e violinistit të njohur Shkelzen Doli.



## Banka NBG Albania, dhuron gjak për fëmijët me Talasemi

Banka NBG Albania Sh. A në bashkëpunim me Kryqin e Kuq Shqiptar dha ndihmesën e saj në mbështetje të fëmijëve me Talasemi duke ftuar stafin të dhurojë gjak. Në Shqipëri janë rreth 600 fëmijë, që vuajnë nga Talasemia. Ata kanë nevojë të marrin gjak çdo tre javë. Prindërit e tyre nuk mund të jenë dhurues, pasi dhe ata vetë janë bartës të sëmundjes.





## Mbështetje për Policinë e Shtetit

Banka NBG Albania dhuroi pajisje për zyrat qendrore të Policisë së Shtetit.



## Dhurim për fëmijët në nevojë - Projekti 'Kthim në Shkollë'

Banka NBG Albania dhuroi sete të plota shkollore për 150 fëmijë në nevojë në Vaqrr/ tdonated a full set of school materials for 150 children in need in Vaqarr. Dhurimi u krye në një ceremoni me pjesë marrjen e kryetarit të Bashkisë Tiranë, Erion Veliaj.



Tags: 1st pic from the left: In the middle the mayor of Tirana, Mr. Erion Veliaj, handing the school bag to the child, the CEO of Banka NBG Albania, Mr. Ioannis Agathos,

## Promovojmë Artin

Si pjesë e angazhimit të saj në mbështetje të artit dhe kulturës, 'Banka NBG Albania ishte sponsori i përgjithshëm i shfaqjes teatrale 'Kush e solli Doruntinën', bazuar në veprën e njohur të Ismail Kadarese. Vepra u vu në skenë nga një emër i njohur i publikut shqiptar, Laert Vasili dhe në rolet kryesore ishin gjithashtu disa prej emrave të mëdhenj të skenës shqiptare si, Margarita Xhepa and Bujar Lako. Vepra u vu në skenë në disa qytete si Tiranë, Shkodër, Korçë, Vlorë, Fier, Durrës si dhe në Kosovë, Prishtinë dhe Greqi, Selanik.



## Banka NBG Albania dhuron për jetimoret në Vlorë dhe Sarandë

Me rastin e festimeve të fundvitit, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, organizoi disa festa në të gjithë 28 qendrat e kujdesit social në Shqipëri. Banka NBG Albania u bë pjesë e kësaj iniciative duke dhuruar fonde në mbështetje të qendrave sociale të Vlorës dhe Sarandës.



## Banka NBG Albania dhuron për Down Syndrome Albania

The President of Albania, His Excellency Mr. Bujar Nishani and the First Lady, Mrs. Odeta Nishani, decided to raise funds for Down Syndrome Albania foundation at the President's End of Year Ball, Banka NBG Albania decided to contribute by donating funds to help financing the education and training of children with Down Syndrome Lako. The play traveled to the main Albanian towns, including Tirana, Shkodra, Korca, Vlora, Fier, Durrës as well as in Kosovo, Prishtina and Greece, Thessaloniki.



# TË DHËNA FINANCIARE



**Banka NBG Albania Sh.A.  
Raporti i audituesit të pavarur dhe  
pasqyrat financiare më dhe  
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015**

# PËRMBAJTJA

<b>RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR</b> .....	
<b>PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR</b> .....	<b>1</b>
<b>PASQYRA E FITIMIT OSE HUMBJES DHE E TË ARDHURAVE TË TJERA PËRMbledhëse</b> .....	<b>2</b>
<b>PASQYRA E NDRYSHIMIT TË KAPITALIT</b> .....	<b>3</b>
<b>PASQYRA E FLUKSIT TË PARASË</b> .....	<b>4</b>
<b>1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM</b> .....	<b>5</b>
<b>2. APLIKIMI I STANDARDEVE NDËRKOMBËTARE TË RAPORTIMIT FINANCIAR (SNRF) TË REJA DHE TË RISHIKUARA</b> .....	<b>6</b>
<b>2.1 STANDARDE DHE INTERPRETIME NË FUQI NË PERIUdhËN RAPORTUESE</b> .....	<b>6</b>
<b>2.2 STANDARDE DHE INTERPRETIME TË PUBLIKUARA, QË NUK JANË AKOMA NË FUQI DHE AS TË APLIKUARA</b> .....	<b>6</b>
<b>3. BAZAT E PËRGATITJES</b> .....	<b>10</b>
<b>4. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL</b> .....	<b>10</b>
<b>5. PËRDORIMI I VLERËSIMEVE DHE GJYKIMEVE</b> .....	<b>23</b>
<b>6. ARKA DHE LLOGARITË ME BANKËN QËNDRORE</b> .....	<b>26</b>
<b>7. HUA DHE PARAPAGIME NGA BANKAT</b> .....	<b>26</b>
<b>8. LETRA ME VLERË TË MBAJTURA PËR TREGTIM</b> .....	<b>28</b>
<b>9. HUA DHE PARADHËNIE PËR KLIENTËT, NETO</b> .....	<b>28</b>
<b>10. LETRA ME VLERË TË VLEFISHME PËR SHITJE</b> .....	<b>29</b>
<b>11. AKTIVE AFATGJATA JOMATERIALE, NETO</b> .....	<b>31</b>
<b>12. AKTIVE AFATGJATA MATERIALE, NETO</b> .....	<b>32</b>
<b>13. AKTIVE TË TJERA, NETO</b> .....	<b>33</b>
<b>14. DETYRIME NDAJ BANKAVE DHE INSTITUCIONEVE FINANCIARE</b> .....	<b>33</b>
<b>15. DETYRIME NDAJ KLIENTËVE</b> .....	<b>34</b>
<b>16. TATIMI I SHTYRË AKTIV</b> .....	<b>34</b>
<b>17. DETYRIME TË TJERA</b> .....	<b>35</b>
<b>18. BORXHI I VARUR</b> .....	<b>36</b>
<b>19. KAPITALI I PAGUAR</b> .....	<b>37</b>
<b>20. REZERVA</b> .....	<b>37</b>
<b>21. TË ARDHURA NGA INTERESI</b> .....	<b>38</b>
<b>22. SHPENZIME INTERESI</b> .....	<b>38</b>
<b>23. TË ARDHURA NGA KOMISIONE DHE TARIFA</b> .....	<b>38</b>
<b>24. PROVIGJIONE PËR HUMBJE NGA HUATË</b> .....	<b>39</b>
<b>25. SHPENZIME TË TJERA OPERATIVE</b> .....	<b>39</b>
<b>26. TATIMI MBI FITIMIN</b> .....	<b>40</b>
<b>27. FITIME NGA INVESTIMET NË LETRA ME VLERË, NETO</b> .....	<b>41</b>
<b>28. (SHPENZIME)/TË ARDHURAT TREGTARE, NETO</b> .....	<b>41</b>
<b>29. PARAJA DHE EKVIVALENTET E SAJ</b> .....	<b>42</b>
<b>30. TRANSAKSIONET ME PALËT E LIDHURA</b> .....	<b>42</b>
<b>31. ANGAZHIME DHE GARANCI</b> .....	<b>44</b>
<b>32. NGJARJE PAS DATËS SË RAPORTIMIT</b> .....	<b>45</b>
<b>33. ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR</b> .....	<b>45</b>

## RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

### Drejtimit të Bankës NBG Albania sh.a.

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Bankës NBG Albania sh.a. ("Banka"), bashkangjitur, të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2015, pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe e të ardhurave të tjera përmbledhëse, pasqyrën e ndryshimit të kapitalit dhe pasqyrën e fluksit të parasë për vitin e mbyllur më këtë datë, si dhe një përmbledhje të politikave bazë kontabël dhe informacione të tjera shpjeguese.

### Përgjegjësia e Drejtimit për Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar dhe për kontrollin e brendshëm, i cili në masën që përcaktohet nga Drejtimi, është i nevojshëm për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare pa pasaktësi materiale si rezultat i mashtrimeve apo gabimeve.

### Përgjegjësia e Audituesit

Përgjegjësia jonë është që, bazuar në auditimin tonë, të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare. Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të përmbushim kërkesat e etikës dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin, me qëllim që të përftojmë siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare nuk kanë pasaktësi materiale.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për sigurimin e të dhënave të auditimit, për vlerat dhe deklaratimet në pasqyrat financiare. Procedurat e përzgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, përfshirë këtu dhe vlerësimin e rreziqeve të ekzistencës së gabimeve në pasqyrat financiare, qofshin këto si rezultat i mashtrimeve apo i gabimeve. Gjatë vlerësimit të rreziqeve, audituesi merr në konsideratë kontrollin e brendshëm në lidhje me përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinionit mbi efektetivitetin e kontrollit të brendshëm të Bankës. Një auditim përfshin gjithashtu vlerësimin për përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kryesore të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë se të dhënat e auditimit që kemi marrë ofrojnë baza të mjaftueshme dhe të përshtatshme për dhënien e opinionit të auditimit.

### Opinionit

Sipas opinionit tonë pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të sigurtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Bankës më 31 dhjetor 2015, rezultatin financiar dhe fluksin e parasë për vitin e mbyllur më këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Ernst & Young Ekspertë Kontabël të Autorizuar  
Dega në Shqipëri

*Ernst & Young Certified Auditors*  
Tiranë, Shqipëri  
29 prill 2016



Mario Vangjel  
Ekspert Kontabël i Regjistruar





PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR  
më 31 dhjetor 2015

Shënime	31 dhjetor 2015 në '000 Lek	31 dhjetor 2014 në '000 Lek	
<b>Aktivët</b>			
Arka dhe llogaritë me Bankën Qëndrore	6	3,797,523	5,283,023
Hua dhe parapagime nga bankat	7	3,830,841	6,199,359
Letra me vlerë të mbajtura për tregtim	8	-	51,173
Hua dhe paradhënie për klientët, neto	9	25,646,577	23,801,412
Letra me vlerë të vlefshme për shitje	10	5,199,843	8,464,177
Aktive afatgjata jomateriale, neto	11	55,938	37,612
Aktive afatgjata materiale, neto	12	182,641	199,658
Aktive të tjera, neto	13	63,167	41,817
Tatim i shtyrë	16	48,154	54,928
Tatim fitimi i parapaguar	26	117,735	140,575
<b>Totali i aktiveve</b>		<b>38,942,419</b>	<b>44,273,734</b>
<b>Detyrimet</b>			
Detyrime ndaj bankave dhe institucioneve financiare	14	2,307,403	1,186,021
Detyrime ndaj klientëve	15	26,511,976	33,070,049
Detyrime të tjera	17	264,318	254,412
Borxh i varur	18	1,647,623	1,681,958
<b>Totali i detyrimeve</b>		<b>30,731,320</b>	<b>36,192,440</b>
<b>Kapitali</b>			
Kapitali i paguar	19	7,587,914	7,587,914
Rezervat	20	479,613	438,829
Fitime të mbartura		143,572	54,551
<b>Totali i kapitalit</b>		<b>8,211,099</b>	<b>8,081,294</b>
<b>Totali i detyrimeve dhe kapitalit</b>		<b>38,942,419</b>	<b>44,273,734</b>

Pasqyrat financiare u aprovuan nga Komiteti Ekzekutiv i Banka NBG Albania Sh.A., u autorizuan për lëshim më 14 Prill 2016 dhe u nënshkruan në emër të Bankës nga:



Ioannis AGATHOS  
Drejtore i Përgjithshëm Ekzekutiv



Brunilda PAPA (JAKOVI)  
Drejtore e Operacioneve

Shënimet shoqëruese në faqet 5 deri në 73 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

PASQYRA E FITIMIT OSE HUMBJES DHE E TË ARDHURAVE TË TJERA PËRMBLEDHËSE  
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2015 në '000 Lek	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2014 në '000 Lek	
Të ardhura nga interesi	21	1,687,437	1,906,854
Shpenzime interesi	22	(418,296)	(842,905)
<b>Të ardhura nga interesi, neto</b>		<b>1,269,141</b>	<b>1,063,949</b>
Të ardhura nga komisione dhe tarifa	23	229,625	216,571
Shpenzime për komisione dhe tarifa		(6,850)	(8,047)
<b>Të ardhura nga komisione dhe tarifa, neto</b>		<b>222,775</b>	<b>208,524</b>
(Shpenzime)/Të ardhura nga tregtimi, neto	28	(100,172)	125,598
Të ardhura nga investimi në letra me vlerë, neto	27	130	16,062
Të ardhura të tjera operative		3,718	4,394
<b>Të ardhura operative</b>		<b>1,395,592</b>	<b>1,418,527</b>
Provizgjione për humbje nga huatë	24	(183,121)	(143,994)
Shpenzime të tjera operative	25	(1,067,495)	(1,074,495)
<b>Fitimi / (humbja) para tatimit</b>		<b>144,976</b>	<b>200,038</b>
Tatimi mbi fitimin	26	(48,548)	(51,922)
<b>Fitimi neto për vitin</b>		<b>96,428</b>	<b>148,116</b>
<b>Të ardhura të tjera përmbledhëse</b>			
<i>Zëra që do riklasifikohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në periudhat pasardhëse (neto nga tatimi):</i>			
Njohja e të ardhurave neto prej letrave të investimit		127	(16,062)
Ndryshimi neto në vlerën e drejtë të letrave me vlerë të vlefshme për shitje		33,250	(105,078)
<b>Totali</b>		<b>33,377</b>	<b>(121,140)</b>
<b>Totali i të ardhurave përmbledhëse për vitin</b>		<b>129,805</b>	<b>26,976</b>

Shënimet shoqëruese në faqet 5 deri në 73 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

**BANKA NBG ALBANIA SHA**

**PASQYRA E NDRYSHIMIT TË KAPITALIT**  
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

	<b>Kapitali aksionar në '000 Lek</b>	<b>Rezerva në '000 Lek</b>	<b>Rezerva të vlerës së drejtë në '000 Lek</b>	<b>Fitime të mbartura në '000 Lek</b>	<b>Totali në '000 Lek</b>
<b>Gjëndja më 1 janar 2014</b>	<b>7,587,914</b>	<b>449,650</b>	<b>106,101</b>	<b>(89,347)</b>	<b>8,054,318</b>
Fitimi neto për vitin	-	-	-	148,116	148,116
Ndryshimi neto në vlerën e drejtë të letrave me vlerë të vlefshme për shitje	-	-	(121,140)	-	(121,140)
Rritje në kapitalin aksionar Shpërndarja e fitimit të vitit 2013 në rezervë	-	4,218	(121,140)	148,116	26,976
<b>Gjëndja më 31 dhjetor 2014</b>	<b>7,587,914</b>	<b>453,868</b>	<b>(15,039)</b>	<b>54,551</b>	<b>8,081,294</b>
Fitimi neto për vitin	-	-	-	96,428	96,428
Ndryshimi neto në vlerën e drejtë të letrave me vlerë të vlefshme për shitje	-	-	33,377	-	33,377
Rritje në kapitalin aksionar Shpërndarja e fitimit të vitit 2014 në rezervë	-	7,407	33,377	96,428	129,805
<b>Gjëndja më 31 dhjetor 2015</b>	<b>7,587,914</b>	<b>461,275</b>	<b>18,338</b>	<b>143,572</b>	<b>8,211,099</b>

*Shënimet shoqëruese në faqet 5 deri në 73 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.*

**BANKA NBG ALBANIA SHA**

**PASQYRA E FLUKSIT TË PARASË**  
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2015 në '000 Lek	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2014 në '000 Lek
<b>Rrjedha e parasë nga veprimtaritë operative:</b>			
Fitimi para tatimit		144,976	200,038
<b>Rregullime për të rakorduar ndryshimin në aktive neto me paratë e gjeneruara nga veprimtaritë operative:</b>			
Zhvlerësimi dhe amortizimi	11, 12	65,684	65,943
Provigjoni për humbjet nga huatë	24	183,121	143,994
Humbje nga këmbimet në valutë	28	31,786	42,567
Të ardhura nga interesat		(1,687,437)	(1,906,854)
Shpenzimet nga interesat		418,296	842,905
<b>Rrjedha e parasë nga veprimtaritë operative para lëvizjeve në kapitalin punues</b>		<b>(843,574)</b>	<b>(611,407)</b>
<b>Ndryshime në aktive dhe detyrime operative</b>			
(Rritje) / rënie në shuma të kushtëzuara me Bankën Qëndrore dhe banka të tjera	6,7	1,624,267	2,986,326
(Rritje)/Rënie në huatë dhe paradhëniet për klientët	9	(1,817,332)	1,150,433
Rënie/(Rritje) në aktivet e tjera	13,16	22,716	(168,308)
Letra me vlerë të maturuara – të mbajtura për tregtim	8	51,173	53,961
Rritje në detyrimet ndaj bankave dhe institucioneve të kreditit	14	1,087,047	401,347
Rënie në detyrimet ndaj klientëve	15	(6,699,229)	(820,108)
(Rënie)/Rritje në detyrimet e tjera	17	(36,462)	34,682
<b>Para e gjeneruar nga veprimtaritë operative</b>		<b>(6,611,394)</b>	<b>3,026,926</b>
Interes i arkëtuar		1,482,310	1,728,687
Interes i paguar		(285,697)	(588,620)
Tatimi mbi fitimin i paguar	26	(45,203)	(53,615)
<b>Rrjedha neto e parasë e gjeneruar nga veprimtaritë operative</b>		<b>(5,459,984)</b>	<b>4,113,378</b>
<b>Rrjedha e parasë nga veprimtaritë investuese</b>			
Blerjet e aktiveve afatgjata materiale	12	(34,629)	(21,997)
Blerjet e aktiveve afatgjata jomateriale	11	(32,364)	(25,868)
Shitje e letrave me vlerë të vlefshme për shitje	10	2,348,671	-
Blerjet e letra me vlerë të vlefshme për shitje	10	(5,415,542)	(5,279,405)
Letra me vlerë të vlefshme për shitje të maturuara		6,364,097	4,397,660
<b>Rrjedha neto e parasë e përdorur në veprimtaritë investuese</b>		<b>3,230,233</b>	<b>(929,610)</b>
<b>Rrjedha e parasë nga veprimtaritë financuese</b>			
Rritje e kapitalit të paguar		-	-
<b>Rrjedha neto e parasë e gjeneruar nga veprimtaritë financuese</b>		<b>-</b>	<b>-</b>
<b>Rënie neto në para dhe ekuivalentet e saj</b>		<b>(2,229,751)</b>	<b>3,183,768</b>
<b>Paraja dhe ekuivalentet e saj në fillim të vitit (shënimi 29)</b>		<b>7,539,599</b>	<b>4,355,831</b>
<b>Paraja dhe ekuivalentet e saj në fund të vitit (shënimi 29)</b>		<b>5,309,848</b>	<b>7,539,599</b>

Shënimet shoqëruese në faqet 5 deri në 73 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

**BANKA NBG ALBANIA SHA**  
**SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2015**  
*(Të gjitha shumat janë shprehur në '000 Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)*

---

**1. Informacion i përgjithshëm**

Banka NBG Albania sh.a. ("Banka") është filial i Bankës Kombëtare të Greqisë, e cila vepron në të gjithë fushat e aktivitetit bankar dhe veçanërisht në transaksionet tregtare duke përdorur një rrjet të gjerë korrespondentësh ndërkombëtarë.

Banka filloi aktivitetin e saj në fund të muajit Nëntor 1995 si Dega e Tiranës së Bankës Kombëtare të Greqisë me një kapital të paguar prej 200,000 mijë Lek. Gjatë periudhës 1999 - 2012 kapitali i paguar është rritur dhe tani ka vlerën prej 7,587,914 mijë Lek.

Në maj të vitit 2012, Banka ndryshoi formën e saj ligjore nga një degë në filial të Bankës Kombëtare të Greqisë, një proces i mbikëqyrur nga Banka e Shqipërisë që e miratoi si shtojcë të liçencës nr. 08/1 datë 25 maj 2012. Si rezultat i këtij transformimi, Banka ndryshoi emrin e saj në Banka NBG Albania sh.a, formën ligjore në "Shoqëri Aksionare" me një aksionar të vetëm Bankën Kombëtare të Greqisë S.A. me një kapital aksionar në shumën 7,168,604,546 Lek i ndarë në 55,851,664 aksione normale me një vlerë nominale prej 1 EURO (ose 0.92 USD ose 128.35 Lek).

Banka ka organet e veta drejtuese si Asambleshën e Aksionarit të Vetëm, Bordin Drejtues, Komitetin e Auditimit Drejtorinë, dhe Komitetin Ekzekutiv.

Rritja e fundit e kapitalit aksionar u bë më 23 Nëntor 2012 me një vlerë prej 3,000,000 EURO (3 milion aksione të zakonshme me vlerë nominale 1 EURO secili) ekuivalente 419,310 mijë Lek. Më 31 dhjetor 2015, totali i kapitalit aksionari Bankës NBG Albania sh.a. është 7,587,914,546.3 Lek, i përbërë nga 58,851,664 aksione të rregullta me vlerë nominale 1 EURO secila (ose 0.92 USD, ose 128.35 Lek).

Banka operon me një rrjet prej 27 (2014: 27) njësisish të vendosura në Tiranë, Durrës, Korçë, Vlorë, Lezhë, Elbasan, Gjirokastrë, Shkodër, Lushnje, Pogradec, Berat, Sarandë, Fushë Krujë, Fier, Kukës, Bilisht dhe Kavajë.

Më 31 dhjetor 2015, Banka kishte 293 punonjës (31 dhjetor 2014: 284 punonjës).

**Drejtimi i Bankës**

Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv:	Ioannis Agathos
Drejtoresh e Operacioneve:	Brunilda Papa (Jakovi)
Drejtor i Riskut:	Ioannis Antoniadis
Drejtor i Korporatave:	Anastasios Asimakopoulos
Drejtoresh e Shitjeve:	Aida Apostoli



**BANKA NBG ALBANIA SHA**

**SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2015**

*(të gjitha shumat janë shprehur në '000 Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)*

---

**2. Aplikimi i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) të reja dhe të rishikuara**

**2.1 Standarde dhe Interpretime në fuqi në periudhën raportuese**

Politikat kontabël të aplikuara janë në përputhje me politikat e vitit financiar të mëprashëm. Ndryshimet e mëposhtme të standardeve janë në fuqi për periudhën raportuese pas 1 janar 2015:

- **Përmirësimet vjetore e ciklit të SNRF-ve 2011-2013 të cilat përmbajnë ndryshime të vogla në qartësimet për:**
- **SNRF 3 Kombinimet e bizneseve**
- **SNRF 13 Matja me vlerën e drejtë**
- **SNK 40 Aktivët material afatgjatë të investuara**

Këto ndryshime në standardet ekzistuese dhe interpretimet nuk kanë ndikuar në politikat kontabël të Bankës.

**2.2 Standarde dhe interpretime të publikuara, që nuk janë akoma në fuqi dhe as të aplikuara**

Standardet e publikuara, por që nuk janë akoma në fuqi dhe as nuk janë aplikuar hershëm nga Banka janë listuar më poshtë. Ky listim përmban standarde dhe interpretime të publikuara, për të cilat Banka pret të kenë ndikim në shënimet shpejguese, pasqyrën e pozicionit financiar, performancë kur të aplikohen në një datë të ardhshme. Banka ka qëllim t'i aplikojë standardet kur ato të bëhen efektive.

- **SNK 16 Aktivët Afatgjatë Materiale dhe SNK 38 Aktivët Jo-materiale (e ndryshuar) – Qartësimi i Metodës së Amortizimit.** Ndryshimi është efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janar 2016. Këto ndryshime qartësojnë parimet e SNK 16 Aktivët Afatgjatë Materiale dhe SNK 38 Aktivët Jo-materiale se të ardhurat reflektojnë modelin e përfitimeve ekonomike që janë konumuar gjatë përdorimit të aktiveve. Si pasojë, raporti i të ardhurave të gjeneruar ndaj totali të të ardhurave të pritshme për t'u gjenruar nuk mund të përdoret si raport për amortizimin e mjeteve afatgjatë materiale dhe mund të përdoret në rrethana të limituara për amortizimin e aktive afatgjatë jomateriale. Banka nuk e përdor raportin e të ardhurave për qëllime të amortizimit dhe drejtimi ka vlerësuar se ky qartësim nuk do të ketë ndikim për Bankën kur të bëhet efektive.
- **SNK 19 Përfitimet e punonjësve (e ndryshuar): Kontributet e punonjësve** - Ky ndryshim është efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 korrik 2014. Ky ndryshim aplikohet në kontributet nga punonjësit ose palë të treta për të përcaktuar një skemë përfitimi. Aktualisht Banka nuk i ofron punonjësve ndonjë skemë përfitimi të përcaktuar dhe ky ndryshim nuk do të ketë ndikim te Banka.
- **SNRF 9 Instrumentet financiare** - Standardi aplikohet për periudha vjetore që fillojnë më ose pas 1 janar 2018, aplikimi i hershëm është i lejuar. Faza finale e SNRF 9 reflekton të gjitha fazat e projektit të instrumenteve financiare dhe zëvendëson SNK 39 Instrumentet Financiare: Njohja dhe Matja dhe versionet e mëparshme. Standardi prezanton kërkesa të reja për klasifikimin dhe matjen, zhvlerësimin dhe kontabilitetin mbrojtës. Drejtimi është ende në procesin e vlerësimit të ndikimit e këtij ndryshimi dhe nëse do ta aplikojë një përdorim të hershëm.
- **SNRF 11 Marrëveshjet e përbashkëta (e ndryshuar): Kontabiliteti për blerjen e interesave në operacionet e përbashkëta** - Ndryshimi është efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janar 2016. Ai shton udhëzime të reja në kontabilizimin e blerjeve të interesave që përbëjnë një biznes në përputhje me SNRF. Nuk pritet që ky ndryshim të jetë i rëndësishëm për bankën. Banka nuk ka ndonjë marrëveshje të përbashkët.

**BANKA NBG ALBANIA SHA**

**SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2015**

*(të gjitha shumat janë shprehur në '000 Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)*

---

**2. Aplikimi i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) të reja dhe të rishikuara (vazhdim)**  
**2.2 Standarde dhe interpretime të publikuara, që nuk janë akoma në fuqi dhe as të aplikuara (vazhdim)**

- **SNFR 15 Të ardhura nga kontratat me klientët** - Standardi është efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2018. SNRF 15 përcakton modelin me pesë hapa që do të aplikohet për të ardhurat e fituara nga kontratat me klientë (me përjashtime të kufizuara), pavarshisht llojit të transaksioneve të të ardhurave ose industrisë. Kërkesat e standardit do të aplikohen në njohjen dhe matjen e fitimit dhe humbjes nga shitja e disa aktive jo-financiare që nuk janë të hyra nga aktiviteti i zakonshëm i njësisë ekonomike (p.sh. shitja e aktiveve afatgjata materiale ose jomateriale). Dhënia e informacion shpjeguese të detajuara do të kërkohej, duke përfshirë ndarjen e të ardhurave totale; informacion për kontratat e premtimit; ndryshimet në tepricat e aktiveve dhe detyrimet kontraktuale ndërmjet periudhave dhe gjykimeve e vlerësimeve kyce. Menaxhimi është ende në procesin e vlerësimit të ndikimit që standardi do të ketë, por gjithsesi duke qenë një institucion financiar, nuk pritet një ndikim i rëndësishëm.
- **SNK 27 Pasqyra financiare individuale (e ndryshuar). Ndryshimi është efektiv nga 1 janari 2016** - Ky ndryshim do të lejojë njësitë ekonomike të përdorin metodën e kapitalit neto në kontabilizimin e investimeve në filiale, sipërmarrje të përbashkëta dhe pjesëmarrje në pasqyrat financiare të tyre të veçanta dhe do të ndihmojë disa juridiksione të kalojnë në SNRF për pasqyrat individuale financiare, reduktimin e kostove të përputhshmërisë pa reduktuar informacionin në dispozicion të investitorëve. Banka aktualisht nuk ka investime në subjektet të tjera dhe ndryshimi nuk do të ketë ndikim për Bankën.
- **SNK 1: Paraqitje e pasqyrave financiare (e ndryshuar)** - Ndryshimet në SNK 1 Paraqitja e Pasqyrave Financiare inkurajojnë kompanitë për të aplikuar më tej gjykimin profesional në përcaktimin se çfarë informacioni do të paraqitet dhe se si do të strukturohet ai në pasqyrat financiare. Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2016. Ndryshimet në SNK nuk janë thelbësore por sqarojnë SNK 1 ekzistuese. Ndryshimet kanë të bëjnë me materialitetin, me radhën e notave, nëntotaleve dhe ndarjes, politikave kontabël dhe paraqitjen e zërave të të ardhurave të tjera përmbledhëse, që rrjedhin nga investimet e mbajtura me metodën e kapitalit. Menaxhimi është duke vlerësuar ndikimin e këtij ndryshimi duke qenë se vazhdimisht përpiqet të përmirësojë prezantimin dhe rëndësinë e informacionit në pasqyrat financiare.
- **SNRF 14 Llogaritë e Shtyra për Arsye Rregullatore** - Ky standard është efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janar 2016. Qëllimi i këtij standardi të përkohshëm është të përmirësojë krahasueshmërinë e raportimit financiar për subjektet të cilat janë subjekt i rregullimit të normës, ku shteti vendos për cmimin për aktivitete veçanta. Kjo mund të përfshijë shërbimet të tilla si gaz, energji elektrike dhe ujë. Standardi kërkon që për aplikuesit e hershëm efekti i rregullimit të normës duhet të paraqitet veçmas nga zërat e tjerë dhe nga përjashtimet nga grantet. Duke qenë se Banka ka aplikuar SNRF-në në periudhat e mëparshme dhe nuk është e angazhuar në aktivitete të rregulluara të qeverisë, nuk pritet që standardi do të jetë i rëndësishëm për Bankën.
- **SNRF 16 Qiratë** - Standardi është efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më 1 janar 2019 dhe më pas. SNRF 16 kërkon që qiramarrësit të njohin pjesën më të madhe të qirave në bilanc dhe të kenë një model kontabilizimi të vetëm për të gjitha qiratë, me përjashtime të caktuara. Kontabilitetit i qiradhënësit është në thelb i pandryshuar. Banka do të analizojë dhe vlerësojë ndikimin e standardit të ri në pasqyrën e pozicionit financiar dhe performancës.

**BANKA NBG ALBANIA SHA**

**SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2015**

*(të gjitha shumat janë shprehur në '000 Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)*

---

**2. Aplikimi i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) të reja dhe të rishikuara (vazhdim)**  
**2.2 Standarde dhe interpretime të publikuara, që nuk janë akoma në fuqi dhe as të aplikuara (vazhdim)**

- **SNK 27 Pasqyra financiare individuale (e ndryshuar)** - Ndryshimi është efektiv nga 1 janari 2016. Ky ndryshim do të lejojë njësitë ekonomike të përdorin metodën e kapitalit neto në kontabilizimin e investimeve në filiale, sipërmarrje të përbashkëta dhe pjesëmarrje në pasqyrat financiare tyre të veçanta dhe do të ndihmojë disa juridiksione të kalojnë në SNRF për pasqyrat individuale financiare, reduktimin e kostove të përputhshmërisë pa reduktuar informacionin në dispozicion të investitorëve. Banka aktualisht nuk ka investime në subjektet të tjera dhe ndryshimi nuk do të ketë ndikim për Bankën.
- **Ndryshime në SNRF 10 “Pasqyrat financiare të konsoliduara” dhe SNK 28 “Investime në pjesëmarrje dhe sipërmarrje të përbashkëta”**- Shitja apo kontributi i pasurive ndërmjet një investitori dhe bashkëpunatori të tij ose sipërmarrje të përbashkët (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2016). Banka nuk ka asnjë investim në pjesëmarrje ndaj nuk përgatit pasqyra financiare të konsoliduara dhe si rrjedhojë ndryshimet në standard nuk ndikojnë Bankën.
- **SNK 12 Tatimi mbi të ardhurat (e ndryshuar)** - Njohja e akitvit tatimor të shtyrë për humbje të përealizuara. Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore më ose pas 1 janar 2017, duke u lejuar aplikimi i hershëm. Objektivi i këtyre ndryshimeve është të qartësojnë kontabilizimin e aktivitetit tatimor të shtyrë për humbje të përealizuara në instrumete të borxhit të matura me vlerën e drejtë. Për shmebull, ndryshimet qartësojnë kontabilizim për aktivitetin tatimor të shtyrë kur një njësi nuk lejohet të zbresë humbjet e përealizuara për qëllime tatimore ose kur ka mundësinë dhe qëllimin t'i mbajë instrumentet e borxhit deri sa të mbyllet humbja e përealizuar. Këto ndryshime nuk janë miratuar ende nga BE-ja. Nuk pritet që këto ndryshime të jenë të rëndësishme për Bankën.
- **SNK 7 Pasqyra e fluksit monetar (e ndryshuar)** - Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janar 2017, duke lejuar aplikimin e hershëm. Objektivi i këtyre ndryshimeve është t'u mundësojë përdoruesve të informacionit financiar të vlerësojnë ndryshimet në detyrime që rrjedhin nga aktivitetet financiare. Ndryshimet u kërkojnë njësitë të japin informacion që u lejon investitorëve të vlerësojnë ndryshimet në detyrime që rrjedhin nga aktivitetet financiare, duke përfshirë ndryshimet që rrjedhin nga fluksi monetar dhe ndryshimet jo-monetare. Ndryshimet nuk janë miratuar akoma nga BE-ja. Nuk pritet që këto ndryshime të jenë të rëndësishme për Bankën.

**Përmirësime vjetore të SNRF-ve, Cikli 2010-2012**

BSNK ka publikuar përmirësimet e përvitshme të SNRF-ve, cikli 2010-2012, ku janë publikuar shtatë standarde që hyjnë në fuqi që nga 1 shkurt 2015. Një përmbledhje e ndryshimeve të publikuara paraqiten më poshtë:

- **SNRF 2 Pagesat e bazuara në aksione** - ndryshim në përkufizimin “kondita të kushtëzimit” dhe “kushte tregu” dhe shtuar përkufizimi i “kushtit të performancës” dhe “kushtit të shërbimit”.
- **SNRF 3 Kombinimet e bizneseve** - qartësim në kontabilizim për konsideratat eventuale që vijnë nga kombinimi i bizneseve.
- **SNRF 8 Segmentet e shfrytëzimit** – dhënie informacioni shtesë të gjykimit të menaxhimit për segmentet e shfrytëzimit dhe qartësim në rakordimin e aktiveve totale të segmenteve me aktivitetin e njësisë.

**BANKA NBG ALBANIA SHA**

**SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2015**

*(të gjitha shumat janë shprehur në '000 Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)*

---

**2. Aplikimi i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) të reja dhe të rishikuara (vazhdim)**

**2.2 Standarde dhe interpretime të publikuara, që nuk janë akoma në fuqi dhe as të aplikuara (vazhdim)**

**Përmirësime vjetore të SNRF-ve, Cikli 2010-2012 (vazhdim)**

- **SNRF 13 Matja me vlerën e drejtë** - qartësim në lidhje me SNRF 9 për sa i përket të arkëtueshmeve dhe detyrimeve afatshkurtra.
- **SNK 16 Aktivët afatgjatë materiale** - ndryshime që tregojnë se kur një zë i aktiveve afatgjatë materiale rivlerësohet, vlera kontabël bruto rregullohet në mënyrë konsistente me rivlerësimin e vlerës kontabël, ndryshe amortizimi i akumuluar llogaritet si diferencë e vlerës kontabël bruto me vlerën kontabël pasi janë marrë në konsideratë humbjet nga zhvlerësimi i akumuluar.
- **SNK 24 Palët e lidhura** – qartëson që një njësi menaxhimi që ofron shërbime kyçe menaxhimi për një njësi raportuese i kërkohet të trajtohet si pale e lidhur, kërkohet informacion për pagesën e bërë ose detyrimin për shërbimin;
- **SNK 38 Aktive Jo-materiale** - të njëjta ndryshime si për SNK 16 më sipër.

Banka është në proces të vlerësimit të ndikimit që këto ndryshime mund të kenë në pasyrat e saj financiare.

**Përmirësime vjetore të SNRF-ve, Cikli 2012-2014**

BSNK ka publikuar përmirësimet e përvitshme të ciklit 2012-2014 të SNRF-ve, që është një përmbledhje e ndryshimeve në SNRF. Ndryshimet janë efektive që nga 1 janar 2016.

- **SNRF 5 Aktive afatgjatë që mbahen për t'u shitur dhe operacionet jo të vijueshme** - Ndryshimi sqaron se ndryshimi nga një metodë nxjerrjeje jashtë përdorimi të tjetra (me anë të shitjes apo shpërndarjes të pronarët), nuk duhet të konsiderohet si nxjerrje jashtë përdorimi, por ajo është një vazhdim i planit fillestar. Prandaj, nuk ka asnjë ndërprerje të zbatimit të kërkesave të SNRF Ndryshimi gjithashtu sqaron se ndryshimi në metodën e nxjerrjes jashtë përdorimit nuk ndryshon datën e klasifikimit.
- **SNRF 7 Instrumentet financiare - Dhënie informacionesh shpjeguese** - Ndryshimi sqaron se një kontratë shërbimi që përfshin një tarifë mund të përbëjë një përfshirje të vazhdueshme në një aktiv financiar. Gjithashtu, ndryshimi sqaron se kompensimi i aktiveve dhe pasiveve financiare nuk është i nevojshëm në raportin financiar të ndërmjetëm të konsoliduar.
- **SNK 34 Raportimi financiar i ndërmjetëm** - Banka nuk raporton asnjë raportim financiar të ndërmjetëm.
- **SNRF 10, 12 dhe SNK 28: Shoqëritë investuese** - Aplikimi për përjashtimin nga konsolidimi (Ndryshimet). Ndryshimet adresojnë tre çështje që lindin nga praktika në aplikimin e përjashtimit nga konsolidimi. Banka nuk plotëson përkufizimin e shoqërisë investuese dhe ndryshimet nuk janë të zbatueshme.

**BANKA NGB ALBANIA SHA**  
**SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2015**  
*(të gjitha shumat janë shprehur në '000 Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)*

---

**3. Bazat e Përgatitjes**

**3.1 Deklarata e përputhshmërisë**

Pasqyrat financiare të Bankës janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF").

**3.2 Bazat e matjes**

Këto pasqyra financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike, përveç letrave me vlerë të mbajtura për tregtim dhe letrave me vlerë të vlefshme për shitje, të cilat janë paraqitur me vlerën e drejtë.

**3.3 Paraqitja e pasqyrave financiare**

Pasqyrat financiare të Bankës janë përgatitur në bazë të supozimit të vijimësisë. Çështje të rëndësishme që ndikojnë në këtë supozim janë paraqitur me më shumë detaje në shënimin 5 (supozimi i vijimësisë). Menaxhimi i Bankës ka bërë një vlerësim të aftësisë së saj për të operuar në vijimësi dhe është i kënaqur që ka burime për të vazhduar në të ardhmen e parashikuar. Për më tepër, menaxhimi nuk është në dijeni të ndonjë pasigurie materiale, që mund të hedh dyshime të konsiderueshme mbi aftësinë e Bankës për të vazhduar në vijimësi. Prandaj, pasqyrat financiare vazhdojnë të jenë të përgatitur në bazë vijimësie.

**3.4 Monedha funksionale dhe raportuese**

Pasqyrat financiare paraqiten në Lek shqiptar ("Lek"), e cila është monedha kryesore e mjedisit ekonomik në të cilin vepron Banka (monedha funksionale). I gjithë informacioni financiar paraqitet në Lek dhe i përafëruar në mijëshe (përveç kur shprehet ndryshe).

Politikat e rëndësishme kontabël janë paraqitur më poshtë.

**4. Politika të rëndësishme kontabël**

**4.1 Monedha të huaja**

Në përgatitjen e pasqyrave financiare transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në Lek me kursin e këmbimit në datën e kryerjes së transaksionit. Në çdo datë raportimi, zërat monetarë të pasqyrës së pozicionit financiar të shprehur në monedhë të huaj rivlerësohen në Lek me kursin në datën e raportimit. Zërat jo monetarë të mbajtur me vlerë të drejtë të shprehur në monedhë të huaj konvertohen në Lek me kursin e datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Zërat jo monetarë në monedhë të huaj që maten me kosto historike nuk konvertohen.

Diferencat që lindin nga kurset e këmbimit regjistrohen në pasqyrën e fitimit ose humbjes.

Kurset zyrtare të këmbimit për monedhat kryesore të përdorura në konvertimin e zërave të pasqyrës së pozicionit financiar të paraqitura në monedhë të huaj ishin si më më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2015</u>	<u>31 dhjetor 2014</u>
Lek / EUR	137.28	140.14
Lek / USD	125.79	115.23



**BANKA NGB ALBANIA SHA**  
**SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2015**  
*(të gjitha shumat janë shprehur në '000 Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)*

---

**4. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)**

**4.2 Aktive dhe detyrime financiare**

**(i) Njohja**

Banka fillimisht njihet huatë, parapagimet dhe depozitat me kosto në datën kur i lind e drejta dhe detyrimi. Të gjitha aktivet dhe detyrimet e tjera financiare njihen në datën e tregtimit, datë në të cilën Banka bëhet palë e dispozitave kontraktuale të instrumentit.

**(ii) Klasifikimi**

Banka i klasifikon aktivet e saj në një nga kategoritë e mëposhtme:

- Hua dhe llogari të arkëtueshme;
- Investime të mbajtura deri në maturim;
- Investime të mbajtura me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes dhe brenda kategorisë si të mbajtura për tregtim;
- Investime të vlefshme për shitje;

Shih shënimet 4.3, 4.4 (i), 4.4 (ii), 4.4 (iii), 4.12.

Banka i klasifikon detyrimet e saj financiare, përveç garancive financiare dhe angazhimeve të huasë, si të matura me koston e amortizuar apo me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes. Shih 4.16.

**(iii) Çregjistrimi**

Banka çregjistron një aktiv financiar nëse të drejtat kontraktuale ndaj rrjedhjeve monetare që vijnë nga aktivi skadojnë ose nëse Banka transferon të drejtat për të marrë rrjedhat e kontraktuara të parasë nga aktivet financiare nëpërmjet një transaksioni në të cilin transferohen të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë mbi aktivin financiar.

Çdo interes në aktive financiare të transferueshme, që përfitohet ose mbahet nga Banka, njihet si një aktiv ose detyrim më vete.

Detyrimet financiare çregjistrohen nga Banka nëse detyrimet kontraktuale të Bankës mbarojnë, janë anuluar ose kanë skaduar.

Banka merr pjesë në transaksione me anë të të cilave transferon aktive të njohura në pasqyrën e pozicionit financiar, por mban në të njëjtën kohë të gjitha rreziqet dhe përfitimet e aktivitetit të transferuar, ose një pjesë të tyre. Nëse të gjitha rreziqet dhe përfitimet mbahen, atëherë aktivet e transferuara nuk çregjistrohen nga pasqyra e pozicionit financiar. Transferimi i aktiveve për të cilat mbahen të gjitha rreziqet dhe përfitimet përfshin për shembull huadhënien e letrave me vlerë dhe transaksionet e riblerjeve. Në transaksione në të cilat Banka nuk mban dhe nuk transferon rreziqet dhe përfitimet e pronësisë mbi aktivet financiare, ajo e çregjistron aktivin nëse kontrolli mbi të humbet.

Të drejtat dhe detyrimet e mbajtura në transferim janë të njohura më vete si aktive ose detyrime sipas rastit. Në transferimet e aktiveve mbi të cilat mbahet kontrolli, Banka vazhdon ta njohë aktivin deri në momentin e përfshirjes së saj të vazhdueshme, e përcaktuar kjo nga koha gjatë së cilës Banka është e ekspozuar ndaj ndryshimeve në vlerën e aktivitetit të transferuar.

**BANKA NBG ALBANIA SHA**  
**SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2015**  
*(të gjitha shumat janë shprehur në '000 Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)*

---

**4. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)**

**4.2 Aktive dhe detyrime financiare (vazhdim)**

**(iv) Kompensimi**

Aktivitet dhe detyrimet financiare kompensohen dhe shuma neto paraqitet në bilanc kur, dhe vetëm kur, Banka ka të drejtën ligjore për të kompensuar shumat dhe ajo synon ose të shlyejë ato në baza neto ose të realizojë aktivin dhe të shlyejë detyrimin njëkohësisht.

Të ardhurat dhe shpenzimet paraqiten në bazë neto vetëm atëherë kur lejohet sipas SNRF, ose për fitimet dhe humbjet e krijuara nga një grup transaksionesh të ngjashme si ato në aktivitetin tregues të Bankës.

**(v) Matja e kostos së amortizimit**

Kostoja e amortizuar e një aktivi ose detyrimi financiar është vlera me të cilën aktivi ose detyrimi njihet në momentin fillestar, duke i zbritur pagesat e principalit, plus ose minus amortizimin e akumuluar, duke përdorur metodën e interesit efektiv për çdo diferencë ndërmjet vlerës fillestare të njohur dhe vlerës në maturitet, minus çdo zbritje për efekt zhvlerësimi.

**(vi) Matja e vlerës së drejtë**

Vlera e drejtë është çmimi që do të përfitohet nga shitja e një aktivi apo vlera që do të paguhej për të transferuar një detyrim në një transaksion mes pjesëmarrësve të tregut në datën e principalit, apo në mungesë të tij, dhe tregut në të cilin banka ka akses në atë datë. Vlera e drejtë e një detyrimi reflekton rrezikun e mos-performancës.

Kur është e aplikueshme, Banka mat vlerën e drejtë të një instrumenti duke përdorur çmimin e kuotuar në një treg aktiv ku gjenden instrumenta të ngjashëm. Një treg konsiderohet si aktiv kur transaksionet për aktivin ose detyrimin kryhen shpesh dhe në mënyrë voluminoze për të siguruar një informacion për çmimin mbi bazën e vijimësisë.

Kur nuk ka një çmimi të kuotuar në treg aktiv, Banka përdor teknika vlerësimi që maksimizojnë përdorimin e faktorëve të vëzhgueshëm të rëndësishëm dhe minimizojnë përdorimin e faktorëve të pavëzhgueshëm. Teknikat e përzgjedhura përfshijnë të gjithë faktorët të cilët pjesëmarrësit e tregut do të merrnin parasysh në vendosjen e një çmimi.

Evidenca më e mirë e vlerës së drejtë së një instrumenti financiar në njohjen fillestare zakonisht është çmimi i transaksionit - p.sh. vlera e drejtë e shumës së dhënë ose të marrë. Nëse Banka përcakton se vlera e drejtë në njohjen fillestare ndryshon nga çmimi i transaksionit dhe vlera e drejtë nuk është evidentuar as nga çmimi i kuotuar në një treg aktiv për një aktiv ose detyrim të ngjashëm, dhe as në bazë të një teknike vlerësimi që përdor vetëm të dhëna nga tregje të mbikëqyrura, instrumenti financiar matet fillimisht me vlerën e drejtë, të rregulluar për të shtyrë ndryshimin midis vlerës së drejtë në njohjen fillestare dhe çmimit të transaksionit. Më pas, kjo diferencë njihet në fitim ose humbje mbi një bazë të përshtatshme përgjatë jetës së instrumentit, por jo më vonë se kur vlerësimi mbështetet plotësisht nga të dhëna të vëzhgueshme të tregut ose kur transaksioni është i mbyllur.

Në qoftë se një aktiv ose detyrim i matur me vlerën e drejtë ka një çmim oferte dhe një çmim kërkese, Banka mat aktivet dhe pozicionet e gjata me çmimin e ofertës dhe detyrimet dhe pozicionet e shkurtra me çmimin e kërkesës.

Portofolet e aktiveve financiare dhe detyrimeve financiare që janë të ekspozuar ndaj rrezikut të tregut dhe rrezikut të kredisë të manaxhuar nga Banka në bazë të ekspozimit neto të rrezikut të kredisë apo të tregut, maten në bazë të çmimit që do të merret nga shitja e një pozicioni neto të gjatë (ose paguar për të transferuar një pozicion neto të shkurtër) për një ekspozim të veçantë rreziku. Këto rregullime të nivelit të portofolit u ndahen aktiveve dhe detyrimeve individuale në bazë të rregullimit të rrezikut relativ të secilit prej instrumentave të veçantë në portofol.

**BANKA NBG ALBANIA SHA**

**SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2015**

*(të gjitha shumat janë shprehur në '000 Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)*

---

**4. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)**

**4.2 Aktive dhe detyrime financiare (vazhdim)**

**(vi) Matja e vlerës së drejtë (vazhdim)**

Banka njih transferimet ndërmjet niveleve të hierarkisë së vlerës së drejtë deri në fund të periudhës raportuese në të cilën ka ndodhur ndryshimi.

Për të përcaktuar vlerën e drejtë, Banka përdor hierarkinë e mëposhtme të vlerës së drejtë që reflekton rëndësinë e të dhënave të përdorura për llogaritjet:

- Niveli 1: Çmimi i kuotuar në treg (i parregulluar), në një treg aktiv për një instrument të njëjtë.
- Niveli 2: Metodot e vlerësimit të bazuara në të dhënat e vëzhgueshme direkte (p.sh. çmimet) ose indirekte (p.sh. të derivuara nga çmimet). Kjo kategori përfshin instrumente të vlerësuar duke përdorur çmimet e kuotuar në tregje aktive për instrumente të ngjashëm; çmime të kuotuar për instrumente identike ose të ngjashëm në tregje që konsiderohen më pak se aktive; ose metoda të tjera vlerësimi, ku të gjitha të dhënat e rëndësishme janë të vëzhgueshme në mënyre direkte ose indirekte nga të dhënat e tregut.
- Niveli 3: Metodot e vlerësimit që nuk përdorin të dhëna të vëzhgueshme e të rëndësishme. Kjo kategori përfshin të gjithë instrumentet ku teknikat e vlerësimit përfshijnë të dhëna jo të bazuara në të dhëna të vëzhgueshme dhe të dhënat e vëzhgueshme kanë efekt të rëndësishëm në vlerësimin e instrumenteve. Kjo kategori përfshin instrumente që janë vlerësuar bazuar në çmimin e kuotuar të instrumenteve të ngjashëm, ku kërkohen rregullime të rëndësishme, të vëzhgueshme ose supozime për të reflektuar diferencat ndërmjet instrumenteve.

Vlera e drejtë për aktivet dhe detyrimet financiare që tregtohen në tregje aktivë bazohen në çmime tregu të kuotuar apo kuotimeve të agjentëve. Për të gjitha instrumentat e tjerë financiarë Banka përcakton vlerën e drejtë duke përdorur teknika të tjera vlerësimi.

Teknika të tjera të vlerësimit përfshijnë vlerën aktuale neto dhe modele të skontimit të flukseve monetare, krahasime me instrumenta të ngjashëm për të cilët ekzistojnë çmime të vëzhgueshme tregu, modeli Black Scholes dhe modele të tjera vlerësimi. Supozimet dhe faktorët e përdorur në teknikat e vlerësimit përfshijnë norma interesi referuese dhe pa rrezik dhe prime të përdorura në vlerësimin e normave të skontuara, çmimet e kapitalit dhe obligacioneve, kurset e këmbimit të monedhave të huaja, kapitalin dhe çmimet e indeksit të kapitalit dhe luhatjet dhe korelacionet e çmimeve.

Objekti i teknikave të vlerësimit është të arrijë në përcaktimin e vlerës së drejtë që reflekton çmimin, që do të përfitohej nga shitja e e aktivitetit apo paguhej nga transferimi i detyrimit në një transaksion të zakonshëm ndërmjet pjesëmarrësve të tregut në datën e raportimit.

Banka përdor modele vlerësimi të njohura gjërësisht për përcaktimin e vlerës së drejtë të instrumentave të zakonshëm dhe të thjeshtë, si normat e interesit dhe këmbime të monedhave që përdorin të dhëna të publikuara nga tregu dhe kërkojnë pak gjykim dhe vlerësim. Çmimet e vëzhgueshme dhe faktorët model zakonisht janë në dispozicion në treg për borxhet e vlerësuar dhe letrat me vlerë të kapitalit, derivativeve për kurset e këmbimit dhe derivativeve të thjeshtë sipas bartesës të interesit. Disponibiliteti i çmimeve të publikuar në bursë redukton nevojën për gjykim dhe vlerësim dhe gjithashtu redukton pasigurinë e shoqëruar me përcaktimin e vlerës së drejtë. Disponueshmëria e çmimeve në bursë dhe faktorëve ndryshon në varësi të produkteve dhe tregjeve dhe është i prirur të ndryshojë në bazë të ngjarjeve të veçanta dhe kushteve të përgjithshme të tregjeve financiare.

**BANKA NBG ALBANIA SHA**  
**SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2015**  
*(të gjitha shumat janë shprehur në '000 Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)*

---

**4. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)**

**4.2 Aktive dhe detyrime financiare (vazhdim)**

**(vi) Matja e vlerës së drejtë (vazhdim)**

Megjithatë, kur Banka mat portofolet e aktiveve dhe pasiveve financiare në bazë të ekspozimeve neto, ajo zbaton gjykim në përcaktimin e rregullimeve të duhura të nivelit të portofolit të tilla si oferta, tendera. Rregullime të tilla rrjedhin nga diferencat e kërkesë ofertës të vrojtueshme për instrumenta të ngjashëm dhe të rregulluar nga faktorë të veçantë të portofolit.

Më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 të gjitha instrumentat financiare janë matur me koston e amortizuar dhe vlerën e drejtë përkatëse. Vlera e drejtë më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 për Bonot e Thesarit dhe Obligacionet e Qeverisë Shqiptare janë matur bazuar në nivelin 2 të hierarkisë, ndërsa për Eurobondin e Qeverisë Shqiptare vlera e drejtë është matur bazuar në nivelin 1 të hierarkisë pasi është i kuotuar në treg të hapur.

*Hua për klientët:* Vlera e drejtë e huave për klientët, norma e kredive e të cilave nuk është e vëzhgueshme në treg, dhe do të matet duke përdorur Nivelin 3 të hierarkisë të vlerës së drejtë. Vlera e drejtë e huave përafrohet me vlerën e tyre kontabël sepse portofoli i huave përbëhet kryesisht nga hua me interes të ndryshueshëm, që riçmohen çdo 3 – 12 muaj.

*Depozitat:* Të gjitha depozitat dhe detyrimet ndaj klientëve (duke përfshirë depozitat me afat) duhet të klasifikohen në Nivelin 3 të hierarkisë të vlerës së drejtë. Kohëzgjatja mesatare e portofolit të depozitave është më pak se 1 vit (afërsisht 6 muaj) duke përafëruar vlerësimin më vlerën e drejtë me vlerën e tyre kontabël.

*Huatë nga bankat:* Të gjitha depozitat nga bankat maten sipas Nivelit 3 të hierarkisë.

*Borxhi i varur:* Borxhi i varur dhe borxhi i varur hibrid mbartin norma interesi të ndryshueshme, që riçmohen çdo tre muaj. Norma e interesit përbëhet nga Euribor plus marzh. Më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 vlera e drejtë e borxhit të varur është matur bazuar në nivelin 3 të hierarkisë.

Vlera e drejtë e parasë dhe ekuivalentëve të saj, huave dhe parapagimeve ndaj bankave janë përafërsisht të njëjta me vlerën e mbartur si pasojë e afatit të shkurtër të maturimit të tyre.

Duke marrë në konsideratë natyrën e aktiveve dhe detyrimeve financiare, Banka nuk shpreh vlerën e drejtë të huave, të arkëtueshmeve, të borxhit të varur dhe depozitave sepse vlera e tyre e drejtë është e përafëruar me vlerën e tyre të mbartura, për faktin se këto instrumente financiare mbartin norma interesi të ndryshueshme, të cilat pasqyrojnë ndryshimet në kushtet e tregut.

**BANKA NBG ALBANIA SHA**  
**SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2015**  
*(të gjitha shumat janë shprehur në '000 Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)*

**4. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)**

**4.2 Aktivet dhe detyrimet financiare (vazhdim)**

*(vi) Matja e vlerës së drejtë (vazhdim)*

Tabela në vijim paraqet vlerat e mbartura dhe vlerat e drejta të aktiveve dhe detyrimeve financiare dhe analizon instrumentet financiare të matur me vlerën e drejtë në fund të periudhës së raportimit, sipas niveleve të hierarkisë së vlerës së drejtë, nëpërmjet së cilës matja e vlerës së drejtë është kategorizuar si më poshtë:

**31 dhjetor 2015**

	Vlera e drejtë				
	Vlera e mbartur	Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3	Totali
Hua dhe parapagime nga bankat	3,830,841	-	3,830,841	-	3,830,841
Letra me vlerë të vlefshme për shitje	5,199,843	703,663	4,496,180	-	5,199,843
Hua për klientët, neto	25,283,733	-	-	22,768,241	22,768,241
<b>Totali i aktiveve financiare</b>	<b>34,314,417</b>	<b>703,663</b>	<b>8,327,021</b>	<b>22,768,241</b>	<b>31,798,925</b>
Detyrime ndaj klientëve	26,511,976	-	-	26,396,656	26,396,656
Detyrime ndaj bankave dhe institucioneve financiare	2,307,403	-	-	2,307,403	2,307,403
Borxh i varur	1,647,623	-	-	1,531,233	1,531,233
<b>Totali i detyrimeve financiare</b>	<b>30,467,002</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>30,235,292</b>	<b>30,235,292</b>

**31 dhjetor 2014**

	Vlera e drejtë				
	Vlera e mbartur	Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3	Totali
Hua dhe parapagime nga bankat	6,199,359	-	6,199,359	-	6,199,359
Letra me vlerë të mbajtura për tregtim	51,173	-	51,173	-	51,173
Letra me vlerë të vlefshme për shitje	8,464,177	700,942	7,763,235	-	8,464,177
Hua për klientët, neto	23,801,412	-	-	21,269,902	21,269,902
<b>Totali i aktiveve financiare</b>	<b>38,516,121</b>	<b>700,942</b>	<b>12,785,904</b>	<b>21,269,902</b>	<b>34,756,748</b>
Detyrime ndaj klientëve	33,070,049	-	-	32,964,860	32,964,860
Detyrime ndaj bankave dhe institucioneve financiare	1,186,021	-	-	1,186,021	1,186,021
Borxh i varur	1,681,958	-	-	1,478,353	1,478,353
<b>Totali i detyrimeve financiare</b>	<b>35,938,028</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>35,629,234</b>	<b>35,629,234</b>



#### **4. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)**

##### **4.2 Aktive dhe detyrime financiare (vazhdim)**

###### **(vii) Identifikimi dhe matja e rënies në vlerë**

Në çdo datë raportimi Banka vlerëson nëse ka evidencë objektive që aktivet financiare, të cilat nuk mbahen me vlerën e drejtë përmes fitimit apo humbjes, janë zhvlerësuar. Aktivet financiare zhvlerësohen kur evidenca objektive paraqet një ngjarje, e cila sjell humbje ka ndodhur pas njohjes fillestare të aktivitetit dhe që ngjarja që sjell humbje, ka një ndikim në rrjedhën e ardhshme të parasë së aktivitetit, të cilat mund të maten me besueshmëri. Evidenca objektive që aktivet financiare janë të zhvlerësuara mund të përfshijnë mospagesa ose shkelje nga huamarrësit, ristrukturimin e një huaje të dhënë për një huamarrës ose huadhënës që po falimenton, zhdukjen e një tregu aktiv për një letër me vlerë, ose të dhëna të tjera të dukshme lidhur me një grup aktivesh si p.sh. ndryshime të pafavorshme të aftësive paguese të një huamarrësi ose huadhënësi ose kushtet ekonomike që mund të sjellin mospagesa.

Banka i zhvlerëson aktivet e saj individualisht dhe gjithashtu në grup. Të gjitha aktivet financiare të konsiderueshme, analizohen për provigjionim specifik. Të gjitha aktivet financiare të konsiderueshme që nuk analizohen për provigjionim specifik analizohen në grup për ndonjë provigjion të ndodhur por të paidentifikuar ende. Aktive, të cilat nuk janë individualisht të konsiderueshme, analizohen së bashku për provigjionim duke u grupuar në aktive financiare (të mbajtura me kosto të amortizuar) me karakteristika të njëjta rreziku.

Për trajtimin e provigjionimit në grup, Banka përdor modelimin statistikor të trendeve historike të probabiliteteve të mospagimit, të kohës së rikuperimit dhe vlerës së humbjes së ndodhur, të përshtatura me gjykimin e Drejtimit mbi faktin nëse kushtet aktuale të ekonomisë dhe të kreditimit janë të tilla që humbjet aktuale të jenë më të mëdha ose më të vogla se ato të sugjeruara nga modeli historik. Normat e mospagimeve, normat e humbjes dhe përcaktimi i kohës së rikuperimit krahasohen përkundrejt rezultateve aktuale për të siguruar që ato të mbeten të duhurat.

Nëse kushtet e aktiveve financiare janë rinegociuar apo modifikuar apo një aktiv financiar ekzistues është zëvendësuar me një të ri, për arsye të vështirësive financiarë të huamarrësit, dhe më pas është bërë një vlerësim nëse aktivet financiare duhet të rregjistrohen. Në praktikë huaja e rinegociuar kontabilizohet si një aktiv i ri dhe huaja ekzistuese rregjistrohet. Nëse flukset e mjeteve monetare të aktivitetit të rinegociuar janë plotësisht të ndryshëm, atëherë të drejtat kontraktuale të flukseve të mjeteve monetare nga aktiviteti financiar konsiderohen si të përfunduara. Në këtë rast aktiviteti origjinal financiar rregjistrohet dhe aktiviteti i ri financiar njihet me vlerën e drejtë. Humbja nga zhvlerësimi matet si më poshtë:

- Në qoftë se ristrukturimi i pritur nuk çon në mosnjohje të aktivitetit ekzistues, flukset monetare të vlerësuara që rrjedhin nga aktiviteti financiar i modifikuar, përfshihen në matjen e aktiveve ekzistuese bazuar në kohën e tyre të pritshëm dhe të shumave të zbritur në normën efektive të interesit të aktiveve financiar ekzistuese.
- Nëse ristrukturimi i pritur rezulton në rregjistrimin e pasurisë ekzistuese, atëherë vlera e pritur e drejtë e aktivitetit të ri trajtohet si fluks përfundimtar monetar nga aktiviteti financiar ekzistues në kohën e rregjistrimit të tij. Kjo shumë është e skontuar nga data e pritur e rregjistrimit në datën e raportimit duke përdorur normën fillestare të interesit efektiv të aktivitetit financiar ekzistues.

Humbjet nga provigjionimi i aktiveve të mbajtura me kosto të amortizuar llogariten si diferencë e vlerës kontabël të aktiveve financiare dhe vlerës aktuale të rrjedhjeve monetare të skontuara me vlerën origjinale të interesit efektiv të këtyre aktiveve. Humbjet njihen në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave dhe pasqyrohen në një llogari provigjioni përkundrejt huave dhe parapagimeve. Interesat mbi aktivet e zhvlerësuara vazhdojnë të njihen nëpërmjet skontimeve të pandryshueshme.

#### **4. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)**

##### **4.2 Aktive dhe detyrime financiare (vazhdim)**

###### **(vii) Identifikimi dhe matja e rënies në vlerë (vazhdim)**

Kur një ngjarje pas datës së raportimit shkakton uljen e humbjes nga provigjoni, humbja nga provigjoni rimerret në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve dhe pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave.

Humbja nga provigjionimi i aktiveve financiare të vlefshëm për shitje llogaritet si riklasifikim i humbjeve të mbartura nga rezerva e vlerës së drejtë në kapital tek fitimi ose humbja. Humbja e mbartur, e cila riklasifikohet nga kapitali në fitim ose humbje, është diferenca ndërmjet kostos së blerjes, neto nga amortizimi dhe pagesat e principalit, dhe vlerës së drejtë aktuale, minus çdo humbje nga zhvlerësimi të njohur më parë në fitim ose humbje. Ndryshimet në provigjionin e zhvlerësimit që i atribuohen aplikimit të metodës së interesit efektiv reflektohen si përbërs i të ardhurave nga interesi.

Nëse, në një periudhë të ardhme, vlera e tregut e një letre me vlerë të vlefshme për shitje të zhvlerësuar më parë rritet, dhe rritja lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes në fitim ose humbje të humbjes nga zhvlerësimi, kjo humbje nga zhvlerësimi kthehet mbrapsht me shumën e kthimit të njohur në fitim ose humbje. Gjithsesi, çdo rimarrje e mëpasshme në vlerën e drejtë të një letre me vlerë të vlefshëm për shitje të zhvlerësuar njihet në të ardhurat e tjera përmbledhëse.

##### **4.3 Huatë dhe paradhëniet për klientët**

Huatë dhe paradhëniet për klientët janë aktive financiare jo-derivative, me pagesa fikse ose të përcaktueshme, të cilat nuk janë kuotuar në tregje aktive dhe Banka nuk ka për qëllim t'i shesë në periudha afatshkurtra. Huatë dhe paradhëniet klasifikohen si hua dhe të arkëtueshme.

Huatë dhe paradhëniet fillimisht njihen me vlerë të drejtë plus kosto direkte transaksioni dhe në vazhdim maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Kur Banka blen një aktiv financiar dhe njëherësh hyn në një marrëveshje për ta rishitur këtë aktiv (ose një aktiv kryesisht të ngjashëm) me një çmim të fiksuar në një datë të ardhshme (marrëveshje të anasjellta të riblerjes), marrëveshja kontabilizohet si një hua apo paradhënie dhe aktivet në bazë të marrëveshjes nuk paraqiten në pasqyrat financiare të Bankës.

##### **4.4 Investime në letra me vlerë**

Investimet në letra me vlerë fillimisht llogariten me vlerën e drejtë plus kosto direkte rritëse të transaksionit, në rastin e investimeve në letra me vlerë që nuk mbahen me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbje, dhe më pas kontabilizohen në varësi të klasifikimeve të tyre si të mbajtura deri në maturim, me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbje, ose si të vlefshëm për shitje.

###### **(i) Investimet të mbajtura deri në maturim**

Investimet që mbahen deri në maturim janë aktive financiare joderivative me pagesa fikse të përcaktueshme dhe me maturitet fiks, të cilat Banka ka synimin e qartë dhe aftësinë për t'i mbajtur deri në maturim dhe që nuk janë të mbajtura me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes ose si të vlefshëm për shitje, dhe që nuk plotësojnë përkufizimin e huave dhe të arkëtueshmeve.

#### **4. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)**

##### **4.4 Investimet (vazhdim)**

###### **(i) Të mbajtura deri në maturim (vazhdim)**

Investimet e mbajtura deri në maturim janë mbartur me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, minus humbjet nga rënia në vlerë (shih shënimin 4.2 (vi)). Një shitje apo riklasifikim i një apo më shumë investimeve jo të rëndësishme të mbajtura deri në maturim do të rezultojë në një riklasifikim të investimeve të mbajtura deri në maturim si të vlefshme për shitje dhe do të pengojë Bankën në klasifikimin e investimeve si të mbajtura deri në maturim për periudhën aktuale dhe dy vitet në vijim. Gjithsesi shitjet dhe riklasifikimet në secilën nga situatat e mëposhtme nuk do kërkonin një riklasifikim:

- Shitje apo riklasifikime që janë pranë maturimit, që ndryshojnë nga norma e interesit të tregut nuk do të kenë një efekt të rëndësishëm në vlerën e drejtë të aktiveve financiare;
- Shitje apo riklasifikime pasi Banka ka arkëtuar principalin origjinal të aktiveve;
- Shitje apo riklasifikime të atribuara ngjarjeve të izoluar të papërsëritura përtej kontrollit të Bankës, që nuk mund të parashikohet në mënyrë të arsyeshme.

###### **(ii) Me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes të mbajtura për tregtim**

Aktivët financiarë të mbajtura me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes ("VDNFH") paraqiten me vlerën e drejtë, ku çdo fitim ose humbje që lind nga rima tja e tyre njihet fitim ose humbje të vitit. Banka ka njohur vetëm aktivët financiarë të mbajtura për tregtim.

Një aktiv financiar klasifikohet si i mbajtur për tregtim në qoftë se:

- ai është blerë ose krijuar kryesisht për qëllime shitjeje ose riblerjeje në një periudhë të shkurtër kohe;
- në njohjen fillestare ai është pjesë e një portofoli të instrumentave financiarë të identifikuar që Banka i drejton së bashku dhe për të cilin ka evidencë të ekzistencës së një modeli të kohëve të fundit për realizimin e fitimeve afatshkurtra; ose
- ai është një instrument derivativ që nuk është përcaktuar dhe nuk është efektiv si instrument mbrojtës.

###### **(iii) Investime të vlefshme për shitje**

Investimet e vlefshme për shitje janë ato aktive financiare joderivative që përcaktohen si të vlefshme për shitje ose që nuk klasifikohen në asnjë nga kategoritë e tjera të aktiveve financiare. Investimet e vlefshme për shitje përfshijnë investime në kapital dhe investime në borxh. Investimet në kapital, të cilat nuk janë të kuotuar dhe vlera e drejtë nuk mund të matet në mënyrë të besueshme, mbahen me kosto. Investimet e tjera të vlefshme për shitje mbahen në pasqyrat financiare me vlerën e drejtë të tyre.

Të ardhurat nga interesi njihen në fitim apo humbje, duke përdorur metodën e interesit efektiv. Fitimi ose humbja nga kursi i këmbimit për investimet e borxhit të vlefshme për shitje do të njihen në fitim apo humbje. Humbja nga zhvlerësimi njihet në fitim ose humbje (shih Shënimin 4.2 (vii)).

Ndryshime të tjera në vlerën e drejtë, përveç humbjeve nga zhvlerësimi (shih Shënimin 4.2 (vii)) njihen në të ardhura të tjera përmbledhëse dhe paraqiten si rezervë e vlerës së drejtë në kapital. Kur një investim shitet, fitimi ose humbja e mbartur në kapital, riklasifikohet në fitim ose humbje. Një aktiv financiar jo-derivativ mund të riklasifikohet nga kategoria e investimeve të vlefshme për shitje në kategorinë hua dhe të arkëtueshme, edhe nëse Banka ka për qëllim ta mbajë këtë aktiv financiar në të ardhmen e parashikuar apo deri në maturim.

**BANKA NGB ALBANIA SHA**  
**SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2015**  
*(të gjitha shumat janë shprehur në '000 Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)*

---

#### **4. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)**

##### **4.5 Interesi**

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera përmbledhëse në bazë të metodës së interesit efektiv, me përjashtim të arkëtueshmëve afatshkurtra ku njohja e interesit do të jetë imateriale. Norma e interesit efektiv është norma që skonton pagesat dhe arkëtimet e ardhshme monetare gjatë jetës së pritshme të aktivitetit ose detyrimit financiar (ose kur është e përshtatshme një periudhë më e shkurtër) për t'i barazuar me vlerën kontabël të aktivitetit ose detyrimit financiar. Kur llogarit normën e interesit efektiv, Banka vlerëson rrjedhat e ardhshme të parasë duke marrë në konsideratë të gjithë termat kontraktuale të instrumentit financiar, përveç humbjeve të mundshme që mund të ndodhin.

Llogaritja e normës së interesit efektiv përfshin të gjitha kostot e transaksionit dhe komisionet e paguara ose të marra të cilat janë një pjesë përbërëse e normës efektive të interesit. Kostot e transaksioneve janë kosto shtesë të lidhura drejtpërdrejt me blerjen ose emetimin e një aktivi apo detyrimi financiar.

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi të paraqitura në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera përmbledhëse përfshijnë:

- interesin mbi aktivet dhe detyrimet financiare të matura me kosto të amortizuar mbi baza të interesit efektiv;
- interesin mbi investime të vlefshme për shitje të llogaritura në bazë të interesit efektiv;
- interesin mbi investime të mbajtura për tregtim të llogaritura në bazë të interesit efektiv.

Të ardhurat dhe shpenzimet e interesit në aktivet dhe detyrimet tregtare konsiderohen si të rastësishme në aktivitetin e Bankës dhe paraqiten bashkë me ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve dhe detyrimeve, në zërin e të ardhurave nga aktivitetet tregtare, neto (shih Shënimin 4.7).

##### **4.6 Tarifa dhe komisione**

Të ardhurat dhe shpenzimet nga tarifat dhe komisionet amortizohen gjatë jetës së pritshme të instrumentit financiar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Tarifat e angazhimit për huatë, që kanë shumë mundësi të transferohen dhe të tjera tarifa të lidhura me kreditë shtyhen (bashkë me kostot e tjera rritëse) dhe njihen si një rregullim ndaj normës së interesit efektiv të kredisë.

Të ardhura të tjera nga tarifat dhe komisionet, duke përfshirë tarifat e mirëmbajtjes së llogarive, tarifat e manaxhimit të investimeve, komisionet e shitjes, tarifat nga vendosjet dhe sindikatat, njihen në momentin kur është kryer shërbimi në fjalë. Kur një angazhim në hua nuk pritet të japë një rezultat të zvogëluar, taksat e lidhura me angazhimin pritet të njihen mbi baza lineare përgjatë periudhës së angazhimit. Të ardhura të tjera nga tarifa dhe komisione, që përfshijnë tarifa të mirëmbajtjes së llogarive, tarifa nga vendosjet, njihen në momentin kur shërbimi i lidhur është kryer.

##### **4.7 Të ardhurat tregtare, neto**

Të ardhurat tregtare neto përfshijnë fitime minus humbje që lidhen me aktivet dhe detyrimet e tregtueshme, dhe përfshijnë të gjitha ndryshimet e realizuara dhe të parealizuara të vlerës së drejtë, interesave, dividendëve dhe diferencave të këmbimeve valutore.

##### **4.8 Pagesat e qirasë operative**

Pagesat e bëra nën qiranë operative njihen në pasqyrën përmbledhëse të ardhurave në bazë të metodës lineare mbi jetëgjatësinë e qirasë.

**BANKA NBG ALBANIA SHA**  
**SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2015**  
*(të gjitha shumat janë shprehur në '000 Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)*

---

**4. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)**

**4.9 Shpenzimet operative**

Shpenzimet operative regjistrohen atëherë kur ato ndodhin. Më shumë detaje janë përfshirë në shënimin 25 të pasqyrave financiare.

**4.10 Planet e pensioneve me kontribut të përcaktuar**

Banka paguan vetëm kontribute për sigurimet shoqërore të detyrueshme për përfitimet e punonjësve që dalin në pension. Autoritetet lokale janë përgjegjëse për përcaktimin e limitit minimal ligjor për pensionet në Shqipëri sipas një plani kontributësh të përcaktuar pensionesh. Detyrimet për planin e pensioneve me kontribut të përcaktuar njihen si një shpenzim në pasqyrën përmbledhëse të ardhurave kur ato ndodhin.

**4.11 Shpenzimi i tatim fitimit**

Tatimi mbi fitimin përfshin tatimin e periudhës aktuale dhe tatimin e shtyrë. Tatimi mbi fitimin njihet në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera përmbledhëse përveç pjesës që lidhet me zëra të njohur direkt në kapital.

**(i) Tatimi aktual**

Tatimi aktual është tatimi që pritet të paguhet mbi fitimin e tatueshëm të vitit duke përdorur normën tatimore në fuqi ose që konsiderohet si e tillë në datën e mbylljes së pasqyrave financiare dhe çdo sistemim të tatimit të pagueshëm për vitet e mëparshme.

Tatimi aktual është shuma e pagueshme në lidhje me fitimin e tatueshëm për vitin. Fitimi i tatueshëm mund të ndryshojë nga fitimi i raportuar në pasqyrën përmbledhëse të ardhurave, sepse përjashton zëra të ardhurave dhe shpenzimeve që janë të tatueshme ose të zbritshme në periudha të ndryshme nga periudha kontabël kur njihet. Tatimi aktual mbi fitimin i Bankës llogaritet duke përdorur normat tatimore që janë në fuqi në fund të periudhës raportuese.

**(ii) Tatimi i shtyrë**

Tatimi i shtyrë njihet nga diferencat e përkohshme ndërmjet vlerës kontabël neto të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime raportimi financiar dhe shumave të përdorura për qëllime tatimore.

Matja e aktivitetit dhe pasivitetit tatimor të shtyrë pasqyron efektet tatimore që do të vijnë nga mënyra në të cilën Banka, në datën e raportimit, pret të rimarrë apo shlyejë vlerën kontabël të aktiveve dhe detyrimeve të saj. Tatimi i shtyrë matet me normat e tatimit që pritet të aplikohen ndaj diferencave të përkohshme kur ato kthehen mbrapsht bazuar në ligjet që janë në forcë në datën e raportimit.

Aktivitet dhe detyrimet e shtyra tatimore kompensohen në qoftë se ka një të drejtë ligjore për të kompensuar aktivitet dhe detyrimet tatimore aktuale, dhe ato lidhen me tatimet e mbledhura nga i njëjti autoritet tatimor në të njëjtën njësi ekonomike, ose në subjekte të ndryshme tatimore, por ata kanë për qëllim të zgjidhin detyrimet dhe aktivitet aktuale tatimore në bazë neto ose aktivitet dhe detyrimet tatimore të tyre do të realizohet në të njëjtën kohë.

Një aktiv tatimor i shtyrë njihet për aq sa është e mundur që fitimi i tatueshëm i ardhshëm do të jetë i disponueshëm kundrejt të cilit diferencat e përkohshme të zbritshme të mund të përdoren. Tatimi i shtyrë rishikohet në çdo datë raportimi dhe zvogëlohet deri në masën që nuk ka më mundësi që përfitimi nga tatimi mund të realizohet.



**BANKA NBG ALBANIA SHA**  
**SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2015**  
*(të gjitha shumat janë shprehur në '000 Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)*

---

**4. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)**

**4.12 Paraja dhe ekuivalentet e saj**

Paraja dhe ekuivalentët e saj përfshijnë kartëmonedha, monedha, shuma të pakushtëzuara me Bankën Qëndrore, llogari rrjedhëse dhe depozita me afat maturimi më pak se tre muaj, të cilat nuk ndikohen shumë nga ndryshimet në vlerën e drejtë dhe përdoren nga Banka për përmbushjen e angazhimeve afatshkurtra.

Për qëllime të pasqyrës së rrjedhës së parasë, paraja dhe ekuivalentet e saj tek pasqyra e rrjedhës së parasë në fund të vitit financiar mund të rakordohen me zërat përkatës në pasqyrën e pozicionit financiar, siç është detajuar në shënimin 30 "Paraja dhe ekuivalentet e saj".

**4.13 Aktivet afatgjata materiale**

**(i) Njohja dhe matja**

Zërat e aktiveve afatgjata materiale paraqiten me kosto minus zhvlerësimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluarra nga rënia në vlerë.

Kostot përfshijnë shpenzimet që janë të lidhura direkt me blerjen e aktivit. Kosto e aktivit të ndërtuar vetë përfshin koston e materialeve dhe punës direkte dhe çdo kosto tjetër direkte të lidhur me vënien e aktivit në kushtet e punës për përdorimin e parashikuar, kostot e çmontimit dhe heqjen e pjesëve dhe restaurimin e zonës në të cilat ato janë vendosur. Pjesë të një prone, makinerie dhe pajisjeje që kanë jetë-gjatësi të ndryshme kontabilizohen si elemente të veçanta (pjesë përbërëse) të aktiveve afatgjata materiale.

**(ii) Kostot vijuese**

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një elementi të aktiveve afatgjata materiale njihet me vlerën e mbartur të elementit, nëse është e mundshme që përfitime ekonomike në të ardhmen, që i atribuohen atij elementi, do të rrjedhin në Bankë dhe kostoja e tij mund të matet me besueshmëri. Kostot e shërbimeve ditore të aktiveve afatgjata materiale njihen në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave në momentin kur ato ndodhin.

**(iii) Amortizimi**

Amortizimi njihet në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave me anën e metodës lineare gjatë jetës së vlerësuar të çdo aktivi afatgjatë material. Aktivet e marra me qira zhvlerësohen për më të shkurtrën midis kohës së qirasë dhe jetëgjatësisë së aktivit

Jetëgjatësia për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 është si vijon:

- |  |              |
|--|--------------|
| • Makineri dhe pajisje                     | 4 deri më 10 |
| • Mobilje zyre dhe pajisje                 | 5 deri më 10 |
| • Përmirësime në ambiente të marra me qira | 6 deri më 15 |

Metoda e amortizimit, jetëgjatësia dhe vlera e mbetur rishikohen në datën e raportimit. Amortizimi nuk llogaritet për aktivet në proces.

#### **4. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)**

##### **4.14 Aktivët afatgjata jomateriale**

Programet kompjuterike të blera nga Banka njihen me koston historike zvogëluar me amortizimin dhe humbjet e akumuluar nga rënia në vlerë. Shpenzimet e mëtejshme mbi programet kompjuterike kapitalizohen vetëm kur këto shpenzime lidhen me rritjen e përfitimit të ardhshëm ekonomik prej këtij aktivi. Të gjitha shpenzimet e tjera njihen në periudhën që ndodhin. Shpenzimi i amortizimit njihet në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave, bazuar mbi metodën lineare të amortizimit gjatë jetës së vlerësuar të dobishme të programit kompjuterik, prej datës në të cilën ai është i gatshëm për përdorim. Jeta e dobishme ekonomike e programeve kompjuterike është pesë vjet.

##### **4.15 Zhvlerësimi i aktiveve materiale dhe jo materiale**

Banka rishikon në fund të çdo periudhe raportuese vlerën kontabël neto të aktiveve materiale dhe jomateriale për të përcaktuar nëse ka të dhëna se këto aktive janë zhvlerësuar. Nëse ekzistojnë tregues të tillë, matet shuma e rikuperueshme e aktivitetit në mënyrë që të përcaktohet masa e zhvlerësimit (nëse ka).

Shuma e rikuperueshme është më e madhja midis vlerës së drejtë minus kostot e shitjes dhe vlerës në përdorim. Nëse shuma e rikuperueshme e një aktivi vlerësohet të jetë më e vogël se vlera kontabël neto, vlera kontabël neto e aktivitetit zvogëlohet deri në shumën e rikuperueshme. Një humbje nga zhvlerësimi njihet menjëherë në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave, përveç nëse aktivi mbahet me shumë të rivlerësuar, rast në të cilin humbja nga zhvlerësimi njihet si pakësim i rivlerësimit. Kur anulohet një humbje nga zhvlerësimi, vlera kontabël neto e aktivitetit rritet deri në vlerën e rishikuar të rikuperueshme, por jo aq sa vlera neto kontabël e rritur të tejkalojë vlerën kontabël neto që do të ishte përcaktuar nëse nuk do të ishte njohur humbja nga zhvlerësimi në vitet e mëparshme.

Një anulim i humbjes nga rënia në vlerë njihet në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave, përveç se kur aktivi mbahet me vlerën e rivlerësuar rast në të cilin anulimi i humbjes nga rënia në vlerë njihet si një rritje nga rivlerësimi.

##### **4.16 Depozita, borxhi i varur dhe detyrime të tjera financiare**

Depozitat, borxhi i varur dhe detyrimet e tjera financiare janë pjesë e burimeve kryesore të financimit të Bankës. Kur Banka shet një aktiv financiar dhe hyn në një marrëveshje ri-blerjeje për ta blerë këtë aktiv (ose një aktiv të ngjashëm) me një çmim fiks në të ardhmen, marrëveshja kontabilizohet si një depozitë, dhe aktivi vazhdon të njihet në pasqyrat financiare të Bankës.

Banka klasifikon instrumentat kapitale si detyrime financiare ose instrumenta kapitale në përputhje me thelbin e kushteve kontraktuale të instrumentit. Depozitat dhe detyrimet e tjera financiare maten fillimisht me vlerën e tregut duke i shtuar kostot e transaksionit dhe në vijim maten me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Depozitat, borxhi i varur dhe detyrimet e tjera financiare maten fillimisht me vlerën e drejtë minus kostot direkte të transaksionit, dhe më pas maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, përveç rasteve kur Banka përcakton matjen e tyre me vlerën e drejtë përmes fitimit apo humbjes. (shih shënimin 4.2 (vii)).

##### **4.17 Provigjionet**

Një provigjon njihet nëse, si rezultat i ngjarjeve të mëparshme, Banka ka një detyrim aktual ligjor ose konstruktiv, i cili mund të matet në mënyrë të besueshme dhe është e mundur që nxjerrje fondesh do të kërkohen për shlyerjen e këtij detyrimi.

#### **4. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)**

##### **4.18 Garancitë financiare dhe angazhimet e huave**

Garancitë financiare janë kontrata të cilat i lejojnë Bankës të kryej pagesa specifike për të rimbursuar mbajtësin në rast humbjeje, kur një debitor nuk arrin të shlyejë huanë në përputhje me kushtet e instrumentit të borxhit. Angazhimet e huasë janë angazhime të cilat ofrojnë kredi me kushte dhe terma të paracaktuar.

Detyrimet që rrjedhin nga garancitë financiare apo angazhime për të siguruar një hua me normë interesi më të ulët se niveli i tregut maten me vlerën e drejtë dhe vlera e drejtë fillestare amortizohet përgjatë jetës së garancisë apo angazhimit. Detyrimi vlerësohet me vlerën më të lartë midis vlerës së amortizuar dhe vlerës aktuale të çdo pagese që pritet të shlyhet në bazë të kontratës. Garancitë dhe angazhimet financiare që sigurojnë një hua me normë interesi nën nivelin e tregut përfshihen tek detyrimet të tjera.

#### **5. Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve**

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon që Drejtimi të bëjë gjykime, vlerësime dhe supozime që ndikojnë zbatimin e politikave kontabël dhe vlerat e aktiveve, pasiveve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto vlerësime.

Vlerësimet dhe supozimet që lidhen me to rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar dhe në periudhat vijuese të prekura.

##### ***Provigjione nga zhvlerësimi***

Provigjionet për humbjet nga aktivet financiare janë vlerësuar mbi bazën e parimeve të përshkruara në shënimin 4.2 (vii).

Përbërësi specifik i totalit të provigjioneve për zhvlerësim aplikohet ndaj aktiveve financiare të vlerësuara individualisht për zhvlerësim dhe bazohet në vlerësimin e drejtimit të vlerës aktuale të flukseve të mjeteve monetare që priten të merren. Për të llogaritur këto flukse të parave, drejtimi i Bankës gjykon mbi situatën financiare të debitorit dhe vlerën neto të realizueshme të kolateralit në fjalë. Çdo aktiv i zhvlerësuar, matet bazuar mbi cilësitë dhe strategjinë e tij, dhe vlerësimi i flukseve të mjeteve monetare që konsiderohen të rikuperueshme aprovohet në mënyrë të pavarur nga funksioni i rrezikut të kredisë.

Një përbërës kolektiv i provigjionit total është vendosur për:

- grupe të kredive homogjene të cilat nuk konsiderohen si të rëndësishme individualisht; dhe
- grupe të aktiveve që janë individualisht të rëndësishme, por që nuk janë zhvlerësuar individualisht

Provigjionimi kolektiv për grupe të huave homogjene është krijuar duke përdorur metoda statistikore të tilla si metodologji të normës së ndryshuar, ose, për portofole të vogla me informacione të pamjaftueshme, llogaritet me formulë duke u bazuar në përvojën historike të normës së humbjes. Metodologjia e normës së ndryshuar përdor analizat statistikore të të dhënave historike mbi shkëlqjen e vlerësimeve të humbjes. Vlerësimi i humbjes i ardhur në bazë të informacionit historik rishikohet më pas për t'u siguruar se pasqyron në mënyrë të përshtatshme kushtet ekonomike dhe llojet e produkteve në datën e raportimit. Metodologjia e normës së ndryshuar dhe normave të humbjes krahasohen rregullisht me përvojën e humbjes aktuale.

## **5. Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve (vazhdim)**

### ***Provigjonet për humbje nga kreditë (vazhdim)***

Provigjonet kolektive për grupet e aktiveve që janë individualisht të rëndësishme, por për të cilat nuk ka prova të jenë zhvlerësuar individualisht (kanë ndodhur por nuk janë raportuar) mbulojnë humbjet e kreditit të qenësishëm në portofolet e huave dhe paradhënieve dhe të letrave me vlerë të investimit të mbajtura deri në maturim me karakteristika të ngjashme me rrezikun e kreditit, kur ka evidenca objektive që sugjerojnë se ato përmbajnë hua dhe paradhënie dhe letra me vlerë të mbajtura deri në maturim të zhvlerësuar, por humbja individuale për çdo njësi nuk mund të identifikohet.

Në vlerësimin e nevojës për provigjonet për humbjet kolektive, manaxhimi konsideron faktorë të tillë si cilësia e kreditit, masa e portofolit, përqëndrimet dhe faktorët ekonomik. Në mënyrë që të vlerësohet provigjoni i kërkuar, janë bërë supozime për të përcaktuar sesi janë modeluar humbjet dhe për të vendosur parametrat e kërkuar, bazuar në përvojën historike dhe në kushtet aktuale ekonomike. Saktësia e provigjoneve varet nga vlerësimet e flukseve të ardhshme të parasë për provigjione të veçanta të kundërpartive dhe nga supozimet e modelit dhe parametrat e përdorur në përcaktimin e provigjoneve kolektive.

Vlerësimi nëse një investim në hua është i zhvlerësuar apo jo mund të jetë i ndërlikuar. Në kryerjen e këtyre vlerësimeve, Banka konsideron faktorët e mëposhtëm:

- Vlerësimi i tregut për dobinë e kreditit siç reflektohet në rendimentin e obligacionit;
- Vlerësimi i agjensive vlerësuese për dobinë e kreditit;
- Aftësia e një vendi për të hyrë në tregjet kapitale për të marrë hua;
- Mundësia që borxhi të ristrukturohet duke rezultuar në humbje për aksionarët falë faljeve vullnetare apo të detyrueshme të borxhit.

Mekanizmat ndërkombëtare të mbështetjes të vendosura për të siguruar mbështetjen e nevojshme si “huadhënës i fundit” për vendin e synuar, janë reflektuar në pasqyrat publike, rreth gadishmërisë së qeverisë dhe agjencive për t’i përdorur këto mekanizma. Kjo përfshin një vlerësim për thellësinë e këtyre mekanizmave dhe pavarësisht nga qëllimi politik, nëse ka kapacitetet për të përmbushur kriteret e kërkuara.

### ***Supozimi i vijimësisë***

Kriza në ekonominë greke ka rezultuar në humbje nga zhvlerësimi në kategori të ndryshme të aktiveve, si në obligacionet e qeverisë greke edhe në hua të tjera në Greqi, të cilat kanë ndikuar negativisht në pozicionin financiar, rezultatet e veprimtarisë, rrjedhja e parasë dhe raportet rregullatore të National Bank of Greece S.A (“NBG S.A.”) duke filluar nga viti 2011. Për më tepër kriza ka kufizuar aksesin e grupit NBG në likuiditete nga institucione të tjera financiare. NBG S.A. mbështetet në likuiditete të siguruar nga Banka Qëndrore Europiane dhe Banka e Greqisë (emërtimi kolektiv “lehtësirave të likuiditetit të Eurosistemit”).

Aftësia e NBG S.A. për të siguruar vijimësinë varet nga mundësia për të siguruar mjaftueshëm fonde për të rindërtuar pozicionin financiar të NBG S.A., i cili aktualisht është negativ, dhe për të mbajtur një nivel të përshtatshëm kapitali dhe në mbështetjen dhe vazhdimësinë e lehtësirave të likuiditetit ofruar nga Eurosistemi.

Pozicioni i drejtimit të grupit NBG është që NBG S.A. (dhe Grupi) mund të vazhdojë të operojë në të ardhmen e afërt me qenë se kërkesat specifike të Ligjit të shoqërisë 2190/1920 janë mbuluar nga plani i rikapitalizimit për bankat greke dhe që plani i rikapitalizimit përbën një pjesë integrale të mbështetjes financiare sipas programit të dytë rregullues ekonomik për Greqinë, që është ratifikuar nga Parlamenti Grek më 14 shkurt 2012 dhe aplikuar nga Këshilli i Bashkimit Europian (“Eurogrupi”) më 21 shkurt 2012 dhe 13 mars 2012 (“Programi”).

## **BANKA NBG ALBANIA SHA**

### **SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2015**

*(Të gjitha shumat janë shprehur në '000 Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)*

---

#### **5. Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve (vazhdim)**

##### ***Supozimi i vijimësisë (vazhdim)***

Pagesa e ndihmës ishte planifikuar të ndodhte në disa disbursimeve që nga maj 2010 deri në qershor 2013. Për shkak të një recesioni të përkeqësuar dhe faktit se Greqia kishte punuar më ngadalë nga çpritej, në përputhje me pikën 2 dhe 3 më sipër, ishte i nevojshme edhe një vit për t'i ofruar Greqisë më shumë kohë dhe para në përpjekje për të rivendosur ekonominë. Në tetor të vitit 2011, liderët e eurozonës ranë dakord për pasojë për të ofruar një kredi të dytë prej 130 miliard € në ndihme Greqisë, të kushtëzuar jo vetëm nga zbatimi i një pakete tjetër shtrënguese (kombinuar me kërkesat e vazhdueshme për privatizim dhe reformat strukturore të përshkruara në programin e parë), por edhe se të gjithë kreditorët privat që mbajnë bono të qeverisë greke duhet të nënshkruajnë një marrëveshje për të pranuar norma të ulëta të interesit dhe një humbje në vlerë nominale prej 53.5%.

Programi i aprovuar tashmë nga Trojka, së bashku me një radhë specifike disbursimesh, vë në dispozicion fonde për planin e rikapitalizimit, në shumën rreth 50 miliard EURO dhe tani është në fazën e zbatimit nën mbikqyrjen e Bankës së Greqisë.

Ekonomia greke u paraqit e qëndrueshme gjatë vitit 2015, edhe pse negociatat e zgjatura me huadhënësit zyrtarë rritën pasigurinë për nevojat e financimit duke shkaktuar rrjedhje të konsiderueshme të depozitave nga sistemi bankar. Skenarët Grexit (e daljes nga eurozona) u rikthyen, ndërsa qeveria greke vendosi kufizime të shumta për menaxhimin e likuiditetit duke deklaruar "pushime bankare" për një periudhë tre javore, kufizimin e shumave të tërheqjes në ditë dhe hapjen e llogarive të reja.

Gjatë gjashtëmujorit të dytë të 2015-ës pozicioni i likuiditetit të bankës është përmirësuar, ndërsa qeveria në gusht të vitit 2015 arriti marrëveshjen për një program të ri mbështetje financiare për Greqinë. NBG SA ka përfunduar me sukses rritjen në kapitalin aksioner dhe rifitoi pozicionin e saj në depozita brenda fundit të vitit. Manaxhimi i NBG S.A. konkludoi se Banka mund të vazhdojë të operojë në të ardhmen e afërt duke konsideruar: i) aksesin në facilitetet e Eurosistemit, ii) marrëveshjen e arritur midis Institucioneve dhe Republikës Greke në Korrik/gusht 2015, iii) raportin i mjaftueshmërisë së kapitalit të Bankës dhe Grupit në dhjetor 2015 dhe iv) pritshmëritë pozitive në raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit të Bankës dhe Grupit nga masat e mbetura prej Planit të Kapitalizimit.

Në vijim të këtyre trazirave ekonomike dhe skenarëve Grexit, Banka NBG Albania pati rrjedhje të depozitave gjatë tremujorit të tretë të 2015-ës. Situata u menaxhua me sukses nga Banka dhe me mbështetjen edhe të Bankës së Shqipërisë për qetësimin e reagimit të depozituesve. Brenda fundit të vitit banka, financiar kryesisht nga depozitat vendase, përmirësoi pozicionin e likuiditetit dhe mbeti e mirëkapitalizuar. Banka nuk ka ekspozim të rëndësishëm borxhi me qeveritë Europiane.

Siç është detajuar në shënimet e mëposhtme, më 31 dhjetor 2015, Banka ka investuar me grupin NBG shumë prej USD 110 mijë dhe llogari të arkëtueshme shumë prej EUR 247 mijë në formën e llogarisë rrjedhëse. Drejtimi beson se çdo tërheqje eventuale të llogarisë rrjedhëse nga mëma nuk do të ndikojnë dukshëm në likuiditetin e Bankës. Borxhi i varur me NBG Athinë në shumë EUR12,000 mijë më 31 dhjetor 2015 përfaqëson vetëm 4.23% të totalit të detyrimeve të Bankës. Borxhi i varur është përdorur si shtesë rezervë e kapitalit në llogaritjet mjaftueshmërisë së kapitalit për të përmbushur kërkesat e rregulloreve të Bankës së Shqipërisë.

Manaxhimi beson se Banka është e pozicionuar mirë për të mbështetur në mënyrë adekuate planin e saj të biznesit gjatë vitit të ardhshëm dhe raportin i mjaftueshmërisë së kapitalit prej 19.06% (mbas auditimit të fitimit të vitit) i mundëson Bankës përballimin e vështirësive brenda parashikimeve të arsyeshme.



**BANKA NBG ALBANIA SHA**  
**SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2015**  
*(të gjitha shumat janë shprehur në '000 Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)*

**6. Arka dhe llogaritë me Bankën Qëndrore**

	<b>31 dhjetor 2015</b>	<b>31 dhjetor 2014</b>
Arka	1,429,140	1,351,503
Llogaritë në Bankën Qëndrore	49,867	902,373
Rezerva në Bankën Qëndrore	2,318,516	3,029,147
<b>Totali</b>	<b>3,797,523</b>	<b>5,283,023</b>

Në përputhje me kërkesat e Bankës Qëndrore për rezervat e detyrueshme, Banka duhet të mbajë një minimum prej 10% të depozitave të klientëve në Bankën Qëndrore si llogari e rezervës së detyrueshme.

Interesi mbi këto rezerva e llogaritur në lekë është 70% e normës së marrëveshjeve të riblerjes, e cila në 31 dhjetor 2015 ka qenë 1.75% në vit (2014: 2.25% në vit);

Më 27 prill 2011, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë lëshoi vendimin Nr. 28 "Aprovimi i normave të interesit për remunerimin e rezervës së detyrueshme të bankave", sipas së cilës, bankat e nivelit të dytë nuk fitojnë remunerim nga rezerva e detyrueshme që vjen nga monedhat e huaja.

Llogaritë rrjedhëse në Bankën Qëndrore nuk pëllogaritet interes.

**7. Hua dhe parapagime nga bankat**

	<b>31 dhjetor 2015</b>	<b>31 dhjetor 2014</b>
<b>Llogari rrjedhëse</b>		
Jo rezident	1,568,908	1,227,851
Rezident	11	11
	<b>1,568,919</b>	<b>1,227,862</b>
<b>Depozita</b>		
Jo rezident	2,161,890	4,968,769
Rezident	100,000	
	<b>2,261,890</b>	<b>4,968,769</b>
Shuma të tjera ndaj bankave	-	189
Interes i pëllogaritur	32	2,539
<b>Totali</b>	<b>3,830,841</b>	<b>6,199,359</b>

**BANKA NBG ALBANIA SHA**  
**SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2015**  
*(të gjitha shumat janë shprehur në '000 Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)*

**7. Hua dhe parapagime nga bankat (vazhdim)**

	<b>31 dhjetor 2015</b>	<b>31 dhjetor 2014</b>
<i>Njësitë e grupit NBG:</i>		
NBG – Zyra qendrore	33,953	343,114
NBG – Dega në Londër	14,019	8,216
<b>Totali për entitetet e grupit</b>	<b>47,972</b>	<b>351,330</b>
<i>Të arkëtueshme për bankat jo rezidente:</i>		
Deutsche Trust Bank	68,117	758,302
Intesa San Paolo Group	677,919	75,663
Atlantic Bank of New York	15,046	6,685
Commonwealth Bank of Australia	10,318	22,365
Deutsche Bank AG Visa Int	749,522	13,492
Standard Chartered	14	14
<b>Totali i të arkëtueshmeve nga bankat jo rezidente</b>	<b>1,520,936</b>	<b>876,521</b>
<i>Letra të vendosjes:</i>		
NBG Malta LTD	-	910,910
Erste Group Bank AG	880,530	806,610
Deutsche Bank	-	-
KBC Bank NV Brussels	713,856	840,840
Unicredito Italiano SPA	503,160	840,840
Raiffeisen International	-	840,840
Intesa San Paolo SPA	64,344	728,729
<b>Totali i letrave të vendosjes nga bankat jo rezidente</b>	<b>2,161,890</b>	<b>4,968,769</b>
<b>Totali i të arkëtueshmeve nga bankat jo rezidente</b>	<b>3,730,798</b>	<b>6,196,620</b>
<i>Të arkëtueshme nga bankat rezidente:</i>		
Tirana Bank (të arkëtueshme)	11	11
National Commercial Bank	100,000	-
<b>Totali i të arkëtueshmeve nga bankat rezidente</b>	<b>100,011</b>	<b>11</b>
Llogari të tjera nga bankat	-	189
Interes i përllogaritur	32	2,539
<b>Totali</b>	<b>3,830,841</b>	<b>6,199,359</b>

**BANKA NBG ALBANIA SHA****SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2015***(Të gjitha shumat janë shprehur në '000 Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)***8. Letra me vlerë të mbajtura për tregtim**

	<u>31 dhjetor 2015</u>	<u>31 dhjetor 2014</u>
Obligacione qeveritare	-	50,136
Interesi i përlogaritur mbi letra me vlerë të mbajtura për tregtim	-	1,037
<b>Totali</b>	<b>-</b>	<b>51,173</b>

	<u>31 dhjetor 2014</u>			
	<u>Vlera Nominale</u>	<u>Interesi i përlogaritur</u>	<u>Ndryshim në vlerën e drejtë</u>	<u>Vlera e drejtë</u>
Obligacione të Qeverisë Shqipëtare	50,000	1,037	136	51,173
<b>Totali</b>	<b>50,000</b>	<b>1,037</b>	<b>136</b>	<b>51,173</b>

**9. Hua dhe paradhënie për klientët, neto**

	<u>31 dhjetor 2015</u>	<u>31 dhjetor 2014</u>
Ndaj individëve	14,622,762	14,411,604
Ndaj shoqërive korporata / profesionale	6,769,286	4,852,388
<b>Kredi pa probleme me kosto të amortizuar</b>	<b>21,392,048</b>	<b>19,263,992</b>
Ndaj individëve	2,346,255	2,316,876
Ndaj shoqërive korporata / profesionale	6,050,346	6,248,931
<b>Kredi me probleme me kosto të amortizuar</b>	<b>8,396,601</b>	<b>8,565,807</b>
Provizjone për humbjet nga huatë dhe Letër Garancisë (shënimi 24)	(4,142,072)	(4,028,387)
<b>Totali</b>	<b>25,646,577</b>	<b>23,801,412</b>

**BANKA NBG ALBANIA SHA**  
**SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2015**  
*(Të gjitha shumat janë shprehur në '000 Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)*

**10. Letra me vlerë të vlefshme për shitje**

	<b>31 dhjetor 2015</b>	<b>31 dhjetor 2014</b>
Bono thesari (Qeveria Shqiptare)	2,100,470	3,533,056
Bono thesari (Qeveria Greke)	-	1,393,620
Letra me vlerë borxhi të emetuara nga entitete të tjera qeveritare dhe publike (të listuara)	703,663	1,433,219
Letra me vlerë borxhi të emetuara nga entitete të tjera qeveritare dhe publike (jo të listuara)	2,318,896	1,984,134
Interes i përllogaritur	76,814	120,148
<b>Totali</b>	<b>5,199,843</b>	<b>8,464,177</b>

Tabela më poshtë paraqet minimumin dhe maksimumin e normave të interesit të aplikuara në letrat me vlerë të vendosjes gjatë vitit 2015 dhe 2014, sipas maturimit dhe monedhës së instrumentit:

	<b>2015</b>		<b>2014</b>	
	<b>Minimumi i Normës së interesit</b>	<b>Maksimumi i Normës së interesit</b>	<b>Minimumi i Normës së interesit</b>	<b>Maksimumi i Normës së interesit</b>
<b>Maturiteti</b>				
Bono Thesari LEK				
12 muaj	2.50%	3.60%	3.18%	3.87%
Obligacione qeveritare LEK				
1-5 vjet	4.90%	8.18%	4.74%	8.18%
> 5 vjet	4.55%	6.07%	4.74%	6.02%
Obligacione qeveritare EUR				
1-5 vjet	3.12%	5.75%	0.13%	4.43%

Letrat me vlerë të vlefshme për shitje sipas afatit të shlyerjes, më 31 dhjetor 2015, janë si vijon:

	<b>31 dhjetor 2015</b>					
	<b>Vlera nominale</b>	<b>Shuma e blerjes</b>	<b>Zbritjet nga amortizimi</b>	<b>Të përllogariturat</b>	<b>Ndryshim në vlerën e drejtë</b>	<b>Vlera e drejtë</b>
3 muaj	-	-	-	-	-	-
6 muaj	100,000	98,769	(1,231)	148	18	98,935
12 muaj	2,060,330	1,994,766	(65,564)	39,060	6,918	2,040,744
1-5 vite	2,820,440	2,815,543	(4,897)	35,906	7,852	2,226,722
>5 vite	200,000	200,000	-	1,700	(837)	200,863
<b>Totali</b>	<b>5,180,770</b>	<b>5,109,078</b>	<b>(71,692)</b>	<b>76,814</b>	<b>13,951</b>	<b>5,199,843</b>

**BANKA NGB ALBANIA SHA**  
**SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2015**  
*(të gjitha shumat janë shprehur në '000 Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)*

**10. Letra me vlerë të vlefshme për shitje (vazhdim)**

Letrat me vlerë të vlefshme për shitje sipas afatit të shlyerjes, më 31 dhjetor 2014, janë si vijon:

	31 dhjetor 2014					
	Vlera nominale	Shuma e blerjes	Zbritjet nga amortizimi	Të përlogariturat	Fitim / (humbja) e tregut	Vlera e drejtë
3 muaj	840,840	839,663	(1,177)	673	(765)	839,571
6 muaj	560,560	554,898	(5,662)	4,542	(177)	559,263
12 muaj	3,657,208	3,534,844	(122,364)	79,377	(1,787)	3,612,434
1-5 vite	2,418,407	2,439,479	21,072	22,351	10,021	2,471,851
>5 vite	1,000,000	998,004	(1,996)	13,205	(30,151)	981,058
<b>Totali</b>	<b>8,477,015</b>	<b>8,366,888</b>	<b>(110,127)</b>	<b>120,148</b>	<b>(22,859)</b>	<b>8,464,177</b>

**Ndryshimet në letrat me vlerë të vlefshme për shitje**

Tabla më poshtë tregon ndryshimet në gjendjet e letrave me vlerë të vlefshme për shitje më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014, duke përfshirë shtesat, maturimet dhe shitjet e investimeve përgjatë këtyre viteve.

	31 dhjetor, 2015	31 dhjetor, 2014
<b>Gjendja më 1 janar</b>	<b>8,464,177</b>	<b>7,703,574</b>
Shtesa	5,415,542	5,279,405
Shitjet	(2,348,671)	-
Maturuar	(6,484,245)	(4,563,772)
Luhatjet e vlerës së drejtë	36,809	(142,520)
Interesi i përlogaritur	76,815	120,148
Diferencat e kursit të këmbimit	39,416	67,342
<b>Balance 31 dhjetor</b>	<b>5,199,843</b>	<b>8,464,177</b>

**BANKA NBG ALBANIA SHA**  
**SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2015**  
*(Të gjitha shumat janë shprehur në '000 Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)*

**11. Aktive afatgjata jomateriale, neto**

	<b>Programe kompjuterike</b>	<b>Të tjera</b>	<b>Totali</b>
<i>Kosto</i>			
<b>Gjëndja më 1 janar 2014</b>	<b>341,864</b>	<b>8,114</b>	<b>349,978</b>
Shtesa	25,868	-	25,868
<b>Gjëndja më 31 dhjetor 2014</b>	<b>367,732</b>	<b>8,114</b>	<b>375,846</b>
Shtesa	32,364	-	32,364
<b>Gjëndja më 31 dhjetor 2015</b>	<b>400,096</b>	<b>8,114</b>	<b>408,210</b>
<i>Amortizimi i Akumuluar</i>			
<b>Gjëndja më 1 janar 2014</b>	<b>318,535</b>	<b>7,526</b>	<b>326,061</b>
Amortizimi i vitit	11,769	404	12,173
<b>Gjëndja më 31 dhjetor 2014</b>	<b>330,304</b>	<b>7,930</b>	<b>338,234</b>
Amortizimi i vitit	13,858	180	14,038
<b>Gjëndja më 31 dhjetor 2015</b>	<b>344,162</b>	<b>8,110</b>	<b>352,272</b>
<i>Vlera kontabël neto</i>			
<b>Gjëndja më 31 dhjetor 2014</b>	<b>37,428</b>	<b>184</b>	<b>37,612</b>
<b>Gjëndja më 31 dhjetor 2015</b>	<b>55,934</b>	<b>4</b>	<b>55,938</b>



**BANKA NBG ALBANIA SHA**  
**SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2015**  
*(Të gjitha shumat janë shprehur në '000 Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)*

**12. Aktive afatgjata materiale, neto**

	Përmirësime në			Totali
	Makineri dhe pajisje	Mobilije zyre dhe pajisje	ambjente të marra me qira	
<b>Kosto</b>				
<b>Gjëndja më 1 janar 2014</b>	<b>599,849</b>	<b>400,774</b>	<b>236,716</b>	<b>1,239,013</b>
Shtesa	13,286	2,795	246	21,997
Transferime	-	1,229	-	(1,229)
Pakësime	(1,118)	-	-	(1,118)
<b>Gjëndja më 31 dhjetor 2014</b>	<b>612,017</b>	<b>404,798</b>	<b>236,962</b>	<b>1,259,892</b>
Shtesa	15,351	10,237	6,611	34,629
Transferime	-	-	-	-
Pakësime	-	(1,524)	-	(1,524)
<b>Gjëndja më 31 dhjetor 2015</b>	<b>627,368</b>	<b>413,511</b>	<b>243,573</b>	<b>1,292,997</b>
<b>Amortizimi i akumuluar</b>				
<b>Gjëndja më 1 janar 2014</b>	<b>544,498</b>	<b>327,166</b>	<b>135,918</b>	<b>1,007,582</b>
Zhvlërësimi i vitit	20,351	21,306	12,113	53,770
Pakësime	(1,118)	-	-	(1,118)
<b>Gjëndja më 31 dhjetor 2014</b>	<b>563,731</b>	<b>348,472</b>	<b>148,031</b>	<b>1,060,234</b>
Zhvlërësimi i vitit	18,358	20,440	12,224	51,022
Pakësime	-	(900)	-	(900)
<b>Gjëndja më 31 dhjetor 2015</b>	<b>582,089</b>	<b>368,012</b>	<b>160,255</b>	<b>1,110,356</b>
<b>Vlera kontabël neto</b>				
<b>Gjëndja më 31 dhjetor 2014</b>	<b>48,286</b>	<b>56,326</b>	<b>88,931</b>	<b>199,658</b>
<b>Gjëndja më 31 dhjetor 2015</b>	<b>45,279</b>	<b>45,498</b>	<b>83,318</b>	<b>182,641</b>

Shumat e transferuara përfaqësojnë ato aktive fikse që janë konsideruar si shpenzime dhe të cilat nuk mund të kapitalizohen.

**BANKA NBG ALBANIA SHA**  
**SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2015**  
*(Të gjitha shumat janë shprehur në '000 Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)*

**13. Aktive të tjera, neto**

Aktivitet e tjera neto më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 janë si vijon:

	<b>31 dhjetor 2015</b>	<b>31 dhjetor 2014</b>
Derdhje e garancisë për detyrime tatimore	19,501	19,501
Debitorë	10,604	7,899
Pagesa në tranzit	11,666	5,650
<i>Diference keshi</i>	848	2,222
<i>Garanci</i>	749	992
<i>Tarifa të pagueshme</i>	1,591	1,458
<i>Të tjera</i>	8,478	978
Të ardhura të tjera të llogaritura	2,001	3,769
Llogari të garancive	14,532	-
Shpenzime të parapaguara	4,863	4,998
<b>Totali</b>	<b>63,167</b>	<b>41,817</b>

Derdhja e garancisë për detyrime tatimore, neto përbëhet prej:

	<b>31 dhjetor 2015</b>	<b>31 dhjetor 2014</b>
Derdhje e garancise per detyrime tatimore	220,782	220,782
Provigjione për humbje potenciale	(201,281)	(201,281)
<b>Totali</b>	<b>19,501</b>	<b>19,501</b>

Banka ka bërë derdhje garancie për detyrimet tatimore të identifikuar nga Autoritet Tatimore gjatë inspektimit tatimor në 2012. Banka ka hapur proces ligjor në lidhje me çështjen. Debitorët përfaqësojnë shumat për zyrën e përbarimit, zyrën e regjistrimit dhe taksa të tjera të paguara nga Banka, neto nga provigjionet.

**14. Detyrime ndaj bankave dhe institucioneve financiare**

Detyrimet ndaj bankave dhe institucioneve financiare më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 janë si vijon:

	<b>31 dhjetor 2015</b>	<b>31 dhjetor 2014</b>
Depozita me afat ndaj institucioneve të kreditit	1,173,399	638,974
Shuma detyruar Bankës Qëndrore	1,117,931	526,152
Depozita me kërkesë ndaj institucioneve të kreditit	13,890	19,761
Interesa të përlllogaritur	2,183	1,134
<b>Totali</b>	<b>2,307,403</b>	<b>1,186,021</b>

Më 31 dhjetor 2015 teprica e depozitave me afat ndaj institucioneve të kreditit përbëhej nga 1,173,399 mijë Lek hua afatshkurtër (2014: 638,974 mijë Lek), nga të cilat 903,160 mijë Lek përfaqësojnë hua nga bankat lokale, dhe 100 mijë GBP hua afatshkurtër të marrë nga National Bank of Grëce S.A. London me normë interesi 1%, dhe nga National Bank of Greece SA Cairo shumë prej 2,000 mijë USD ndërkohë që në dhjetor 2014 e njëjta balancë ishte 630,000 mijë Lek me një normë interesi 2.25%. Më 31 dhjetor 2015 Banka ka hyrë në marrëveshje riblerje, me Bankën e Shqipërisë në shumë prej 1,117,931 mijë Lek, me normë interesi që varion nga 1.78% në 2.20%.

**BANKA NBG ALBANIA SHA**  
**SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2015**  
*(Të gjitha shumat janë shprehur në '000 Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)*

**15. Detyrime ndaj klientëve**

	<b>31 dhjetor 2015</b>	<b>31 dhjetor 2014</b>
<i>Detyrime ndaj klientëve individë</i>		
Depozita me afat	19,280,769	23,682,780
Llogari rrjedhëse	3,005,927	3,445,107
Llogari kursimi	1,447,111	2,302,970
	<b>23,733,807</b>	<b>29,430,857</b>
<i>Detyrime ndaj klientëve korporatë</i>		
Llogari rrjedhëse	1,287,436	2,245,310
Depozita me afat	611,291	679,170
	<b>1,898,727</b>	<b>2,924,480</b>
<i>Detyrime ndaj qeverisë dhe agjensive</i>		
Llogari rrjedhëse	409,743	382,113
Depozita me afat	337,100	78,314
	<b>746,843</b>	<b>460,427</b>
Interes i përllogaritur	132,599	254,285
<b>Totali</b>	<b>26,511,976</b>	<b>33,070,049</b>

**16. Tatimi i shtyrë aktiv**

Tatimi i shtyrë aktiv dhe pasiv vijnë si pasojë e diferencave të përkohshme nga zërat e mëposhtëm:

	<b>31 dhjetor 2015</b>	<b>31 dhjetor 2014</b>
Amortizimi tatimor mbi normat fiskale	30,654	33,913
Provizjonet për detyrimet e mundshme	-	499
Letra me vlerë të vlefshme për shitje	-	3,429
Komisione të shtyra nga huatë	17,500	17,107
<b>Tatim i shtyrë aktiv</b>	<b>48,154</b>	<b>54,948</b>
Letra me vlerë të tregtueshme	-	(20)
<b>Tatim i shtyrë pasiv</b>	<b>-</b>	<b>(20)</b>
<b>Tatim i shtyrë aktiv, neto</b>	<b>48,154</b>	<b>54,928</b>

